KODI ZGJEDHOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(Miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008
dhe ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012)

PASQYRA E LËNDËS

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I
OBJEKTI, PËRKUFIZIME DHE PARIME

Neni 1 Qëllimi dhe objekti.....1
Neni 2 Përkufizime.....1
Neni 3 Parime të përgjithshme.....4
Neni 4 Emërimi dhe detyrat e nëpunësit ndërlidhës.....5
Neni 5 Ndalimi i përdorimit të forcave dhe strukturave
të posaçme.....5

KREU II
VËZHGUESIT

Neni 6 E drejta për të caktuar vëzhgues.....6
Neni 7 Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve.....7

KREU III
PERIUDHA ZGJEDHORE
DHE DATA E MBAJTJES SË ZGJEDHJEVE

Neni 8 Periudha zgjedhore.....8
Neni 9 Caktimi i datës së zgjedhjeve për Kuvendin.....8
Neni 10 Caktimi i datës së zgjedhjeve
për organet e qeverisjes vendore.....9
Neni 11 Orari i votimit.....10

PJESA E DYTË
INSTITUCIONET PËR PËRGATITJEN DHE ADMINISTRIMIN E ZGJEDHJEVE

KREU I
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)

Neni 12 Përbërja e KQZ-së.....11
Neni 13 Mandati dhe koha e punës e anëtarëve të KQZ-së.....12
Neni 14 Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së.....12
Neni 15 Zgjedhja e Kryetarit të KQZ-së.....13
Neni 16 Zëvendëskryetari i KQZ-së.....14
Neni 17 Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të KQZ-së.....15
Neni 18 Ndërprerja para kohe e mandatit të anëtarit të KQZ-së....15
Neni 19 Zëvendësimi i anëtarëve të KQZ-së.....16
Neni 20 Kompetencat e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit
të KQZ-së.....17
Neni 21 Kompetencat e KQZ-së.....18
Neni 21/1 Kompetencë e posaçme e KQZ-së.....20
Neni 21/2 Rregulla procedurale për zbatimin e teknologjisë
së informacionit në fushën e zgjedhjeve 20
Neni 22 Mbledhjet e KQZ-së 21
Neni 23 Aktet e KQZ-së dhe hyrja në fuqi e tyre 22
Neni 24 Vendimmarrja në KQZ.....22
Neni 25 Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e KQZ-së.....24
Neni 26 Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ.....25

KREU II
ZONAT E ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR (ZAZ) DHE KOMISIONET E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR (KZAZ)

Neni 27 Zonat e Administrimit Zgjedhor.....26
Neni 28 Ngritja e Komisioneve të Zonave të Administrimit
Zgjedhor.....27
Neni 29 Përbërja e KZAZ-së.....27
Neni 30 Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit
dhe të sekretarit të KZAZ-së.....29
Neni 31 Kushtet per emërimin e anëtarit dhe të sekretarit
të KZAZ-së.....30

Neni 32 Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit
të KZAZ-së.....30
Neni 33 Detyrat e KZAZ-së 31
Neni 34 Detyrat e sekretarit të KZAZ-së.....32
Neni 35 Mbledhjet dhe vendimet e KZAZ-së.....32

KREU III
KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT (KQV)

Neni 36 Përbërja e KQV-së.....33
Neni 37 Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit
të KQV-së.....34
Neni 38 Kushtet për emërimin e anëtarit dhe sekretarit
të KQV-së.....34
Neni 39 Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe sekretarit
të KQV-së.....35
Neni 40 Detyrat e KQV-së.....35
Neni 41 Detyrat e sekretarit të KQV-së.....36
Neni 42 Mbledhjet dhe vendimet e KQV-së.....37
Neni 43 Përbërja dhe përgjegjësitë e KQV-ve të posaçme.....37

PJESA E TRETË
ZGJEDHËSIT DHE PËRGATITJA E LISTËS SË ZGJEDHËSVE

KREU I
PËRMBAJTJA, HARTIMI DHE MIRATIMI
I LISTËS SË ZGJEDHËSVE

Neni 44 Kriteret për përfshirjen e zgjedhësit
në listat e zgjedhësve.....38
Neni 45 Përbërësit zgjedhorë.....38
Neni 46 Lista e zgjedhësve.....39
Neni 47 Përputhshmëria me RKGJC-në.....39
Neni 48 Përmbajtja dhe formati i listës së zgjedhësve.....39

KREU II
PROCESI I PËRGATITJES SË LISTËS SË ZGJEDHËSVE

Neni 49 Organi që harton listën e zgjedhësve.....40
Neni 50 Drejtimi metodologjik dhe mbikëqyrja e procesit
të hartimit të listave.....41
Neni 51 Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë.....42
Neni 52 Njoftimi me shkrim i zgjedhësve.....43
Neni 53 Shkaqet dhe procedurat e ndryshimit në ekstraktin
e përbërësve zgjedhorë.....44
Neni 54 Procedura administrative e rishikimit dhe
e ndryshimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë.....46
Neni 55 Ankimi gjyqësor ndaj refuzimit të kërkesës
për ndryshim.....46
Neni 56 Përgatitja dhe shpallja e listës së zgjedhësve.....47
Neni 57 Vendimet gjyqësore pas hartimit të listës
së zgjedhësve.....48

KREU III
ZGJEDHËSIT E VEÇANTË

Neni 58 Zgjedhësit e veçantë.....49
Neni 59 Lista për zgjedhjet e pjesshme, të parakohshme
ose të përsëritura.....50
Neni 60 Vënia e listave të zgjedhësve dhe ekstraktit
të përbërësve zgjedhorë në dispozicion
të subjekteve zgjedhore dhe publikut.....50
Neni 61 Mbikëqyrja e hartimit të listave të zgjedhësve
nga KQZ-ja.....51

KREU IV
ZONA E QENDRËS SË VOTIMIT

Neni 62 Caktimi i zonave dhe vendndodhjes së qendrave
të votimit.....53

PJESA E KATËRT
REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Neni 63 Subjektet zgjedhore dhe kandidatët.....55
Neni 64 Regjistrimi i partive politike në zgjedhje.....56
Neni 65 Regjistrimi i koalicioneve zgjedhore.....56
Neni 66 Identifikimi i subjekteve zgjedhore.....57
Neni 67 Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve
të partive.....57
Neni 68 Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve..58
Neni 69 Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet
në Kuvend.....59
Neni 70 Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet
e organeve të qeverisjes vendore.....60
Neni 71 Procedura e mbledhjes së nënshkrimeve.....61
Neni 72 Dokumentet e kandidimit.....62
Neni 73 Verifikimi i dokumentacionit.....62

PJESA E PESTË
ZONA ZGJEDHORE DHE NUMRI I MANDATEVE PËR ÇDO ZONË

Neni 74 Zona zgjedhore për Kuvendin.....63
Neni 75 Kriteret dhe procedura për caktimin e numrit
të mandateve.....63
Neni 76 Procedura dhe periudha e përcaktimit të mandateve.....64

PJESA E GJASHTË
FUSHATA ZGJEDHORE DHE MEDIA

Neni 77 Periudha e fushatës dhe e heshtjes zgjedhore.....65
Neni 78 Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore
gjatë fushatës.....65
Neni 79 Materialet propagandistike.....66
Neni 80 Fushata zgjedhore e subjekteve zgjedhore
në radiotelevizionin publik.....66

Neni 81 Edicionet informative të radiotelevizionit publik.....67
Neni 82 Minutazh falas për KQZ-në.....68
Neni 83 Orari i transmetimeve.....69
Neni 84 Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private.....69
Neni 84/1 Mbulimi i fushatës zgjedhore në zgjedhjet vendore.....72
Neni 85 Monitorimi i fushatës zgjedhore.....72
Neni 85/1 Mënyra e formimit të Bordit të Monitorimit të Medias.....73

PJESA E SHTATË
FINANCIMI I ZGJEDHJEVE DHE I FUSHATËS

KREU I
FINANCIMI I ZGJEDHJEVE

Neni 86 Fondet për përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve.....74

KREU II
FINANCIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Neni 87 Fondet nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje.....75
Neni 87/1 Burimet e financimit të fushatës zgjedhore.....76
Neni 87/2 Fondet e dhëna nga Buxheti i Shtetit për fushatën zgjedhore.....77
Neni 87/3 Mënyra e përllogaritjes së fondit paradhënie.....77
Neni 88 Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore.....78
Neni 89 Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike...78
Neni 90 Regjistrimi i fondeve jopublike.....79
Neni 91 Auditimi i fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore.....80
Neni 92 Përzgjedhja e auditëve nga KQZ-ja.....81

PJESA E TETË
PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS PËR ZGJEDHJET DHE GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE (GNV)

KREU I
VENDNDODHJA E QENDRAVE TË VOTIMIT, SELIVE TË KZAZ-VE, VENDEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE

Neni 93 Vendndodhja e qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe Vendeve të Numërimit të Votave.....82
Neni 94 Vendndodhja dhe përgatitja e Vendeve të Numërimit të Votave.....83
Neni 95 Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV).....85
Neni 96 Procedura për përcaktimin e partive që propozojnë anëtarë të GNV-ve 86

KREU II
PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR DHE DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE

Neni 97 Fletët e votimit.....87
Neni 98 Përmbajtja e fletëve të votimit.....87
Neni 99 Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KQZ-ja në KZAZ...88
Neni 100 Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV...90

PJESA E NËNTË
VOTIMI

KREU I
PROCEDURAT PËR HAPJEN E VOTIMIT

Neni 101 Veprime paraprake të KQV-së.....91
Neni 102 Hapja e votimit dhe prania e anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së.....92
Neni 103 Vulosja e fletëve të votimit 93

KREU II
PROCEDURAT GJATË VOTIMIT

Neni 104 Numri i kutive të votimit.....93
Neni 105 Paraqitja e zgjedhësit në qendrën e votimit.....94
Neni 106 Votimi.....95
Neni 107 Fletët e votimit të dëmtuara.....96
Neni 108 Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë.....96
Neni 109 Rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit.....98
Neni 110 Personat e pranishëm në qendrën e votimit.....98
Neni 111 *Shfuqizuar*…….....99

KREU III
MBYLLJA E VOTIMIT DHE NUMËRIMI I VOTAVE

Neni 112 Mbyllja e votimit.....99
Neni 113 Veprimet pas mbylljes së votimit.....100
Neni 114 Shoqërimi i kutive të votimit dhe i materialeve
të votimit në Vendin e Numërimit të Votave.....102

KREU IV
DORËZIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE
DHE NUMËRIMI I VOTAVE

Neni 115 Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor nga KZAZ-ja..103
Neni 116 Numërimi i votave.....106
Neni 116/1 Hapja e kutive të materialeve të votimit……..…….....107
Neni 117 Llojet e votave dhe kriteret për vlerësimin e votës.....109
Neni 118 Vlerësimi i votave.....110
Neni 119 Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve
nga Grupi i Numërimit.....112
Neni 120 Radha e numërimit për zgjedhjet
e pushtetit vendor.....114
Neni 121 Personat e pranishëm gjatë procesit
të numërimit të votave.....116
Neni 122 Nxjerrja e tabelës përmbledhëse
të rezultatit të zgjedhjeve nga KZAZ-ja.....116
Neni 123 Nxjerrja e rezultateve nga KQZ-ja.....117

PJESA E DHJETË
ANKIMI NË RRUGË ADMINISTRATIVE I VENDIMEVE TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE

Neni 124 E drejta e ankimit.....119
Neni 125 Llogaritja e afateve.....120
Neni 126 Forma dhe përmbajtja e ankimit kundër vendimeve të KZAZ-së dhe vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve 121
Neni 127 Regjistrimi i kërkesave ankimore nga KQZ-ja.....121
Neni 128 *Shfuqizuar*.....122
Neni 129 Verifikimi i plotësimit të formës dhe përmbajtjes së kërkesës ankimore.....122
Neni 130 Objekti i verifikimit paraprak.....123
Neni 131 Përmbajtja e vendimit të pranimit për shqyrtim të kërkesës ankimore.....123
Neni 132 Bashkimi i kërkesave ankimore.....123
Neni 133 Palët në shqyrtimin administrativ.....124
Neni 134 Shqyrtimi administrativ.....125
Neni 135 Çelja e seancës për shqyrtimin e kërkesës ankimore.....125
Neni 136 Paraqitja e pretendimeve dhe kërkimi i provave.....126
Neni 137 Detyrimi i organeve të tjera për të vënë në dispozicion prova.....127
Neni 138 Këqyrja e materialit zgjedhor.....127
Neni 139 Faktet e njohura botërisht dhe ekspertimet.....129
Neni 140 Prapësimet mbi provat.....129
Neni 141 Mbyllja e hetimit administrativ.....129
Neni 142 Tërheqja e pretendimeve ose heqja dorë prej tyre.....130
Neni 143 Lloji i vendimeve që merr KQZ-ja pas shqyrtimit të ankimeve dhe afatet.....130
Neni 144 Përmbajtja e vendimeve të KQZ-së.....131

PJESA E NJËMBËDHJETË
ANKIMI NË RRUGË GJYQËSORE I VENDIMEVE TË KQZ-SË DHE PAVLEFSHMËRIA E ZGJEDHJEVE

KREU I
ANKIMI NË RRUGË GJYQËSORE I VENDIMEVE TË KQZ-SË

Neni 145 E drejta e ankimit në gjykatë.....132
Neni 146 Përbërja e Kolegjit Zgjedhor
të Gjykatës së Apelit, Tiranë.....132
Neni 147 Kohëzgjatja dhe mbledhjet e Kolegjit Zgjedhor.....134
Neni 148 Kriteret për mospërfshirjen e gjyqtarëve në short.....134
Neni 149 Mbrojtja e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor.....135
Neni 150 Pavlefshmëria e delegimit.....135
Neni 151 Përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi i çështjes.....135
Neni 152 Afati i ankimit në gjykatë.....136
Neni 153 Forma dhe përmbajtja e ankimit.....136
Neni 154 Veprimet paraprake lidhur me kërkesëpadinë.....137
Neni 155 Procedura e shqyrtimit të kërkesëpadisë.....137
Neni 156 Të drejtat e palëve në proces.....138
Neni 157 Afati i gjykimit në Kolegjin Zgjedhor.....138
Neni 158 Llojet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor.....139
Neni 159 Përmbajtja e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor.....139

KREU II
PAVLEFSHMËRIA DHE PËRSËRITJA E ZGJEDHJEVE

Neni 160 Pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit.....140
Neni 161 Përsëritja e zgjedhjeve.....141

PJESA E DYMBËDHJETË
NDARJA E MANDATEVE

KREU I
MANDATET PËR KUVENDIN

Neni 162 Përllogaritja e mandateve të subjekteve zgjedhore.....142
Neni 163 Ndarja e mandateve brenda koalicionit.....143
Neni 164 Ndërprerja e mandatit dhe zëvendësimi i vakancës.....145

KREU II
SISTEMI I ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Neni 165 Sistemi i zgjedhjeve vendore.....146
Neni 166 Zgjedhja e organeve të qeverisjes vendore.....146

KREU III
SHPALLJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE

Neni 167 Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve.....147

PJESA E TREMBËDHJETË
PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET

Neni 168 Përgjegjësia e personave të ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve.....147
Neni 169 Mosbashkëpunimi me KQZ-në.....147
Neni 170 *Shfuqizuar* 147
Neni 171 Sanksionet administrative.....148
Neni 172 Sanksionet për shkelje të parimeve të Kodit.....148
Neni 173 Sanksionet në lidhje me financimin e fushatës.....149
Neni 174 Thyerja e heshtjes zgjedhore.....150
Neni 175 Sanksionet në lidhje me barazinë gjinore.....150
Neni 176 Ekzekutimi i sanksioneve administrative.....150

PJESA E KATËRMBËDHJETË
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 177 Lista e zgjedhësve për Bashkinë e Tiranës.....151
Neni 178 Ruajtja e dokumentacionit.....151
Neni 179 Plani i Veprimit për përdorimin e teknologjive
të informacionit në zgjedhje…….....152
Neni 179/1 Masat për realizimin e teknologjisë së re informative
në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013.....154
Neni 180 Ndarja e zonave të administrimit zgjedhor.....154
Neni 181 Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së.....155
Neni 182 Ndërprerja e mandatit të
anëtarëve ekzistues të KQZ-së.....155
Neni 183 Përtëritja pjesore e anëtarëve të KQZ-së…….....155
Neni 184 Nxjerrja e akteve nënligjore…….....…….....156
Neni 185 Shfuqizime.....156
Neni 186 Hyrja në fuqi.....156

SHTOJCA II

NUMËRIMI DHE VLERËSIMI I VOTAVE NËPËRMJET SISTEMIT ELEKTRONIK TË NUMËRIMIT (SEN)

Seksioni 1 Qëllimi.....157
Seksioni 2 Sistemi Elektronik i Numërimit (SEN).....157
Seksioni 3 Testimi paraprak i SEN-it.....158
Seksioni 4 Personat përgjegjës për numërimin dhe mbikëqyrja e procesit.....159
Seksioni 5 Verifikimi i saktësisë së SEN-it në vendin e numërimit (verifikimi *a posteriori*).....160
Seksioni 6 Numërimi i fletëve të votimit.....161
Seksioni 7 Vlerësimi i votave dhe nxjerrja e rezultatit nëpërmjet SEN-it.....163

SHTOJCA III

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË VERIFIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË PJESËMARRJES SË ZGJEDHËSVE NË DITËN E VOTIMIT (SEV)

Seksioni 1 Qëllimi.....167
Seksioni 2 Sistemi elektronik për verifikimin dhe regjistrimin e zgjedhësit (SEV).....167
Seksioni 3 Përdorimi i pajisjeve të leximit në qendrën e votimit dhe personeli.....168
Seksioni 4 Përpunimi i të dhënave, raportet dhe administrimi i sistemit.....169
Seksioni 5 Procedurat në qendrën e votimit.....171

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I
OBJEKTI, PËRKUFIZIME DHE PARIME

Neni 1
Qëllimi dhe objekti

1. Ky Kod ka për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet.

2. Në këtë Kod janë objekt i rregullimit:

a) caktimi i zonave zgjedhore;

b) afatet, procedura dhe kompetenca për regjistrimin e subjekteve zgjedhore;

c) organizimi dhe funksionimi i administratës dhe komisioneve zgjedhore;

ç) afatet, procedura dhe kompetencat për përgatitjen e listës së zgjedhjeve;

d) financimi i subjekteve zgjedhore;

dh) zhvillimi i fushatës zgjedhore;

e) procedura e votimit dhe shpalljes së rezultateve;

ë) shqyrtimi i ankimimeve dhe vendosja e sanksioneve administrative dhe penale;

f) rregulla të tjera në lidhje me zgjedhjet.

Neni 2*
Përkufizime

Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Data e zgjedhjeve” është data e votimit, e caktuar me dekret të Presidentit të Republikës.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

2. “Institucione të posaçme” janë burgjet, vendet e paraburgimit, si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë.

3. “Kandidat i paraqitur nga një grup zgjedhësish” është një kandidat për deputet ose për kryetar bashkie a komune, ose për këshillin e bashkisë a të komunës, që nuk mbështetet nga asnjë parti politike dhe që propozohet nga zgjedhësit, në përputhje me këtë Kod.

4. “Kandidat” është një shtetas shqiptar, i regjistruar si kandidat për deputet ose për kryetar bashkie a komune, ose për këshillin e bashkisë a të komunës, në përputhje me këtë Kod, për të cilin do të votohet në zgjedhje.

5. “Koalicion” është grupimi i dy apo më shumë partive politike për të konkurruar së bashku në zgjedhje, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod.

6. “KQV” është Komisioni i Qendrës së Votimit.

7. “KQZ” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod.

8. “KZAZ” është Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, që ngrihet dhe funksionon në përputhje më këtë Kod për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjet vendore.

9. “Listat e zgjedhësve” janë dokumente zyrtare të zgjedhësve, që burojnë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për çdo zonë të qendrës së votimit, të hartuara në përputhje me këtë Kod.

10. “Listë shumemërore” është lista e kandidatëve për deputetë ose për këshillat e bashkisë a komunës, e hartuar dhe e regjistruar në përputhje me këtë Kod.

11. “Marrëdhënie krushqie e afërt” është lidhja e krushqisë midis anëtarit të komisionit dhe kandidatit, ku njëri prej tyre është prind i bashkëshortit ose bashkëshortes së tjetrit apo motër ose vëlla i bashkëshortit ose bashkëshortes, apo bashkëshort i motrës së bashkëshortes ose të bashkëshortit apo bashkëshorte e vëllait të bashkëshortes ose të bashkëshortit.

12. “Parti parlamentare” është partia politike që ka fituar dhe zotëron të paktën një vend në Kuvend nga zgjedhjet pararendëse.

13. “Parti politike” është një parti e regjistruar në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”.

14. “Përfaqësues i subjektit zgjedhor” është një person i autorizuar i subjektit zgjedhor për të përfaqësuar interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve zgjedhore, në emër dhe për llogari të subjektit zgjedhor.

15. “Periudhë zgjedhore” është periudha e vitit, e përcaktuar në këtë Kod, gjatë së cilës zhvillohen zgjedhjet periodike të radhës për Kuvendin e Shqipërisë dhe organet e qeverisjes vendore.

15/1. “Provë” është mjeti ligjor që shërben për të provuar ekzistencën ose mosekzistencën e faktit të pretenduar në shqyrtimin administrativ dhe që merret në përputhje me këtë Kod.

16. “Qendër votimi” është mjedisi i caktuar për zhvillimin e votimit, në përputhje me këtë Kod.

17. “Regjistri Kombëtar Elektronik i Gjendjes Civile” është baza elektronike e të dhënave të shtetasve, i hartuar sipas dispozitave të ligjit për gjendjen civile.

18. “Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja, në përputhje më këtë Kod dhe që përfshin:

a) numrin e votave, numrin e mandateve dhe listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt në zonën zgjedhore, si dhe në shkallë vendi, në përputhje me rregullat e këtij Kodi;

b) rezultatin e votimit për kandidatët për kryetarë bashkie dhe komune, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në zonë zgjedhore përkatëse;

c) numrin e votave të fituar nga secili subjekt në shkallë kombëtare, bazuar në rezultatin e votave të fituara nga çdo subjekt zgjedhor në votimin për këshillat e qeverisjes vendore; dhe

ç) rezultatin e votimit për çdo alternativë në referendum, sipas dispozitave të këtij Kodi.

19. “Rishikimi i listave” është procesi i fshirjes ose i shtimit të emrave apo i ndryshimit të të dhënave në listat e zgjedhësve, në përputhje me këtë Kod.

20. “Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod.

21. Shfuqizuar

22. “Zgjedhje të pjesshme” janë votimet për të plotësuar vendin e kryetarit të bashkisë a të komunës, si dhe për zgjedhjen e një këshilli të ri vendor në rast shpërndarjeje.

23. “Zgjedhje” janë votimet për Kuvendin, për njësitë e qeverisjes vendore dhe referendumet.

24. “Zonë e qendrës së votimit” është një zonë gjeografike brenda territorit të një bashkie, komune ose zone zgjedhore, e përcaktuar në përputhje me këtë Kod.

25. “Zonë zgjedhore” është ndarja administrativo-territoriale e qarkut për zgjedhjet në Kuvend dhe bashkia apo komuna për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Zgjedhjet janë periodike.

2. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës.

3. Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.

4. Çdo zgjedhës ka të drejtën e vetëm një vote për zgjedhjen e një subjekti zgjedhor.

5. Subjektet zgjedhore janë të lira të bëjnë paraqitjen e programeve të tyre zgjedhore në çdo formë dhe mënyrë të ligjshme.

6. Komisionet zgjedhore, të parashikuara në këtë Kod, i përmbushin funksionet e tyre, në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme dhe transparente.

7. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj, ndalohet vënia në përdorim të subjekteve zgjedhore i mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme pronë publike, si dhe i burimeve njerëzore të administratës publike të çdo niveli.

8. Institucionet e administratës publike, të çdo niveli, me veprimtarinë e tyre nuk duhet të cenojnë zhvillimin e zgjedhjeve.

Neni 4

Emërimi dhe detyrat e nëpunësit ndërlidhës

1. Aparati i Këshillit të Ministrave dhe i Kryeministrisë, çdo ministri, zyra e prefektit dhe bashkitë janë të detyruara të caktojnë nëpunës ndërlidhës, përgjegjës për shkëmbimin e informacionit me KQZ-në, për veprimtaritë që kanë lidhje me administrimin ose zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike, jo më vonë se 24 orë pas caktimit të datës së zgjedhjeve.

2. Për emërimin e nëpunësit ndërlidhës i dërgohet njëkohësisht njoftim me shkrim KQZ-së, në të cilin përfshihet emri i nëpunësit, detyra ose titulli që mban, adresa e punës, si dhe numrat e telefonit dhe faksit. Në rast se ndonjëra nga këto institucione nuk cakton nëpunësin e vet ndërlidhës, në përputhje me kërkesat dhe brenda afatit të përcaktuar në këtë nen, atëherë titullari i institucionit përkatës konsiderohet se ka marrë përsipër funksionin e nëpunësit ndërlidhës.

3. Nëpunësi ndërlidhës ka për detyrë t'i paraqesë KQZ-së informacion të plotë me shkrim për urdhrat e titullarit për çdo veprimtari që mund të ndikojë ose dëmtojë administrimin ose zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente. Ky informacion i jepet me shkrim KQZ-së jo më vonë se 10 ditë përpara datës së përcaktuar për fillimin e veprimtarisë.

4. Nëpunësit ndërlidhës i jepet aksesi i informacionit në nivelet më të larta të institucionit të vet, me qëllim shkëmbimin e informacionit me KQZ-në.

5. Në rast se KQZ-ja vlerëson se veprimtaria e institucionit mund të dëmtojë ose të pengojë administrimin ose zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente, atëherë KQZ-ja informon me shkrim nëpunësin ndërlidhës të institucionit përkatës jo më vonë se 5 ditë përpara datës së përcaktuar për fillimin e veprimtarisë.

Neni 5

Ndalimi i përdorimit të forcave dhe strukturave të posaçme

1. Forcat komando dhe forcat e tjera të ushtrisë ndalohen që të përdoren gjatë gjithë fushatës zgjedhore, përveçse me urdhër me

shkrim të ministrit që mbulon rendin publik dhe Ministrit të Mbrojtjes, kur këto forca nevojiten për ruajtjen e objekteve të rëndësisë së veçantë, në zëvendësim të punonjësve të Policisë së Shtetit ose në zbatim të detyrimeve ndërkombëtare. Një kopje e urdhrit me shkrim i dërgohet menjëherë KQZ-së.

2. Ndalohet përdorimi i forcave komando dhe i forcave të tjera të ushtrisë për ruajtjen e objekteve që kanë lidhje me zgjedhjet.

3. Forcat e ushtrisë ndalohen të kryejnë ushtrime ose manovra ushtarake jashtë reparteve ose vendeve të dislokimit të tyre gjatë gjithë fushatës zgjedhore.

4. Në të gjitha llojet e zgjedhjeve ndalohet përdorimi ose pjesëmarrja e punonjësve apo strukturave të Shërbimit Informativ Shtetëror.

KREU II
VËZHGUESIT

Neni 6*
E drejta për të caktuar vëzhgues

1. Çdo parti politike apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit, i regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor, ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, në KQV dhe për çdo tavolinë në Vendin e Numërimit të Votave pas regjistrimit të kandidatit/kandidatëve për zonën zgjedhore përkatëse ose pasi ka paraqitur listë shumemërore. Në rast se partitë politike paraqiten në zgjedhje si koalicion, të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka vetëm koalicioni. Koalicioni mund të caktojë jo më shumë se tre përfaqësues për koalicion. Kandidatët e partive politike nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues.

2. Organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues në zgjedhje.

3. Shfuqizuar

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

4. Akreditimi i vëzhguesve pranë komisioneve zgjedhore bëhet mbi bazën e të dhënave vetjake të çdo vëzhguesi. Akreditimi mund të përfshijë një ose më shumë qendra votimi ose një apo më shumë zona zgjedhore. Një organizatë joqeveritare shqiptare apo koalicion i tillë, parti politike ose kandidat i propozuar nga zgjedhësit nuk mund të ketë në të njëjtën kohë më shumë se një vëzhgues të pranishëm në një qendër votimi. Çdo organizatë joqeveritare e huaj, si dhe organizatat ndërkombëtare nuk mund të kenë në të njëjtën kohë më shumë se dy vëzhgues të huaj në një qendër votimi. Në rast se partitë politike paraqiten në zgjedhje si koalicion, të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka vetëm koalicioni. Koalicioni mund të caktojë jo më shumë se tre përfaqësues për koalicion.

5. Kërkesat e vëzhguesve shqiptarë për akreditim i paraqiten KQZ-së jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve. KQZ-ja miraton kërkesat jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e tyre. Kërkesat e vëzhguesve të huaj paraqiten në KQZ jo më vonë se 72 orë para datës së zgjedhjeve. KQZ-ja miraton kërkesat e vëzhguesve të huaj brenda 24 orëve nga paraqitja e tyre. Ndaj refuzimit ose mosdhënies së akreditimit mund të bëhet ankim, sipas procedurave të këtij Kodi.

6. KQZ-ja ka të drejtë, me udhëzim të veçantë, t'u delegojë KZAZ-ve kompetencën e akreditimit të vëzhguesve, sipas pikave 1 dhe 3 të këtij neni.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve

1. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë këto të drejta:

a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;

b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;

c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor;

ç) të drejta të tjera të përcaktuara në këtë Kod apo në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Vëzhguesit kanë këto detyra:

a) të respektojnë kërkesat e këtij Kodi dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve;

b) të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti apo koalicion në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas këtij Kodi;

c) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja, si dhe me një dokument identifikimi të pranuar nga KQZ-ja;

ç) të mos mbajnë shenja dalluese, që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit;

d) të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit, të numërimit dhe administrimit të zgjedhjeve.

KREU III
PERIUDHA ZGJEDHORE DHE DATA E MBAJTJES SË ZGJEDHJEVE

Neni 8
Periudha zgjedhore

Zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin apo për njësitë e qeverisjes vendore zhvillohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit brenda periudhës që shtrihet nga 15 marsi deri më 30 qershor ose nga 15 shtatori deri më 30 nëntor. Bëjnë përjashtim nga ky rregull rastet e parashikuara në pikat 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 9 të këtij Kodi.

Neni 9
Caktimi i datës së zgjedhjeve për Kuvendin

1. Data e zgjedhjeve për Kuvendin caktohet me dekret nga Presidenti i Republikës, sipas rregullave të parashikuara në nenin 65 të Kushtetutës. Zgjedhjet për Kuvendin zhvillohen në një nga dy të dielat e fundit, brenda periudhës zgjedhore të përcaktuar në nenin 8 të këtij Kodi dhe në çdo rast jo më vonë se 30 ditë para datës së mbarimit të mandatit të Kuvendit. Në rast se mandati i Kuvendit përfundon më herët se 30 ditë nga fillimi i periudhës zgjedhore, zgjedhjet zhvillohen në periudhën zgjedhore pararendëse. Për efekt të këtij Kodi, mandati i Kuvendit mbaron në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt pas datës së mbledhjes së parë të tij.

2. Presidenti i Republikës nxjerr dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin jo më vonë se 9 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit. Me vendim të Kuvendit, mbyllja e legjislaturës ose shpërndarja e tij bëhen jo më shpejt se 45 ditë para datës së caktuar për zgjedhjet dhe jo më vonë se 30 ditë para kësaj date.

3. Në zbatim të pikës 5 të nenit 87 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës nxjerr dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve jo më vonë se 24 orë pas shpërndarjes së Kuvendit. Zgjedhjet zhvillohen jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit. Datë e shpërndarjes së Kuvendit është data e votimit të pestë, sipas pikës 5 të nenit 87 të Kushtetutës, kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Presidentin e ri.

4. Në zbatim të pikës 4 të nenit 96 të Kushtetutës, kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, jo më vonë se 24 orë pas votimit të parashikuar në pikën 3 të po atij neni, Presidenti i Republikës dekreton shpërndarjen e Kuvendit dhe cakton datën e zgjedhjeve. Zgjedhjet zhvillohen jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit.

5. Në zbatim të pikës 2 të nenit 104 të Kushtetutës zgjedhjet zhvillohen jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit.

6. Kur për shkaqe të tjera nga ato të përmendura në pikat 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni Kuvendi vetëshpërndahet, atëherë Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve jo më vonë se 24 orë pas shpërndarjes së tij. Kuvendi shpërndahet në ditën e votimit të tij për vetëshpërndarje. Zgjedhjet zhvillohen jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit.

Neni 10
Caktimi i datës së zgjedhjeve
për organet e qeverisjes vendore

1. Data e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore caktohet me dekret nga Presidenti i Republikës. Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, Presidenti zbaton rregullat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 9 të këtij Kodi.

2. Për efekt të këtij Kodi, mandati i organeve të qeverisjes vendore mbaron në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt

pas datës së shpalljes me vendim të KQZ-së në shkallë vendi të rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

3. Në rast të ndërprerjes së mandatit, për shkaqet e parashikuara në nenin 115 të Kushtetutës, zgjedhjet mbahen jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë nga data e njoftimit të ndërprerjes së mandatit. Në rast ankimi të organit të shpërndarë ose të shkarkuar, zgjedhjet zhvillohen jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë nga mbarimi i afatit që ka organi i shpërndarë për të ankimuar vendimin e Këshillit të Ministrave në Gjykatën Kushtetuese, kur kjo e drejtë nuk është ushtruar, ose data e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në rast se është ankuar në këtë gjykatë brenda afatit të nenit 115 pika 2 të Kushtetutës. Në çdo rast, Presidenti i Republikës nxjerr dekretin jo më vonë se 48 orë nga njoftimi për ndërprerjen e mandatit.

Neni 11

Orari i votimit

1. Kur data e zgjedhjeve caktohet ndërmjet 31 marsit dhe 15 tetorit, qendrat e votimit hapen në orën 7^{00} dhe mbyllen në orën 19^{00}.

2. Kur data e zgjedhjeve caktohet ndërmjet 16 tetorit dhe 30 marsit, qendrat e votimit hapen në orën 7^{00} dhe mbyllen në orën 18^{00}.

3. Askush nuk mund të votojë pas orës së mbylljes së qendrave të votimit, me përjashtim të zgjedhësve që presin për të votuar në kohën e mbylljes, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod.

PJESA II
INSTITUCIONET PËR PËRGATITJEN DHE ADMINISTRIMIN E ZGJEDHJEVE

KREU I
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)

Neni 12*
Përbërja e KQZ-së

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga 7 anëtarë.

2. Anëtar i KQZ-së mund të emërohet çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili përmbush këto kritere:

a) të jetë me moshë mbi 35 vjeç;

b) të jetë me arsim të lartë;

c) të ketë përvojë profesionale prej jo më pak se 10 vjet punë, të paktën në një nga fushat e mëposhtme:

i) në fushën e së drejtës;

ii) në administratën publike;

iii) në administrimin e zgjedhjeve;

iv) si drejtues i organizatave jofitimprurëse, të cilat kanë objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen dhe zhvillimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, zhvillimin e zgjedhjeve demokratike apo politikat publike;

ç) të mos jetë i dënuar penalisht;

d) të mos ketë qenë anëtar i ndonjë partie politike në 5 vitet e fundit;

dh) të mos ketë qenë i zgjedhur deputet i Kuvendit në 5 vitet e fundit;

e) të mos ketë qenë pjesëtar në 5 vitet e fundit në Policinë e Shtetit, në Forcat e Armatosura dhe në Shërbimin Informativ Shtetëror;

ë) të mos jetë larguar nga administrata publike apo çdo funksion publik për shkelje të detyrës.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Neni 13*

Mandati dhe koha e punës e anëtarëve të KQZ-së

1. Anëtari i KQZ-së ka mandat 6-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Kryetari i KQZ-së ka mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Fillimi dhe mbarimi i mandatit të anëtarit të KQZ-së përcaktohet në këtë Kod.

3. Anëtari i KQZ-së e ushtron këtë detyrë me kohë të plotë. Funksioni i tij është i papajtueshëm me çdo detyrë ose funksion tjetër politik, publik ose privat, me përjashtim të mësimdhënies.

4. Përpara fillimit të detyrës, anëtari i zgjedhur i KQZ-së kryen betimin para Kuvendit, në një ceremoni publike. Teksti i betimit është: **"Betohem në nderin tim se do të angazhohem me të gjitha forcat e mia për realizimin e zgjedhjeve të drejta, të lira dhe demokratike në Republikën e Shqipërisë, do të siguroj dhe do të mbroj integritetin dhe fshehtësinë e votës, do të ruaj paanësinë në kryerjen e detyrës si anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe do të tregoj profesionalizëm në kryerjen e saj".**

Neni 14

Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së

1. Kuvendi i Shqipërisë zgjedh anëtarët e KQZ-së sipas kësaj procedure:

a) 2 anëtarë propozohen nga partia që ka numrin më të madh të vendeve nga partitë e shumicës parlamentare dhe 2 anëtarë nga partia e opozitës parlamentare që ka numrin më të madh të vendeve në Kuvendin e Shqipërisë;

b) subjektet propozuese, në fazën e përzgjedhjes, paraqesin jo më pak se dy kandidatura për secilën vakancë. Kryetarët e grupeve parlamentare të subjekteve propozuese përzgjedhin kolegjialisht 4 kandidatura, në përputhje me kriteret e parashikuara në shkronjën "a" të kësaj pike. Subjektet propozuese të shkronjës "a" përzgjedhin një kandidaturë nga secila gjini;

c) kandidaturat e përzgjedhura sipas shkronjës "b" të kësaj pike i paraqiten Kuvendit për miratim;

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

ç) anëtari i pestë i KQZ-së zgjidhet nga kandidatura të propozuara nga grupime deputetësh të partive të shumicës parlamentare, përjashtuar partinë më të madhe të grupimit të shumicës. Anëtari i gjashtë i KQZ-së zgjidhet nga kandidatura të propozuara nga grupime deputetësh të partive të opozitës parlamentare, përjashtuar partinë më të madhe të opozitës. Grupimi propozues paraqet një listë me jo më pak se dy kandidatura për vakancën përkatëse.

Kuvendit i paraqitet për votim lista e kandidatëve që ka siguruar numrin më të madh të nënshkrimeve mbështetëse të deputetëve të grupeve respektive parlamentare të shumicës dhe opozitës parlamentare, përfshirë edhe deputetët e dy partive më të mëdha të secilit grupim. Në rast se dy apo më shumë lista sigurojnë numër të njëjtë nënshkrimesh mbështetëse, të gjitha kandidaturat e përfshira në këto lista futen në votim.

2. Votimi për zgjedhjen e anëtarëve të KQZ-së, sipas këtij neni, zhvillohet në një ditë të vetme.

Neni 15*

Zgjedhja e Kryetarit të KQZ-së

1. Anëtari i shtatë dhe njëkohësisht Kryetar i KQZ-së zgjidhet jo më vonë se 10 ditë pasi të ketë përfunduar procedura e zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së, sipas nenit 14 të këtij Kodi.

2. Jo më vonë se 30 ditë para datës së mbarimit të mandatit të Kryetarit të KQZ-së, Kuvendi i Shqipërisë publikon shpalljen për vendin vakant të Kryetarit të KQZ-së. Çdo shtetas që plotëson kushtet e nenit 12 të këtij Kodi mund të paraqitet si kandidat për Kryetar të KQZ-së. Kërkesa paraqitet e shoqëruar me dokumentacionin përkatës që provon përmbushjen e kritereve ligjore për anëtar të KQZ-së.

3. Lista e kandidatëve i kalon komisionit të Kuvendit që mbulon çështjet ligjore për të verifikuar përmbushjen e kritereve ligjore. Në këtë listë nuk mund të përfshihen ose, nëse janë përfshirë, përjashtohen kandidatët e propozuar sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 14 të këtij Kodi. Komisioni i shqyrton kandidaturat në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Pas verifikimit të kritereve zbatohet procedura si më poshtë:

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

a) komisioni përzgjedh për t'u paraqitur për votim Kuvendit dy kandidatët që gëzojnë mbështetjen më të madhe të anëtarëve të komisionit, por jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij. Kur shumicën e cilësuar e gëzojnë më shumë se dy kandidatë, në votim paraqiten dy kandidatët që gëzojnë mbështetjen më të madhe. Çdo anëtar i komisionit mund të mbështesë deri në katër kandidatë;

b) nëse shumicën e cilësuar sipas shkronjës "a" nuk e gëzojnë së paku dy kandidatë, komisioni identifikon katër kandidatët që kanë marrë mbështetjen më të madhe midis anëtarëve të komisionit pas zbatimit të shkronjës "a";

c) kur gjatë zbatimit të shkronjave "a" dhe "b" dy apo më shumë kandidatë gëzojnë të njëjtën mbështetje, përzgjedhja e tyre bëhet me short;

ç) përfaqësuesit e pakicës parlamentare në komision përjashtojnë dy nga kandidatët e përzgjedhur sipas shkronjës "b". Kandidatët e mbetur i kalojnë Kuvendit për votim;

d) Kryetar i KQZ-së zgjidhet kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të deputetëve të Kuvendit.

Neni 16

Zëvendëskryetari i KQZ-së

1. KQZ-ja zgjedh si Zëvendëskryetar një nga anëtarët e KQZ-së, të zgjedhur mbi bazën e propozimit të partisë më të madhe të opozitës parlamentare, sipas pikës 1 shkronja "a" të nenit 14 të këtij Kodi.

2. Zgjedhja zhvillohet me votim të fshehtë, sipas procedurës së mëposhtme:

a) në një fletë votimi shkruhen emrat e dy anëtarëve të KQZ-së, sipas pikës 1 të këtij neni;

b) secili prej anëtarëve voton, duke bërë shënimin përkatës, për një nga emrat që janë në fletëvotim;

c) anëtari që ka marrë 5 vota zgjidhet Zëvendëskryetar i KQZ-së;

ç) në rast se asnjë prej kandidatëve nuk ka marrë numrin e kërkuar të votave, bëhet një raund i dytë votimi. Anëtari që merr më shumë vota në raundin e dytë zgjidhet Zëvendëskryetar i KQZ-së. Votimi zhvillohet brenda së njëjtës ditë.

3. Zëvendëskryetari zgjidhet deri në fund të mandatit.

4. Mbledhja për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit, kur mungon Kryetari, drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë i KQZ-së dhe procedura e zgjedhjes zhvillohet në prani të një noteri.

Neni 17*

Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të KQZ-së

1. Paga dhe privilegjet e anëtarit të KQZ-së janë të njëjta me pagën dhe privilegjet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Paga e Kryetarit të KQZ-së është 10 për qind më e lartë se paga e anëtarit. Paga e Zëvendëskryetarit të KQZ-së është 5 për qind më e lartë se paga e anëtarit.

2. Anëtari i KQZ-së ushtron funksionin në mënyrë të pavarur. Ai voton në përputhje me ligjin.

3. Anëtari i KQZ-së nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe votimin e një çështjeje kur:

a) ka marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjë nga kandidatët që kanë paraqitur ankim në KQZ; ose

b) ka një nga pengesat e parashikuara në nenin 37 të Kodit të Procedurave Administrative.

4. Tërheqja nga shqyrtimi dhe votimi i çështjes deklarohet me shkrim nga anëtari i KQZ-së, ose mund të kërkohet nga çdo përfaqësues i subjekteve zgjedhore apo nga anëtarët e tjerë të KQZ-së. Tërheqja nga shqyrtimi dhe votimi i çështjes ose vendimi i KQZ-së për përjashtimin e anëtarit nga shqyrtimi dhe rezultati i votimit regjistrohet në procesverbal.

5. Pas mbarimit të funksionit, anëtari i KQZ-së rikthehet në funksionin publik të mëparshëm dhe kur kjo nuk është e mundur, në një vend të njëjtit nivel në organet e administratës publike.

Neni 18

Ndërprerja para kohe e mandatit të anëtarit të KQZ-së

1. Mandati i anëtarit dhe Kryetarit të KQZ-së përfundon përpara afatit kur:

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

a) kryen veprimtari politike, njëkohësisht me detyrën e anëtarit të KQZ-së;

b) mbush moshën për pension;

c) vdes;

ç) jep dorëheqjen nga detyra;

d) dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

dh) me veprim ose mosveprim cenon rëndë veprimtarinë e KQZ-së për përgatitjen, mbikëqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e të gjitha aspekteve që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe referendumet, si dhe me shpalljen e rezultateve të tyre;

e) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në dy mbledhje radhazi të KQZ-së, ose në periudhë zgjedhore për më shumë se 5 ditë.

2. Shkarkimi i anëtarit të KQZ-së bëhet me vendim të Kuvendit, pas propozimit të KQZ-së për shkaqe të parashikuara në shkronjat "a", "d", "dh" dhe "e" të pikës 1 të këtij neni. KQZ-ja është e detyruar të fillojë procedurën për propozimin e shkarkimit jo më vonë se 5 ditë nga marrja dijeni për shkakun. Në rastet e tjera të pikës 1 të këtij neni, anëtari i KQZ-së lirohet me vendim të Kuvendit pas njoftimit nga ana e KQZ-së.

Neni 19*

Zëvendësimi i anëtarëve të KQZ-së

1. Anëtarët e rinj të KQZ-së zgjidhen jo më vonë se 30 ditë para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve që largohen. Anëtarët e rinj fillojnë detyrën ditën e nesërme pas përfundimit të mandatit të anëtarit që largohet ose pas bërjes së betimit në rastin e përfundimit të parakohshëm të mandatit.

2. Në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të KQZ-së, Kuvendi emëron një anëtar zëvendësues brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vakancës nga KQZ-ja, sipas shkronjave "b", "c" dhe "ç" të pikës 1 të nenit 18 të këtij Kodi ose nga çasti i shkarkimit. Të drejtën për propozimin e kandidaturave e ka i njëjti subjekt politik që kishte propozuar anëtarin që i kishte mbaruar mandati, nëse subjekti i plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 1

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

të nenit 14 të këtij Kodi. Në të kundërt, kandidaturat propozohen nga partia politike, e cila i plotëson kriteret e renditjes dhe përkatësisë. Në rastin e zëvendësimit të Kryetarit, zhvillohet e njëjta procedurë votimi, sipas nenit 15 të këtij Kodi.

3. Në rast se mandati i një anëtari të KQZ-së përfundon para kohe gjatë periudhës së zgjedhjeve, ai zëvendësohet nga Kuvendi sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë nga krijimi i vakancës.

4. Anëtari zëvendësues qëndron në detyrë deri në mbarimin e afatit të mandatit ligjor që gëzonte, sipas aktit të zgjedhjes, anëtari i larguar para kohe.

5. Shfuqizuar

Neni 20

Kompetencat e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të KQZ-së

1. Kryetari i KQZ-së ka këto kompetenca:

a) drejton mbledhjet e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhënie me institucionet e tjera;

b) kryen funksionet e drejtuesit administrativ të institucionit. Në zbatim të kompetencave, sipas kësaj shkronje, Kryetari i KQZ-së nxjerr urdhra të brendshëm vetëm në bazë dhe për zbatim të vendimeve të KQZ-së.

2. Zëvendëskryetari i KQZ-së kryen detyrat e Kryetarit në mungesë të tij.

3. Kryetari i ushtron kompetencat në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni së bashku me Zëvendëskryetarin. Të gjitha aktet e nxjerra në bazë të shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni nënshkruhen edhe nga Zëvendëskryetari, përndryshe janë të pavlefshme. Bëjnë përjashtim rastet kur Kryetari ose Zëvendëskryetari nuk ushtrojnë funksionet për arsye objektive.

Neni 21*

Kompetencat e KQZ-së

KQZ-ja ka këto kompetenca:

1. Nxjerr, në bazë dhe për zbatim të ligjit dhe brenda sferës së juridiksionit të saj, vendime dhe udhëzime me fuqi juridike të përgjithshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Merr vendime për njësimin e praktikave zgjedhore.
3. Drejton dhe kontrollon kolegjialisht, nëpërmjet çdo anëtari ose strukturave të saj, procesin parazgjedhor dhe atë zgjedhor.
4. Miraton kufijtë e zonave të administrimit zgjedhor, në përputhje me këtë Kod.
5. Propozon ndarjen e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet në Kuvend.
6. Regjistron pjesëmarrjen në zgjedhje të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet në Kuvend, në përputhje me procedurat e këtij Kodi.
7. Shpall me vendim rezultatin e zgjedhjeve për çdo zonë zgjedhore, kandidatët fitues për zgjedhjet në Kuvend, kandidatë fitues për anëtarët e këshillave për organet e qeverisjes vendore.
8. Shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi, në përputhje me këtë Kod.
9. Kryen, me shpenzimet e veta, kurse trajnimi jo më vonë se 30 ditë pas emërimit të anëtarëve të KZAZ-ve dhe në përfundim të tyre, pas kryerjes së testimeve, u jep atyre dëshminë përkatëse. Për anëtarët e KQV-ve kryen, me shpenzimet e veta, sesione kualifikimi për legjislacionin zgjedhor. KQZ-ja merr masa dhe organizon edhe programe për edukimin zgjedhor të shtetasve.
10. Kryen trajnime për administrimin zgjedhor jashtë periudhës zgjedhore dhe në mënyrë periodike për të gjithë të interesuarit dhe shpërndan dëshmitë përkatëse. Trajnimet mund të jenë të përgjithshme dhe të specializuara për funksione të veçanta të administrimit të zgjedhjeve.
11. Emëron dhe shkarkon, në përputhje me këtë Kod, anëtarët e KZAZ-së dhe i mbikëqyr ata në përmbushjen e detyrave të tyre.
12. Boton buletinin e zgjedhjeve, i cili përmban rezultatet e zgjedhjeve për çdo zonë zgjedhore dhe qendër votimi, raportin për

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

shpenzimet zgjedhore, si dhe publikon raportet, sipas nenit 91 të këtij Kodi.

13. Paraqet në Kuvend, brenda muajit shkurt të çdo viti, raportin vjetor për veprimtarinë e vitit të kaluar.

14. Përgatit projektbuxhetin vjetor, sipas ligjit përkatës, për funksionimin e institucionit dhe, pas miratimit me ligj të buxhetit, përcakton strukturën e shpenzimeve buxhetore.

15. Ushtron kontrollin mbi financimet e fushatës zgjedhore, në përputhje me këtë Kod.

16. Përgatit projektbuxhetin për zgjedhjet e pritshme dhe administron fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme në shërbim të zgjedhjeve, duke marrë vendim për strukturën e shpenzimeve buxhetore dhe donacioneve të ndryshme për zgjedhjet.

17. Shqyrton dhe zgjidh ankesat e subjekteve zgjedhore për zhvillimin e procesit zgjedhor, në përputhje me rregullat e këtij Kodi.

18. Harton dhe shpërndan modelet për ankimet zgjedhore, në përputhje me rregullat e këtij Kodi.

19. Cakton masën e shpërblimit për anëtarët e KZAZ-ve, KQV-ve dhe anëtarët e grupeve të numërimit.

20. Vendos sanksione administrative kundër personave, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet, si dhe bën kallëzim penal për vepra penale në lidhje me zgjedhjet.

21. Miraton strukturën, organikën dhe strukturën e pagave të administratës së KQZ-së me kohë të plotë pune dhe asaj me kohë jo të plotë.

22. Ngre zyra rajonale të përhershme apo të përkohshme, me qëllim zbatimin e detyrave që burojnë nga ky Kod dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

23. Mban dhe përditëson regjistrin e administratës zgjedhore, ku përfshihen trajnimet dhe masat disiplinore të marra ndaj tyre.

24. Emëron, në përputhje me procedurat e këtij Kodi, Sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së.

25. Miraton Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të KQZ-së, duke përfshirë edhe mënyrën e zhvillimit të mbledhjeve.

26. Kryen detyra të tjera, që burojnë nga ky Kod ose nga ligje të tjera dhe që sipas këtij Kodi nuk kryhen nga komisionet e niveleve më të ulëta.

Neni 21/1*

Kompetencë e posaçme e KQZ-së

1. KQZ-ja ka të drejtë të miratojë rregulla të posaçme lidhur me procedurat e votimit dhe të numërimit të votave kur vendos zbatimin e teknologjisë së informacionit për identifikimin e zgjedhësve, votimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultatit zgjedhor.

2. Vendimi i KQZ-së për përdorimin e teknologjisë së informacionit në identifikimin e zgjedhësve, votimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultatit zgjedhor, sipas pikës 1 të këtij neni, miratohet me votën "pro" të jo më pak se 5 anëtarëve të KQZ-së.

3. Vendimi duhet të përcaktojë Planin e Veprimit për zbatimin e teknologjisë në zgjedhje, të detajuar në faza dhe afate të përcaktuara. Në çdo rast zbatimi i teknologjisë së informacionit në zgjedhje në të gjithë vendin fillon nëpërmjet një projekti pilot, si rregull në 20 për qind të zgjedhësve, dhe shtrihet në të gjithë territorin dy vjet nga fillimi i Planit të Veprimit.

Neni 21/2*

Rregulla procedurale për zbatimin e teknologjisë së informacionit në fushën e zgjedhjeve

1. Për zbatimin e teknologjive të reja të informacionit në identifikimin e zgjedhësve, votimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultatit zgjedhor, deri në shtrirjen e tyre në të gjithë territorin e vendit, KQZ-ja përcakton me vendim të miratuar me jo më pak se 5 vota "pro" rregulla të posaçme për përdorimin e tyre.

2. Rregullat përfshijnë teknologjinë, personelin administrues, marrëdhëniet me administratën zgjedhore, të drejtat dhe detyrimet respektive, administrimin e të dhënave që sigurohen nga përdorimi i teknologjisë dhe efektet ligjore të tyre, mbrojtjen e të dhënave personale, testimin *a priori* dhe verifikimin *a posteriori* të teknologjisë, si dhe përshtatjen e procedurave të identifikimit, votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit, me qëllim optimizimin e procesit.

3. Në rastet e defekteve teknike që cenojnë integritetin e teknologjisë që aplikohet apo që e bëjnë zbatimin e tyre të pamundur në zgjedhje, KQZ-ja mund të vendosë zbatimin e votimit

* Shtuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

ose numërimit me dorë, sipas këtij Kodi. Defektet serioze dhe të pariparueshme duhet të konfirmohen nga raporti i testimeve *a priori* nga auditë të specializuar, sipas pikës 2 të këtij neni. Vendimi për numërimin me dorë miratohet me votën "pro" të jo më pak se 4 anëtarëve të KQZ-së. Efektet juridike të vendimit të KQZ-së për përdorimin e teknologjisë, të miratuar me jo më pak se 5 vota "pro", pushojnë së ekzistuari sapo merret vendimi për numërimin me dorë, sipas këtij Kodi.

Neni 22
Mbledhjet e KQZ-së

1. Mbledhjet e KQZ-së thirren nga Kryetari ose të paktën nga dy anëtarë të KQZ-së. Në çdo rast, thirrja e mbledhjes nuk i nënshtrohet votimit dhe duhet të përmbajë rendin e ditës të mbledhjes. Në rendin e ditës përfshihet çdo kërkesë e ardhur nga të paktën dy anëtarë të KQZ-së.

2. Gjatë periudhës nga caktimi i datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, KQZ-ja mblidhet rregullisht çdo ditë, ndërsa në periudhën tjetër të vitit të paktën një herë në muaj. Mbledhjet e KQZ-së mbyllen me caktimin e rendit të ditës për mbledhjen pasardhëse.

3. Njoftimi për mbledhjen, së bashku me rendin e ditës, shpallet publikisht në hyrje të selisë së KQZ-së dhe pranë selive të KZAZ-ve të interesuara për çështjen, të paktën 24 orë para orës së caktuar për fillimin e mbledhjes. Njoftimi për mbledhjen u dërgohet të gjitha partive parlamentare, si dhe publikohet në faqen e internetit të KQZ-së.

4. Në fillim të çdo mbledhjeje çdo subjekt zgjedhor i regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhje ose persona të tjerë të interesuar, vetëm një herë dhe për një kohë jo më të gjatë se 5 minuta kanë të drejtë të flasin për çështje që nuk janë përfshirë në rendin e ditës.

5. Mbledhjet e KQZ-së janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë të saj, me përjashtim të rasteve kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimit, sipas nenit 24 të këtij Kodi.

6. Çdo mbledhje e KQZ-së fillon sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të këtij neni. Në mbledhjet e KQZ-së kanë të drejtë të diskutojnë

dhe të japin mendime vetëm anëtarët e KQZ-së, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, sipas nenit 26 të këtij Kodi, si edhe personat që lidhen me përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve. Në fillim të çdo mbledhjeje KQZ-ja përcakton me vendim kohën për të folur për çdo të interesuar.

7. Mbledhjet e KQZ-së janë kurdoherë publike.

Neni 23

Aktet e KQZ-së dhe hyrja në fuqi e tyre

1. KQZ-ja, në bazë dhe për zbatim të ligjit, mund të nxjerrë vetëm këto akte:

a) vendime;

b) udhëzime.

2. Aktet me karakter normativ të KQZ-së kanë fuqi mbi të gjithë territorin e vendit dhe janë të detyrueshme për të gjithë.

3. Çdo akt normativ i KQZ-së votohet tri herë, sipas radhës së mëposhtme:

a) votohet në parim;

b) votohet nen për nen ose, sipas rastit, pjesë për pjesë;

c) në fund votohet në tërësi.

4. Aktet normative të KQZ-së kanë karakter të përhershëm dhe zbatohen si rregull për të gjitha zgjedhjet. Këto akte rishikohen në rast të ndryshimit të ligjit apo për shkaqe të tjera që përligjin ndryshimin e tyre. Aktet për përgatitjen e zgjedhjeve si rregull miratohen apo ndryshohen jo më vonë se 60 ditë nga data e zgjedhjeve.

5. Aktet normative të KQZ-së hyjnë në fuqi pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare, përveç rasteve kur rrethanat diktojnë hyrjen e menjëhershme në fuqi, ndërsa aktet e tjera hyjnë në fuqi menjëherë. Aktet normative me fuqi të menjëhershme publikohen jo më vonë se 24 orë në radiotelevizionin publik, si dhe në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së.

Neni 24

Vendimmarrja në KQZ

1. Konsiderohen të miratuara, kur votojnë “pro” jo më pak se 5 anëtarë të KQZ-së, vendimet lidhur me:

a) shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas neneve 162, 163 dhe 166, pika 3 të këtij Kodi;

b) pranimin e ankimit kundër vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve të zonës zgjedhore, sipas nenit 123 të këtij Kodi dhe vendimet lidhur me ankimet kundër vendimeve të KZAZ-ve për rezultatin e zgjedhjeve për qeverisjen vendore;

c) kërkesat për deklarimin e pavlefshëm të zgjedhjeve në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi;

ç) shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore apo në të gjithë vendin dhe përsëritjen e tyre;

d) aktet me karakter normativ dhe që kanë për qëllim rregullimin e çështjeve që lidhen me zgjedhjet;

dh) propozimin për shkarkimin e anëtarit të KQZ-së, sipas pikës 2 të nenit 18 të këtij Kodi;

e) miratimin e strukturës organike të KQZ-së, si dhe rregulloren e funksionimit të KQZ-së;

ë) caktimin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas nenit 76 të Kodit;

f) caktimin e zonave të administrimit zgjedhor, sipas nenit 27 të Kodit.

Vendimet e tjera miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQZ-së.

2. Vendimet e KQZ-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve të KQZ-së, përbri nënshkrimit të tij, shënon me shkrim mënyrën e tij të votimit, sipas rastit “pro” ose “kundër”. Anëtarët në pakicë duhet të paraqesin mendimin e tyre të pakicës ose atë alternativ jo më vonë se 24 orë nga marrja e vendimit. Mendimi i pakicës i bashkëngjitet vendimit përkatës.

3. Çdo vendim i KQZ-së zbardhet brenda 24 orëve nga marrja e tij. Jo më pak se dy ekzemplarë origjinalë të vendimit ose, sipas rastit, edhe të udhëzimit të KQZ-së, mbahen në arkivin e KQZ-së. Vendimet publikohen menjëherë në faqen zyrtare të KQZ-së.

4. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, gjatë periudhës zgjedhore, jep, kundrejt kërkesës të çdo subjekti zgjedhor, pa pagesë, brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KQZ-së. Jashtë periudhës zgjedhore, si dhe për çdo person tjetër

të interesuar kopjet e akteve të KQZ-së jepen kundrejt një pagese, sipas akteve përkatëse në fuqi.

Neni 25

Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e KQZ-së

1. Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave që burojnë nga ky Kod, KQZ-ja ka administratën e vet, të përbërë me nëpunës të shërbimit civil. Procedurat e rekrutimit, transferimit, ngritjes në detyrë, lëvizjes paralele dhe shkarkimit nga detyra bëhen në përputhje me përcaktimet e bëra për institucionet e pavarura në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

2. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së është nëpunësi më i lartë civil i administratës së KQZ-së dhe emërohet në përputhje me procedurat e ligjit për statusin e nëpunësit civil. Në çdo rast KQZ-ja është e detyruar të emërojë një nga tre fituesit e konkursit për rekrutimin e Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në nenin 12 të këtij Kodi dhe të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e së drejtës ose të administratës publike.

4. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së kryen këto detyra:

a) merr masa për organizimin e mbledhjeve të KQZ-së, përgatit materialet e mbledhjes, si dhe bën njoftimet përkatëse;

b) merr masa për botimin e akteve të KQZ-së dhe bërjen publike të tyre;

c) merr masa për plotësimin e kushteve të punës së anëtarëve të KQZ-së, sipas kërkesave të tyre, në zbatim të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja;

ç) është përgjegjës, drejton dhe organizon punën për zbatimin e vendimeve të KQZ-së apo urdhrave të Kryetarit, sipas nenit 20 të këtij Kodi;

d) ndjek zbatimin e buxhetit dhe merr masat përkatëse për të;

dh) propozon për miratim në KQZ Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Administratës së KQZ-së; dhe

e) kryen detyra të tjera të përcaktuara nga ky Kod.

Neni 26

Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ

1. Çdo parti politike ose koalicion partish politike, nëpërmjet drejtuesit më të lartë të saj, mund të caktojë me autorizim një përfaqësues dhe një zëvendës të tij pranë KQZ-së.

2. Përfaqësuesit e partive parlamentare që kanë marrë pjesë në zgjedhje janë me status të përhershëm pranë KQZ-së. Ata kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet që zhvillon KQZ-ja. Përfaqësuesit e partive joparlamentare apo të partive të krijuara rishtazi gjatë legjislaturës kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm në mbledhjet e KQZ-së të zhvilluara në periudhë zgjedhore.

3. Përfaqësuesit e partive në KQZ nuk kanë të drejtë vote. Ata, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod, si dhe në akte të tjera, kanë këto të drejta:

a) të marrin fjalën dhe të diskutojnë në mbledhje të KQZ-së;

b) të paraqesin kërkesa dhe propozime pranë KQZ-së;

c) të marrin kopje të akteve të KQZ-së;

ç) të njihen dhe të marrin kopje të dokumentacionit zgjedhor, të miratuar nga KQZ-ja;

d) të njihen dhe të marrin informacion për të gjitha aspektet e procesit zgjedhor, pa cenuar veprimtarinë e KQZ-së apo edhe të strukturave të tjera zgjedhore.

4. Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesit të partive parlamentare apo joparlamentare konsiderohen sikur të jenë kryer nga vetë partitë përkatëse në cilësinë e tyre si subjekte zgjedhore.

5. Përfaqësuesit janë të detyruar të respektojnë rregulloren e KQZ-së, si dhe etikën e mbledhjeve dhe të komunikimit. Në rast të thyerjes së tyre merren masat e parashikuara në rregulloren e brendshme të KQZ-së.

KREU II
ZONAT E ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR (ZAZ) DHE KOMISIONET E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR (KZAZ)

Neni 27*
Zonat e Administrimit Zgjedhor

1. Zonat e Administrimit Zgjedhor ngrihen dhe funksionojnë për çdo lloj zgjedhjeje dhe referendumi, sipas këtij Kodi.

2. Juridiksioni territorial i ZAZ-ve si rregull është i njëjtë me rrethin administrativ, sipas ligjit që rregullon organizimin territorial të Republikës së Shqipërisë. Rrethet që kanë më shumë se 60 mijë shtetas me të drejtë vote ndahen nga KQZ-ja në më shumë se sa një Zonë e Administrimit Zgjedhor, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) pandashmëria e territorit të komunës dhe bashkisë;

b) vazhdimësia dhe kompaktësia e territorit, duke shmangur barrierat gjeografike;

c) mundësi të mira komunikimi brenda territorit;

ç) numër i përafërt zgjedhësish.

3. Asnjë Zonë Administrimi Zgjedhor nuk mund të shtrihet gjeografikisht në dy ose më shumë qarqe apo rrethe të ndryshme brenda të njëjtit qark.

4. Bashkitë me më shumë se 30 mijë shtetas me të drejtë vote përbëjnë zonë administrimi zgjedhor më vete, kur numri i përgjithshëm i shtetasve me të drejtë vote në shkallë rrethi është më i madh se 60 mijë.

Në bashkitë që kanë mbi 80 mijë shtetas me të drejtë vote KQZ-ja mund të krijojë dy apo më shumë zona administrimi zgjedhor më vete, me numër të barabartë zgjedhësish, si dhe duke ruajtur vazhdimësinë dhe kompaktësinë e territorit të zonave të qendrave të votimit. Për Bashkinë e Tiranës, secila nga njësitë bashkiake përbën zonë administrimi zgjedhor më vete.

5. Zonat e Administrimit Zgjedhor miratohen nga KQZ-ja jo më vonë se 9 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, mbi bazën e numrit të shtetasve me të drejtë vote në datën e fundit të periudhës zgjedhore për caktimin e zgjedhjeve, sipas të dhënave

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Jo më vonë se 10 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon të dhënat KQZ-së, të ndara sipas njësive të qeverisjes vendore.

6. KQZ-ja, jo më vonë se 5 muaj para datës së zgjedhjeve, mund të ndryshojë kufijtë e ZAZ-së, sipas kërkesave të këtij neni, vetëm nëse ka ndryshim të kritereve për caktimin e tyre sipas pikave 2, 3 dhe 4 të këtij neni.

Neni 28

Ngritja e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor

1. Vendimi për ngritjen e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor merret nga KQZ-ja jo më vonë se 90 ditë para datës së zgjedhjeve.

2. Partitë politike propozojnë kandidaturat përkatëse për anëtar të KZAZ-së jo më vonë se 15 ditë para afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 29*

Përbërja e KZAZ-së

1. KZAZ-ja përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KQZ-ja, sipas procedurës së mëposhtme:

a) dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare, dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia e dytë e shumicës parlamentare dhe një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare. Në rast se nuk arrihet baraspeshimi politik, sipas kësaj shkronje, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në baraspeshimin politik shumicë-opozitë;

b) anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse gjysma tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare, sipas kritereve objektive të bazuara në:

i) përzgjedhjen rastësore;

ii) shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor;

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

c) sekretari i KZAZ-së duhet të jetë jurist dhe propozohet nga partia, e cila propozon zëvendëskryetarin e KZAZ-së;

ç) 30 për qind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës, në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini.

2. Kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së zgjidhen nga KQZ-ja, me propozim të KZAZ-së. Në KZAZ-të ku anëtari i shtatë i përket partisë kryesore të shumicës parlamentare, kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët e KZAZ-së, përfaqësues i partisë kryesore të shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër zgjidhet njëri nga anëtarët e KZAZ-së, përfaqësues i partisë kryesore të opozitës parlamentare. Zëvendëskryetari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin.

3. Anëtarët e KZAZ-së nuk punojnë me kohë të plotë. KQZ-ja përcakton orarin e punës së KZAZ-së gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe jashtë saj. Për punën e kryer anëtarët përfitojnë shpërblim në masën e përcaktuar me vendim të KQZ-së.

4. Renditja e partive për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ, sipas përcaktimeve të këtij neni, bëhet mbi bazën e numrit të mandateve që ka fituar partia politike nga zgjedhjet pararendëse për Kuvendin. Në rastin e zgjedhjeve vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare.

Në rast se dy ose më shumë parti kanë të njëjtin numër mandatesh dhe nuk është e mundur të përcaktohet partia përfituese, renditja e tyre përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi. Nëse dy ose më shumë parti kanë të njëjtin numër votash, renditja përcaktohet nga KQZ-ja me short.

5. Nëse partitë politike të shumicës parlamentare dhe të opozitës parlamentare, që kanë të drejtë të paraqesin kandidatura për KZAZ, nuk e ushtrojnë këtë të drejtë në afatin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 28 të këtij Kodi, kjo e drejtë u kalon automatikisht partive që vijnë në radhë me numër vendesh në Kuvend pas të parave, brenda grupimit përkatës. Kur kjo nuk është e mundur, propozimet bëhen sipas pikës 1 shkronja “a” të këtij neni. Nëse edhe këto parti nuk propozojnë anëtarë, KQZ-ja emëron kryesisht anëtarët e KZAZ-së deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje.

Anëtarët e emëruar kryesisht qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e anëtarëve të propozuar nga partitë politike, sipas këtij neni. Zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 30 ditë nga dita e zgjedhjeve. Në rastin e zgjedhjeve të parakohshme, zëvendësimi kryhet jo më vonë se 5 ditë nga dita e zgjedhjeve. Procedurat për përzgjedhjen dhe trajnimin e shtetasve që mund të emërohen kryesisht përcaktohen nga KQZ-ja me udhëzim të veçantë.

6. Në rastet e zgjedhjeve të pjesshme ose të parakohshme, KZAZ-ja ngrihet jo më vonë se 10 ditë nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve.

7. Kur vendi i një anëtari të KZAZ-së mbetet vakant, ai plotësohet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë nen brenda 15 ditëve nga data e krijimit të vakancës. Gjatë periudhës së zgjedhjeve, vendet vakante plotësohen brenda 3 ditëve.

8. Kur vendi i një anëtari ose sekretarit të KZAZ-së mbetet vakant në ditën e zgjedhjeve, propozimi në KQZ duhet të dorëzohet jo më vonë 3 orë nga çasti i krijimit të vakancës. Në rast se subjektet me të drejtë propozimi nuk propozojnë kandidaturë në KQZ, kjo e drejtë i kalon partive politike të të njëjtit grupim që vijnë pas tyre në Kuvend për nga numri i vendeve të fituara në Kuvend në zgjedhjet pararendëse. Nëse edhe këto parti nuk propozojnë anëtarë, KQZ-ja emëron kryesisht anëtarët e KZAZ-së deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje.

Neni 30

Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe të sekretarit të KZAZ-së

Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së nuk mund të jenë:

a) deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;

b) kryetarë të bashkive ose komunave;

c) ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror; ose

ç) anëtarë apo sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

Neni 31

Kushtet për emërimin e anëtarit dhe të sekretarit të KZAZ-së

Anëtar dhe sekretar i KZAZ-së mund të emërohet çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;

b) ka arsim të lartë dhe në rastin e sekretarit të jetë jurist;

c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;

ç) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

d) ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.

Neni 32

Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZAZ-së

1. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së shkarkohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:

a) shkelin dispozitat e këtij Kodi ose të akteve nënligjore në zbatim të tij lidhur me detyrat e KZAZ-së;

b) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

c) mungojnë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht të KZAZ-së, ose në periudhën zgjedhore nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht; ose

ç) nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.

2. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së lirohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:

a) kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;

b) janë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumemërore të një partie apo koalicioni që konkurron në zonë;

c) nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës;

ç) nuk kanë më vendbanimin e tyre në zonën zgjedhore;

d) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.

3. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së lirohen/shkarkohen nga detyra nga KQZ-ja, kryesisht ose me propozim të subjekteve zgjedhore, vetëm për shkaqet e parashikuara në këtë nen. Në çdo rast, kërkesa për lirim ose shkarkim duhet të përmbajë edhe argumente dhe fakte për shkeljen e pretenduar. Në rastin e parashikuar në shkronjën "d" të pikës 2 të këtij neni ky rregull nuk zbatohet dhe kërkesa pranohet në çdo rast.

Neni 33

Detyrat e KZAZ-së

KZAZ-ja kryen këto detyra:

a) përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ, sipas dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja;

b) emëron kryetarin, zëvendëskryetarin, anëtarët, sekretarët e KQV-ve, dhe anëtarët e grupeve të numërimit, të përfshira në juridiksionin e ZAZ-së, sipas këtij Kodi;

c) regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe, sipas rastit, verifikon informacionet ose pretendimet e subjekteve zgjedhore në zonë;

ç) afishon në një vend të dukshëm listat përfundimtare të zgjedhësve, dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe të dhëna të tjera, që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve në zonë;

d) administron buxhetin e caktuar nga KQZ-ja;

dh) garanton shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit;

e) merr në dorëzim nga KQV-të materialet e votimit dhe kutitë e votimit;

ë) përgatit dhe miraton tabelën përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për çdo subjekt zgjedhor në ZAZ dhe ia dërgon atë KQZ-së, së bashku me materialet e tjera të nevojshme, në përputhje me nenin 122 të këtij Kodi;

f) regjistron subjektet zgjedhore dhe kandidatët për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore;

g) shpall kandidatët fitues për kryetar të njësisë vendore.

Neni 34
Detyrat e sekretarit të KZAZ-së

Sekretari i KZAZ-së kryen këto detyra:

a) përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KZAZ-së;

b) protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KZAZ-së;

c) mban dokumentacionin zgjedhor të arkivuar;

ç) përgatit, në përputhje me udhëzimet e kryetarit, materialet për mbledhjen e KZAZ-së dhe ua shpërndan ato anëtarëve;

d) mban procesverbalet e mbledhjeve të KZAZ-së;

dh) kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KZAZ-ja dhe i vulos ato;

e) regjistron në protokoll vendimet e KZAZ-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara;

ë) u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KZAZ-së ose procesverbaleve të mbledhjeve të tyre;

f) regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore të dërguara nga KQZ-ja, sipas nenit 99 të këtij Kodi dhe përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me kërkesat e këtij Kodi;

g) me kërkesë të zgjedhësve, lëshon vërtetime nëse emri i zgjedhësit gjendet ose jo në listat përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor;

gj) regjistron në protokoll vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin komisionit.

Neni 35*
Mbledhjet dhe vendimet e KZAZ-së

1. Mbledhjet e KZAZ-së janë publike.

2. Mbledhjet e KZAZ-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të KZAZ-së. Vendimet e KZAZ-

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote.

3. Vendimet e KZAZ-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve të komisionit, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën "pro" ose "kundër", si dhe arsyetimin përkatës.

4. Vota e anëtarëve që janë në kushtet e konfliktit të interesit, të parashikuar në nenin 32 pika 2 të këtij Kodi dhe nuk janë liruar nga detyra, sipas atij neni, është e pavlefshme dhe nuk llogaritet në kuorum.

5. Në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja i dërgohet brenda 24 orëve për shqyrtim KQZ-së nga kryetari i KZAZ-së ose të paktën nga dy anëtarë, ose mund të ankimohet në KQZ nga subjekti zgjedhor i interesuar. Vendimi i KQZ-së është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KZAZ-ja.

KREU III
KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT (KQV)

Neni 36*
Përbërja e KQV-së

1. KQV-ja përbëhet nga 7 anëtarë, ku një anëtar ushtron detyrën e sekretarit. KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kritereve të nenit 29 të këtij Kodi për çdo lloj zgjedhjeje, me përjashtim të shkronjës "ç" të pikës 1 të nenit 29 të këtij Kodi.

2. Anëtarët dhe sekretari i KQV-së emërohen vetëm për periudhën e zgjedhjeve. Propozimet për anëtarë dhe sekretar të KQV-së bëhen jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe në rastin e zgjedhjeve të pjesshme apo të parakohshme 20 ditë para datës së zgjedhjeve. KZAZ-ja emëron anëtarët e KQV-ve jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve, kur konstaton se propozimi është në përputhje me kërkesat e neneve 37 dhe 38 të këtij Kodi. Në çdo rast emërimi i anëtarëve dhe sekretarit bëhet jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

3. Kryetari dhe sekretari i KQV-së zgjidhen nga KZAZ-ja. Në KQV-të ku anëtari i shtatë i përket partisë kryesore të shumicës parlamentare, kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët e KQV-së, përfaqësues i partisë kryesore të shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër zgjidhet njëri nga anëtarët e KQV-së, përfaqësues i partisë kryesore të opozitës parlamentare. Sekretari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin.

4. Kur vendi i një anëtari ose sekretarit të KQV-së mbetet vakant, ai plotësohet brenda 3 ditëve, por jo më vonë se 24 orë para hapjes së procesit të votimit. Zëvendësimi i anëtarëve të larguar në ditën e zgjedhjeve ose që nuk paraqiten në detyrë në ditën e zgjedhjeve, bëhet jo më vonë se 2 orë nga njoftimi i mungesës.

5. Kur KQV-ja mbetet pa kuorum, për shkak të mungesave të anëtarëve dhe me kalimin e afatit, sipas pikës 4 të këtij neni, nuk është kryer zëvendësimi, sipas pikës 4, KZAZ-ja urdhëron vazhdimin e procedurave dhe merr masa për plotësimin kryesisht të vakancës. KQV-ja bën shënimet përkatëse në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të saj dhe procedon me zbatimin e detyrave, pavarësisht nga kuorumi.

6. Zëvendësimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së bëhet, si rregull, me persona, të cilët kanë trajnim për legjislacionin zgjedhor.

Neni 37

Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit të KQV-së

Anëtari dhe sekretari i KQV-së nuk mund të jenë:

a) deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;

b) kandidatë ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;

c) ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror; ose

ç) anëtarë apo sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

Neni 38

Kushtet për emërimin e anëtarit dhe sekretarit të KQV-së

1. Anëtar ose sekretar i KQV-së mund të emërohet çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;

b) ka të paktën arsimin e mesëm;

c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;

ç) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi; dhe

d) ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.

2. Sekretari i KQV-së, si rregull, ka arsimin e lartë.

Neni 39*

Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së

1. Anëtari dhe sekretari i KQV-së shkarkohen nga detyra me vendim të KZAZ-së kur:

a) shkelin dispozitat e këtij Kodi ose të akteve nënligjore në zbatim të tij, lidhur me detyrat e KQV-së;

b) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

c) nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht; ose

ç) nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.

2. Anëtarët dhe sekretari i KQV-së lirohen nga detyra me vendim të KZAZ-së kur:

a) kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë zgjedhore për organet e qeverisjes vendore;

b) janë në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;

c) japin dorëheqjen nga detyra;

ç) nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës.

Neni 40

Detyrat e KQV-së

1. KQV-të ngrihen dhe funksionojnë për të gjitha llojet e zgjedhjeve.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

2. Anëtarët e KQV-së përgjigjen për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit, duke zbatuar detyrat e parashikuara në këtë Kod dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.

Neni 41

Detyrat e sekretarit të KQV-së

Sekretari i KQV-së kryen këto detyra:

a) përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KQV-së;

b) protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KQV-së;

c) mban dokumentacionin zgjedhor të arkivuar;

ç) përgatit, në përputhje me udhëzimet e kryetarit, materialet për mbledhjen e KQV-së dhe ua shpërndan ato anëtarëve;

d) mban procesverbalet e mbledhjeve të KQV-së;

dh) kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KQV-ja dhe i vulos ato;

e) regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve vendimet e KQV-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara;

ë) u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KQV-së dhe të procesverbaleve të mbledhjeve të tyre;

f) regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore, sipas nenit 100 të këtij Kodi, nga KZAZ-ja dhe përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me kërkesat e këtij Kodi;

g) regjistron në protokoll vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin KQV-së;

gj) përgjigjet për vendosjen e materialeve zgjedhore në Kutinë e Materialeve të Votimit dhe vulosjen e saj me vulat me kodet e sigurisë.

Neni 42*

Mbledhjet dhe vendimet e KQV-së

1. Mbledhjet e KQV-së janë publike.

2. Vendimet e KQV-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQV-së. Kur KQV-ja kryen detyrat nën kuorum, sipas pikës 5 të nenit 36 të këtij Kodi, vendimet e marra quhen të vlefshme.

3. Vendimet e KQV-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve të komisionit, krahas nënshkrimit të tij, deklaron në vendim votën "pro" ose "kundër", si dhe arsyetimin përkatës.

4. KQV-ja merr vendim për:

a) hapjen e votimit;

b) pezullimin e votimit;

c) kërkimin e ndihmës nga Policia e Shtetit për rivendosjen e rendit në qendrën e votimit;

ç) largimin e forcave të policisë pas rivendosjes së rendit në qendrën e votimit;

d) largimin e personave të caktuar nga mjediset e qendrës së votimit, sipas nenit 110 të këtij Kodi;

dh) përcaktimin e numrit të personave që kanë votuar në qendrën e votimit në rast kundërshtimi, sipas nenit 113 pika 2 të këtij Kodi;

e) mbylljen e votimit.

5. Në rast se KQV-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja i dërgohet menjëherë për shqyrtim KZAZ-së nga kryetari ose nga të paktën dy anëtarë të KQV-së, apo mund të ankimohet në KZAZ nga subjekti i interesuar. Vendimi i KZAZ-së zbatohet nga KQV-ja.

Neni 43

Përbërja dhe përgjegjësitë e KQV-ve të posaçme

KZAZ-ja, në përputhje me këtë Kod dhe me udhëzimet e KQZ-së, i propozon KQZ-së krijimin e KQV-ve të posaçme në institucionet

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

e posaçme. Këto komisione kanë të njëjtën përbërje dhe të njëjtat përgjegjësi si edhe KQV-ja.

PJESA III
ZGJEDHËSIT DHE PËRGATITJA E LISTËS SË ZGJEDHËSVE

KREU I
PËRMBAJTJA, HARTIMI DHE MIRATIMI I LISTËS SË ZGJEDHËSVE

Neni 44*
Kriteret për përfshirjen e zgjedhësit në listat e zgjedhësve

Kriteret për përfshirjen e një personi në listën e zgjedhësve janë:

a) të ketë shtetësinë shqiptare;

b) të ketë mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në datën e zgjedhjeve;

c) të mos jetë shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar;

ç) të jetë i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (në vijim RKGJC);

d) të ketë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit;

dh) të regjistrohet zgjedhës në listën e vetëm një zone qendre votimi.

Neni 45*
Përbërësit zgjedhorë

1. Zgjedhësi identifikohet në RKGJC nga përbërësit zgjedhorë. Përbërës zgjedhorë quhen përbërësit e gjendjes civile si më poshtë:

a) emri;

b) atësia;

c) amësia;

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

ç) mbiemri;
d) datëlindja;
dh) numri personal i identifikimit;
e) shtetësia;
ë) kodi i vendbanimit.

2. Përbërësit zgjedhorë të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “ë” publikohen në përputhje me nenet 51 dhe 56 të këtij Kodi. Lista që përdoret nga KQV-ja në procesin e votimit përmban përbërësit e përcaktuar në shkronjat “a”, “ç”, “d” dhe “dh”.

Neni 46*

Lista e zgjedhësve

1. Lista e zgjedhësve hartohet për çdo zonë qendre votimi dhe përmban të gjithë zgjedhësit që kanë vendbanimin e regjistruar në RKGJC në atë zonë qendre votimi. Përfshirja e zgjedhësit në listë bëhet mbi bazën e kodit të vendbanimit.

2. Një zonë qendre votimi ka jo më pak se 200 dhe jo më shumë se 1,000 zgjedhës me vendbanim në territorin e saj.

Neni 47*

Përputhshmëria me RKGJC-në

1. Lista e zgjedhësve nxirret nga RKGJC-ja.

2. RKGJC-ja mundëson administrimin, përpunimin dhe përditësimin e përbërësve zgjedhorë, si dhe nxjerrjen e tyre në çdo moment dhe në përputhje me dispozitat e këtij Kodi.

3. Ndryshimi i përbërësve të gjendjes civile që janë përbërës zgjedhorë, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për gjendjen civile, kryhet automatikisht në RKGJC.

Neni 48*

Përmbajtja dhe formati i listës së zgjedhësve

1. Lista e zgjedhësve përmban emërtimin e zonës zgjedhore, llojin dhe datën e zgjedhjeve, numrin e qendrës së votimit dhe

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

përbërësit zgjedhorë të zgjedhësve, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni.

2. Lista e zgjedhësve hartohet në formatet e mëposhtme:

a) listë zgjedhësish në formë të printuar për publikim, sipas përcaktimeve të nenit 56, e ndarë sipas qendrave të votimit dhe që përmban përbërësit zgjedhorë të përcaktuar në shkronjat "a", "b", "ç", "d" dhe "ë" të pikës 1 të nenit 45 të këtij Kodi;

b) listë zgjedhësish në formë të printuar për përdorim nga KQV-ja në procesin e votimit, e ndarë sipas qendrave të votimit dhe që përmban përbërësit zgjedhorë të përcaktuar në shkronjat "a", "ç", "d" dhe "dh". Ky format përmban edhe hapësirën për shënimin e numrit të dokumentit të identifikimit dhe nënshkrimin nga vetë zgjedhësi gjatë votimit;

c) përmbledhje e të gjithë zgjedhësve në nivel zone zgjedhore, sipas llojit të zgjedhjeve, me përbërësit zgjedhorë të përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike, i cili përdoret nga KZAZ-ja për informim të zgjedhësve;

ç) përmbledhje e të gjitha listave në nivel vendi që publikohet në faqet zyrtare të internetit të KQZ-së dhe ministrisë që mbulon shërbimin e gjendjes civile, e organizuar në nivel qarku, rrethesh brenda qarkut, njësish të qeverisjes vendore dhe qendrash votimi.

3. Zgjedhësit në listë renditen sipas rendit alfabetik të mbiemrit.

4. Lista e zgjedhësve, sipas nenit 56, duhet të mbahet edhe në format elektronik. Një kopje në format elektronik, sipas shkronjës "ç" të pikës 2 të këtij neni, i dërgohet Arkivit Qendror të Shtetit nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile jo më vonë së 10 ditë pas shpalljes së listës së zgjedhësve.

KREU II
PROCESI I PËRGATITJES SË LISTËS SË ZGJEDHËSVE

Neni 49*
Organi që harton listën e zgjedhësve

1. Çdo zyrë e gjendjes civile është përgjegjëse për përgatitjen e listave të zgjedhësve të zonave të qendrave të votimit nën

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

juridiksionin e saj, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra nga ministri që ka në varësi shërbimin e gjendjes civile. Zyra e gjendjes civile ka akses të plotë në RKGJC mbi përbërësit zgjedhorë të shtetasve të njësisë vendore, individualisht dhe në tërësi, dhe ka përgjegjësi të plotë për saktësinë e administrimit dhe ndryshimit të tyre.

2. Zyra e gjendjes civile, pas fillimit të procesit të hartimit të listave, i raporton një herë në muaj kryetarit të njësisë vendore për numrin dhe llojin e ndryshimeve që janë kryer në përbërësit zgjedhorë, shtimin apo pakësimin e numrit të zgjedhësve, si dhe i dorëzon për shpallje listën e zgjedhësve.

3. Listat e hartuara nga zyra e gjendjes civile shpallen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka në juridiksion zyrën përkatëse të gjendjes civile. Çdo faqe e listës së publikuar përmban nënshkrimin dhe vulën e përgjegjësit të gjendjes civile. Në rast mospërmbushjeje brenda afatit të këtij detyrimi nga ana e kryetarit, zyra e gjendjes civile njofton menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila shpall listat.

Neni 50*

Drejtimi metodologjik dhe mbikëqyrja e procesit të hartimit të listave

1. Ministri që ka në varësi shërbimin e gjendjes civile nxjerr urdhra dhe udhëzime për:

a) mbajtjen, përpunimin, përditësimin, ndryshimin, nxjerrjen dhe publikimin e të dhënave zgjedhore të RKGJC-së;

b) procedurat dhe afatet për hartimin dhe shpalljen e listave dhe ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë, njoftimin e zgjedhësve, si dhe vënien e listave në dispozicion të subjekteve që përcakton ky Kod;

c) administrimin e zonave të qendrave të votimit, në përputhje me nenin 62, ndarjen ose bashkimin e listave të zgjedhësve, si dhe për çdo aspekt tjetër të hartimit të listave të zgjedhësve në zbatim të këtij Kodi dhe legjislacionit të gjendjes civile;

ç) modelet dhe formularët që përdoren në procesin e hartimit të listave të zgjedhësve.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile mbikëqyr dhe kontrollon të gjitha veprimet që kryhen në RKGJC, kryen udhëzimin dhe drejtimin metodologjik të punës së zyrave të gjendjes civile, u kërkon atyre të verifikojnë dhe të ndryshojnë problemet e konstatuara në RKGJC, merr masa disiplinore për nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile që shkelin procedurat e administrimit të përbërësve zgjedhorë, si dhe i propozon KQZ-së marrjen e masave disiplinore për kryetarët e njësive të qeverisjes vendore që shkelin rregullat e përcaktuara në këtë Kod.

3. KQZ-ja mbikëqyr procesin e hartimit të listave të zgjedhësve, administrimin e zonave të qendrave të votimit dhe numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi. KQZ-ja i kërkon informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësive të qeverisjes vendore. Për shkeljet e konstatuara dhe për mosdhënie të informacionit, KQZ-ja u vendos sanksione drejtuesve të institucioneve përgjegjëse, në përputhje me këtë Kod.

Neni 51*

Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, jo më vonë se 5 ditë nga dita e dekretimit të datës së zgjedhjeve, urdhëron zyrat e gjendjes civile të fillojnë procesin e hartimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, në përputhje me këtë Kod. Jo më vonë se 15 ditë nga dita e dekretimit, zyra e gjendjes civile nxjerr në format elektronik ekstraktin me përbërësit zgjedhorë të të gjithë shtetasve me të drejtë vote në datën e zgjedhjeve, me përjashtim të shtetasve që kanë mbushur 100 vjeç deri në këtë datë.

2. Kur ekstrakti i një zone qendre votimi ka një numër zgjedhësish më të vogël se 200 zgjedhës, RKGJC-ja nuk lejon hartimin e ekstraktit për zonën e qendrës së votimit respektive. Në këtë rast zyra e gjendjes civile njofton jo më vonë se 48 orë nga konstatimi kryetarin e njësisë vendore dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile. Kryetari i njësisë vendore zbaton detyrimet që rrjedhin nga pikat 6 dhe 7 të nenit 62 të këtij Kodi. Sistemi kompjuterik mundëson ndryshimin e qendrës së votimit dhe ekstraktin respektiv pas bashkimit, sipas kësaj pike.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

3. Kur numri i zgjedhësve të një zone qendre votimi është më i madh se 1,000, ekstrakti i zgjedhësve ndahet në aq pjesë të barabarta sa qendra votimi ngrihen për atë zonë qendre votimi, në përputhje me nenin 62. Listat e ndara u caktohen qendrave në përputhje me numrin rendor të zgjedhësve, ku pjesa e parë i përket qendrës së votimit me numrin bazë. Në këtë rast, programi kompjuterik i RKGJC-së bën ndarjen automatike të listës mbi bazën e numrit të qendrës së votimit të caktuar çdo zgjedhësi. Zgjedhësit me të njëjtin mbiemër nuk mund të ndahen në lista të ndryshme.

4. Jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, zyrat e gjendjes civile, pas miratimit nga kryetari i njësisë vendore, printojnë dhe publikojnë ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre. Publikimi bëhet në ambientet e zyrave të gjendjes civile ose në ambientet pranë tyre me akses të lirë për publikun.

5. Jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile dhe KQZ-ja publikojnë në faqet përkatëse zyrtare të internetit ekstraktin e zgjedhësve në shkallë vendi.

6. Të dhënat e shtetasve, sipas pikave 3, 4 dhe 5 të këtij neni, publikohen të grupuara sipas zonave të qendrave të votimit dhe renditen sipas rendit alfabetik të mbiemrit. Në rastin e publikimit, sipas pikës 5 të këtij neni, faqet përkatëse të internetit duhet të mundësojnë kërkime të përbërësve zgjedhorë të shtetasve.

7. Publikimi, sipas pikës 4 të këtij neni, përsëritet në mënyrë periodike çdo 30 ditë deri në shpalljen e listës së zgjedhësve. Çdo publikim duhet të pasqyrojë çdo ndryshim të përbërësve zgjedhorë të RKGJC-së që është bërë nga publikimi paraardhës deri në momentin e publikimit të ri.

Neni 52*
Njoftimi me shkrim i zgjedhësve

1. Brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të zgjedhësve, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 51,

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore. Njoftim bëhet edhe për shtetasit që kanë mbushur 100 vjeç, sipas të dhënave në RKGJC, duke i njoftuar ata për arsyen e mospërfshirjes në listë.

2. Lajmërimi me shkrim përmban qendrën e votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhësve të qendrës së tij të votimit.

3. Për kryerjen e njoftimit, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ngarkon administratorët e lagjeve ose, sipas rastit, kryetarët e fshatrave që përfshihen në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore dhe, nëse është e nevojshme, edhe persona të tjerë nga administrata e njësisë së qeverisjes vendore.

4. Personat e ngarkuar me njoftimin e zgjedhësve i dorëzojnë njoftimin zgjedhësit personalisht ose, në mungesë të zgjedhësit, një anëtari madhor të familjes së tij, që gjendet në banesën e zgjedhësit, i cili firmos për marrjen e njoftimit. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore raporton për përmbushjen e këtij detyrimi, sipas udhëzimit të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

5. Shpenzimet për njoftimin, sipas këtij neni, mbulohen nga ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile. Fondi përkatës u shpërndahet njësive të qeverisjes vendore në raport me numrin e zgjedhësve që ka çdo njësi e qeverisjes vendore.

Neni 53*

Shkaqet dhe procedurat e ndryshimit në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë

1. Ekstrakti i përbërësve zgjedhorë shtohet, ndryshohet ose fshihet në rastet kur, pas momentit të publikimit të përbërësve zgjedhorë deri në shpalljen e listës së zgjedhësve, një person që ka mbushur ose mbush moshën 18 vjeç në datën e zgjedhjeve:

a) ka fituar ose ka lënë shtetësinë shqiptare;

b) është shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar;

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

c) vdes;

ç) ndryshojnë një ose më shumë prej përbërësve të gjendjes civile që përbëjnë përbërës zgjedhorë;

d) është regjistruar më shumë se një herë në listë;

dh) është regjistruar në qendrën e gabuar të votimit;

e) nuk është caktuar në asnjë qendër votimi;

ë) zona e qendrës së votimit është bashkuar me një zonë tjetër ose lista është ndarë në përputhje me nenin 62.

2. Në rast se kërkohet të shtohet, të ndryshohet ose të fshihen të dhënat e një zgjedhësi ose një apo më shumë përbërës zgjedhorë të tij, kërkesa bëhet pranë zyrës përkatëse të gjendjes civile, në përputhje me ligjin e gjendjes civile dhe aktet e dala në zbatim të tij, si më poshtë:

a) në rastin e shkronjave "ç", "d", "dh" dhe "e" të pikës 1 të këtij neni, kërkesa për ndryshim të përbërësit zgjedhor bëhet nga shtetasi ose një anëtar madhor i familjes së tij;

b) në rastet e shkronjave "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni, kërkesa për shtimin ose fshirjen e përbërësit zgjedhor mund të bëhet nga shtetasi kur ka fituar shtetësinë, një anëtar madhor i familjes së personit, kujdestari ligjor ose nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kryesisht ose mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga persona të tretë;

c) në rastin e shkronjës "d" të pikës 1 të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka të drejtë t'i kërkojë zyrës përkatëse të gjendjes civile fshirjen e përbërësit zgjedhor të dyfishtë ose të përbërësit që nuk përputhet me vendbanimin e regjistruar në RKGJC. Procedurat për evidentimin dhe verifikimin përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile, duke përdorur të gjitha të dhënat shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) në rastin e shkronjës "ë" të pikës 1 të këtij neni, ndryshimi bëhet drejtpërdrejt nga zyra e gjendjes civile mbi bazën e vendimit të marrë në përputhje me nenin 62 nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore.

3. Shtetasit që nuk janë përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë, për shkak se kanë mbushur moshën 100 vjeç, përfshihen në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit ku kanë vendbanimin, në përputhje me shkronjën "e" të pikës 1 dhe procedurën e parashikuar në shkronjën "a" të pikës 2 të këtij neni.

Neni 54*

Procedura administrative e rishikimit dhe e ndryshimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë

1. Me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 2 shkronja "c" të nenit 53, kërkesat për ndryshime në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë nuk mund të paraqiten më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve.

2. Kërkesa për ndryshim, sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 53, përbëhet nga një formular i veçantë, i cili paraqitet në zyrën e gjendjes civile ku zgjedhësi ka vendbanimin. Një kopje e formularit mbahet nga kërkuesi pas shënimit të datës së pranimit dhe nënshkrimit të nëpunësit që ka pranuar formularin. Formulari përmban:

a) emrin e plotë të kërkuesit dhe adresën e tij;

b) shkakun, për të cilin kërkohet ndryshimi;

c) dokumentet që provojnë shkakun për të cilin kërkohet ndryshimi.

3. Pas dorëzimit të kërkesës, zyra e gjendjes civile kryen verifikimet përkatëse dhe jo më vonë se 2 ditë nga dorëzimi i kërkesës kryen ndryshimin e kërkuar ose refuzon me shkrim kërkesën. Akti i refuzimit hartohet në jo më pak se tri kopje, nga të cilat njëra i dërgohet kërkuesit jo më vonë se 3 ditë nga data e marrjes së vendimit, një kopje Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në përfundim të periudhës së rishikimit dhe një kopje ruhet pranë zyrës përkatëse të gjendjes civile.

Neni 55*

Ankimi gjyqësor ndaj refuzimit të kërkesës për ndryshim

1. Kundër mospranimit të kërkesës për ndryshim të përbërësit zgjedhor, për shkaqet e parashikuara në nenin 53 dhe sipas procedurave të nenit 54 të këtij Kodi, mund të bëhet ankim nga kërkuesi në gjykatën e rrethit gjyqësor, në juridiksionin e së cilës ndodhet njësia e qeverisjes vendore. Ankimi bëhet jo më vonë se 5 ditë nga marrja dijeni për vendimin ose nga kalimi i afatit për marrjen

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

e vendimit mbi kërkesën nga zyra e gjendjes civile. Kërkesëpaditë, sipas këtij neni, përjashtohen nga pagesa e taksës së shërbimit gjyqësor.

2. Gjykata shqyrton çështjen dhe merr vendim brenda 5 ditëve nga çasti i paraqitjes së kërkesëpadisë. Në rast se paditësi ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk paraqitet në gjykim, gjykata pushon gjykimin. Në rast se i padituri nuk paraqitet në gjykim, gjykimi zhvillohet në mungesë. Gjykata duhet t'i njoftojë vendimin palës në mungesë, sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, brenda 24 orëve nga data e shpalljes së vendimit. Zyra e gjendjes civile është e detyruar të zbatojë vendimin e gjykatës brenda 48 orëve nga marrja dijeni, pa qenë nevoja që paditësi të kërkojë lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Në çdo rast, gjykata duhet të vërë në dispozicion të palëve vendimin e saj të arsyetuar me shkrim në të njëjtën datë me shpalljen e vendimit.

3. Kërkimi provohet me të njëjtat dokumente dhe prova, me të cilat provohet kërkesa para zyrës së gjendjes civile.

Neni 56*

Përgatitja dhe shpallja e listës së zgjedhësve

1. Zyra e gjendjes civile harton listën e zgjedhësve për çdo zonë qendre votimi jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve, duke nxjerrë nga të dhënat elektronike të RKGJC-së të gjithë shtetasit që do të mbushin moshën 18 vjeç deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve dhe që kanë vendbanimin në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e saj. Lista miratohet nga kryetari i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore.

2. Lista e zgjedhësve hartohet në përputhje me kriteret për numër zgjedhësish, të përcaktuara në pikën 2 të nenit 46 të këtij Kodi.

3. Lista e zgjedhësve i dërgohet, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, KZAZ-së në tri formatet e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 2 të nenit 48. KZAZ-ja, sipas rastit, publikon listën pranë qendrës përkatëse të votimit, në një ambient me akses të lirë për zgjedhësit, si dhe i dërgon KQV-së kopjen e saj të listës për përdorim gjatë votimit.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

4. Në rast se kompetencat e parashikuara në këtë nen nuk ushtrohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, detyrimet, sipas këtij neni, përmbushen menjëherë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

5. Lista e zgjedhësve nuk ndryshon në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak pas afatit të parashikuar në pikën 1. Programi kompjuterik ndërtohet në një mënyrë të tillë që nuk lejon asnjë ndryshim në listën e zgjedhësve, pavarësisht nga ndryshimet në përbërësit e gjendjes civile në RKGJC.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon një kopje të printuar të të gjitha listave të zgjedhësve Arkivit Qendror të Shtetit për ruajtje brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 57*

Vendimet gjyqësore pas hartimit të listës së zgjedhësve

1. Kur zgjedhësi vëren se përbërësi i tij zgjedhor përmban pasaktësi, nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij ose nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njësisë së qeverisjes vendore ku ai ka vendbanimin, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa, sipas kësaj pike, përjashtohet nga taksat gjyqësore.

2. Në rast se zgjedhësi ndryshon vendbanimin pas shpalljes së listës së zgjedhësve, lista nuk ndryshon dhe zgjedhësi voton në qendrën e votimit ku ka emrin në listën e miratuar. Në rast se zgjedhësi paraqet kërkesë në gjykatë në kushtet e kësaj pike, kërkesa rrëzohet.

3. Gjykatat e rretheve gjyqësore shqyrtojnë dhe vendosin në lidhje me kërkesat, sipas pikës 1 të këtij neni, si në ditën e fundit para zgjedhjeve, edhe në ditën e zgjedhjeve, por jo më vonë se 6 orë përpara mbylljes së votimit. Në rastin kur vendimi gjyqësor bën korrigjimin e përbërësve zgjedhorë, përcaktohet qartë përbërësi zgjedhor që ndryshohet. Kur saktësohet qendra e votimit ose zgjedhësi shtohet në listë, vendimi gjyqësor përcakton qendrën

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

e votimit ku zgjedhësi do të votojë dhe numrin e dokumentit të identifikimit.

4. Emri i zgjedhësit që paraqitet për të votuar me vendim gjykate shënohet nga KQV-ja në një regjistër të posaçëm, të cilit i bashkëngjitet vendimi i gjykatës. Në këtë regjistër shënohet edhe numri i dokumentit të identifikimit që përdoret për votim. E njëjta procedurë zbatohet edhe për rastet kur vendimi është marrë në përputhje me nenin 55, por vendimi nuk është pasqyruar në listën e zgjedhësve.

KREU III
ZGJEDHËSIT E VEÇANTË

Neni 58*
Zgjedhësit e veçantë

1. Anëtarët e KQV-ve votojnë në qendrën e votimit ku janë caktuar komisionerë, pavarësisht nëse e kanë ose jo emrin në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi. Në procesverbalin e mbledhjes regjistrohet fakti i votimit të personave të përcaktuar në këtë pikë, si dhe deklarimi i tyre i nënshkruar që nuk kanë votuar në qendrën e votimit ku janë të regjistruar sipas vendbanimit.

2. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së votojnë në qendrën e votimit më të afërt të caktuar me vendim të KZAZ-së, pavarësisht nëse e kanë ose jo emrin në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi. Personat e përcaktuar në këtë pikë pajisen nga sekretari i KZAZ-së me vërtetim të posaçëm që dëshmon numrin e qendrës së votimit që KZAZ-ja ka përcaktuar me vendim.

3. Kur personat e parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk e kanë emrin në listë, emri i tyre shënohet në regjistrin e posaçëm që mbahet sipas nenit 57 pika 4 të këtij Kodi.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Neni 59*

Lista për zgjedhjet e pjesshme, të parakohshme ose të përsëritura

1. Në rastin e zgjedhjeve të pjesshme ose të parakohshme, jo më vonë se 5 ditë nga nxjerrja e dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve, zyrat e gjendjes civile, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, hartojnë listat e zgjedhësve.

2. Brenda 48 orëve nga përfundimi i përditësimit, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore miratojnë dhe shpallin listat e zgjedhësve, në përputhje me nenin 48 të këtij Kodi.

3. Ndryshimet në listën e zgjedhësve bëhen në përputhje me nenin 57 të këtij Kodi.

4. Në rast përsëritjeje të zgjedhjeve, sipas nenit 161 të këtij Kodi, lista e zgjedhësve nuk ndryshon.

Neni 60*

Vënia e listave të zgjedhësve dhe ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në dispozicion të subjekteve zgjedhore dhe publikut

1. Listat e zgjedhësve dhe ekstraktet e përbërësve zgjedhorë vihen në dispozicion të subjekteve zgjedhore ose, sipas rastit, partive politike, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

2. Subjektet zgjedhore të regjistruara në KQZ ose partitë politike, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, mund të marrin nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile një kopje elektronike të listave të zgjedhësve ose ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në shkallë vendi, si dhe sa herë që ato përditësohen dhe publikohen, sipas nenit 51 të këtij Kodi. Kopja elektronike hartohet në mënyrë të tillë që të lejojë kërkime dhe krahasime të kryqëzuara të të dhënave.

3. Subjekteve të mësipërme zgjedhore u vihen në dispozicion listat e zgjedhësve jo më vonë se 3 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës.

4. Në rast se subjektet zgjedhore kërkojnë më shumë se një kopje të listave të zgjedhësve, ato vihen në dispozicion kundrejt

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

pagesës. Në këtë rast, pagesat për listat e zgjedhësve duhet të mbulojnë vetëm shpenzimet administrative të riprodhimit të tyre.

5. Listat e zgjedhësve, sipas shkronjës "ç" të pikës 2 të nenit 48, shpallen në formë elektronike në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ministrisë që mbulon pushtetin vendor. Formati elektronik duhet të mundësojë kërkime të shumëfishta të përbërësve të listës së zgjedhësve nga çdo i interesuar nëpërmjet internetit.

Neni 61*

Mbikëqyrja e hartimit të listave të zgjedhësve nga KQZ-ja

1. KQZ-ja mbikëqyr procesin e hartimit të listave, duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësive të qeverisjes vendore për procesin e caktimit të zonave të qendrave të votimit dhe numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi, në përputhje me rregullat e këtij Kodi dhe ligjit të gjendjes civile.

2. KQZ-ja, jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i zgjedhjeve, emëron me vendim dy auditë teknicienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të RKGJC-së. Të drejtën e propozimit për secilin audit teknicien e kanë respektivisht Kryetari dhe Zëvendëskryetari i KQZ-së, pas konsultimit me përfaqësuesit e partisë më të madhe të shumicës dhe asaj më të madhe të pakicës në KQZ. Auditët teknicienë nuk mund të shkarkohen nga detyra, përveç shkeljeve të përcaktuara në pikën 9 të këtij neni. Auditi teknicien zëvendësues emërohet jo më vonë se 5 ditë sipas të njëjtës procedurë dhe kriter të përcaktuar në këtë nen.

3. Auditët teknicienë duhet të kenë arsimim universitar dhe ekspertizë në fushën e teknologjisë së informacionit apo statistikës, si dhe të kenë njohuri për procesin e hartimit të listave të zgjedhësve dhe/ose gjendjes civile. Rregullat e veçanta për kushtet e kontratës dhe për kryerjen e auditimit, përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.

4. Auditët teknicienë kontrollojnë përputhshmërinë e veprimeve të kryera nga zyrat e gjendjes civile dhe Drejtorisë së

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Përgjithshme të Gjendjes Civile, me rregullat e përcaktuara nga ky Kod, ligji për gjendjen civile dhe aktet e nxjerra në zbatim të tyre nga KQZ-ja dhe ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile. Auditët teknicienë kryejnë dhe detyra të tjera të përcaktuara në këtë Kod dhe në aktet e KQZ-së.

5. Çdo audit teknicien ka akses në sistemin elektronik dhe bazën e të dhënave të RKGJC-së, për të bërë të mundur leximin dhe krahasimin e përbërësve të gjendjes civile, ndryshimeve të tyre, kohën kur janë kryer këto veprime nga përdoruesit apo administratorët e sistemit, si dhe të raporteve të auditit apo çdo lloj raporti të sistemit elektronik, të cilat gjurmojnë të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur mbi përbërësit zgjedhorë në RKGJC për periudhën që kontrollohet, duke përfshirë dhe metodologjinë si gjenerohet ky raport. Aksesi i auditit në RKGJC në çdo rast është jo më i vogël sesa aksesi që ka Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Gjendjes Civile.

6. Çdo audit ka të drejtë të vizitojë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile sa herë që e gjykon të arsyeshme, por të paktën një herë në muaj. Ata nuk mund të kryejnë dhe as të urdhërojnë veprime në bazën e të dhënave të RKGJC-së. Zyrtarët e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile janë të detyruar të bashkëpunojnë me auditët teknicienë, si dhe të japin çdo informacion apo sqarim në lidhje me ato që kërkohen në përmbushje të detyrës, përfshirë dhe detaje në lidhje me ndryshimet e ndodhura në RKGJC dhe personave që i kanë kryer apo autorizuar ato. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është e detyruar t'u krijojë kushte pune auditëve për të kryer auditimin e tyre në mënyrë të pavarur.

7. Auditët teknicienë i paraqesin një raport auditimi çdo muaj KQZ-së për gjetjet e auditimit, sipas detyrave të përcaktuara nga KQZ-ja ose për vërejtje apo çështje që lidhen me zbatimin e legjislacionit në lidhje me regjistrin e gjendjes civile. Secili nga auditët teknicienë mund të paraqesë raport individual nëse ka opinion apo koment të ndryshëm nga auditi tjetër.

8. KQZ-ja, me kërkesën e dy anëtarëve të saj, i përcjell gjetjet dhe rekomandimet e auditëve teknicienë për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile brenda 48 orëve, duke i kërkuar njëkohësisht shpjegime në lidhje me to. Raportet e auditëve teknicienë i paraqiten KQZ-së, e cila i shqyrton ato në seancë publike.

Detyra e auditëve teknicienë, në lidhje me mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, përmbushet me raportin përfundimtar për listën e zgjedhësve të hartuar sipas nenit 56 të këtij Kodi.

9. Auditët teknicienë janë të detyruar të trajtojnë të dhënat e mësuara apo të administruara gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, vetëm për llogari të raportimit në KQZ dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Auditët teknicienë nuk mund t'ia kalojnë të dhënat që nuk mund të publikohen sipas ligjit, personave të tretë. Shkelja e këtij detyrimi ndëshkohet sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

KREU IV
ZONA E QENDRËS SË VOTIMIT

Neni 62*
Caktimi i zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit

1. Zona e qendrës së votimit duhet të jetë brenda një territori kompakt dhe të pashkëputur gjeografik dhe numri i zgjedhësve për çdo qendër votimi nuk duhet të jetë më i vogël se 200 dhe më i madh se 1,000 zgjedhës.

2. Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës.

3. Kufijtë ekzistues të zonës së qendrës së votimit nuk ndryshojnë, me përjashtim të rastit kur bëhet i domosdoshëm ndryshimi për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. KQZ-ja, me udhëzim të veçantë, numërton zonat e qendrave të votimit në mënyrë unike në shkallë vendi.

4. Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur. Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

5. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 4 të nenit 51 të këtij Kodi, cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

6. Kur një zonë qendre votimi ka më shumë se 1,000 zgjedhës dhe lista është ndarë sipas nenit 51 të këtij Kodi, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vendos krijimin e qendrës shtesë të votimit brenda së njëjtës zonë. Në këtë rast qendra e re e votimit ngrihet, për sa është e mundur, në të njëjtën godinë me qendrën ekzistuese të votimit dhe numërtohet sipas sistemit unik kombëtar të numërtimit të qendrave të votimit.

7. Kur një zonë qendre votimi ka më pak se 200 zgjedhës, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vendos që ajo t'i bashkohet zonës së qendrës së votimit me numër më të madh zgjedhësish, më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor. Si rregull, qendra e re e votimit nuk është më larg se 5 km nga qendra e votimit që shkrihet për zonat rurale. Në rast se nuk është e mundur të zbatohen të dy kriteret e mësipërme, kriteri i numrit minimal të zgjedhësve ka përparësi. Numri i qendrës së votimit të shkrirë pezullohet dhe ky pezullim nuk ndikon në numërtimin ekzistues të qendrave të tjera të votimit. KQZ-ja përcakton me akt normativ kriteret dhe procedurat për bashkimin e qendrave të votimit, në përputhje me këtë pikë.

8. Përgjegjësitë e përcaktuara në këtë nen për Bashkinë e Tiranës ushtrohen nga kryetarët e njësive bashkiake të Tiranës.

9. Jo më vonë se 10 ditë nga përcaktimi i qendrës së votimit, sipas këtij neni, kryetari i njësisë vendore është i detyruar të njoftojë KQZ-në. Njoftimi për vendndodhjen shoqërohet edhe me planimetrinë, llojin e objektit dhe informacione të tjera të përcaktuara në aktin normativ të KQZ-së.

10. Mbi bazën e informacionit të marrë nga kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, në zbatim të këtij neni, KQZ-ja krijon dhe përditëson hartën e zonave të qendrave të votimit, si dhe krijon bazën e të dhënave mbi vendndodhjet e qendrave të votimit. Përfaqësuesit e partive politike të akredituara në KQZ kanë të drejtë të njihen në çdo kohë me to.

11. KQZ-ja, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, ndërhyn kryesisht ose me ankesë të përfaqësuesve të partive në KQZ, për të zbatuar kërkesat dhe kriteret për qendrën e votimit,

numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjen e tyre. Pas vendimit të KQZ-së qendra e votimit nuk ndryshon.

12. Në rast të refuzimit të zbatimit të urdhërimeve të KQZ-së në lidhje me qendrat e votimit, KQZ-ja ndëshkon kryetarin e njësisë vendore me 50,000 deri në 100,000 lekë gjobë, si dhe njofton prefektin për zbatimin e vendimit për caktimin e qendrave të votimit. Gjoba përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas Kodit të Procedurës Civile.

PJESA IV
REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Neni 63*
Subjektet zgjedhore dhe kandidatët

1. Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.

2. Subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod.

3. Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie apo komune ose për këshillat vendorë në KZAZ.

4. Përveç kushteve të parashikuara në pikën 3, nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen pa hequr dorë më parë nga detyra:

a) gjyqtarët, prokurorët;

b) ushtarakët e shërbimit aktiv;

c) punonjësit e policisë dhe të sigurimit kombëtar;

ç) përfaqësuesit diplomatikë;

d) kryetarët e bashkive dhe të komunave për zgjedhjet në Kuvend;

dh) deputetët, kur konkurrojnë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore;

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

e) prefektët në vendet ku kryejnë detyrat e tyre për zgjedhjet në Kuvend dhe për organet e qeverisjes vendore;

ë) kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve;

f) Presidenti i Republikës;

g) zyrtarët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuar me ligj.

5. Në rast të zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvendin dhe për organet e qeverisjes vendore në mënyrë të njëkohshme, kandidatët regjistrohen vetëm në një lloj zgjedhjeje.

Neni 64*

Regjistrimi i partive politike në zgjedhje

1. Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

2. Për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ:

a) vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë;

b) emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidatët;

c) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën e partisë;

ç) specimenin e vulës së partisë;

d) emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë; dhe

dh) emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në.

Neni 65*

Regjistrimi i koalicioneve zgjedhore

1. Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

2. Partia politike pjesëmarrëse në një koalicion nuk mund

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

të marrë pjesë në një koalicion tjetër dhe as të paraqesë kandidatë apo listë shumemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë.

Neni 66
Identifikimi i subjekteve zgjedhore

Nëse dy parti politike ose koalicione kanë emër ose emblemë të njëjtë apo të ngjashme në atë masë saqë mund të shkaktojë konfuzion ose lajthitje të votuesve, atëherë KQZ-ja vendos cila parti ose cili koalicion ka të drejtë të përdorë emrin ose emblemën përkatëse për qëllime zgjedhore, duke marrë në konsideratë datën e themelimit ligjor të partive ose datën e regjistrimit të parë të koalicionit në KQZ. Për të përcaktuar datën e parë të regjistrimit të koalicioneve, KQZ-ja i referohet edhe zgjedhjeve të mëparshme.

Neni 67*
Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive

1. Partia politike, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.

Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve.

2. Partia politike, pjesëtare e një koalicioni, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.

Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore lista e kandidatëve regjistrohet në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve.

3. Në zbatim të paragrafit të dytë të pikës 1 dhe të paragrafit të dytë të pikës 2 të këtij neni kandidati për kryetar bashkie dhe

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

lista për këshillin vendor të qytetit të Tiranës, si dhe për njësitë e qeverisjes vendore, territori i të cilave nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme, regjistrohen në KQZ.

4. Kandidati për deputet, i regjistruar në një listë shumemërore në një zonë zgjedhore ose kandidati për këshillat e bashkisë dhe komunës nuk mund të regjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish.

5. Emrat në listën e partisë paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumemërore të një partie të regjistruar si subjekt zgjedhor më vete apo numri i përgjithshëm i kandidatëve të një koalicioni nuk duhet të jetë më i vogël sesa numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse. Për një parti pjesëtare të koalicionit, numri i kandidatëve nuk mund të jetë më i vogël sesa gjysma e mandateve që zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse. Për listat shumemërore për këshillat e bashkisë dhe komunës zbatohet i njëjti rregull.

6. Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumemërore duhet t'i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas pikës 2 të nenit 164 të këtij Kodi.

7. Në rast mospërmbushjeje të njërit prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me përbërjen e listës shumemërore, KQZ-ja zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 175 të këtij Kodi.

Neni 68*

Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve

1. Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 5,000 zgjedhës në shkallë kombëtare. Në rastin e koalicionit zgjedhor listat në tërësi duhet të kenë marrë mbështetjen e jo më pak se 7,000 zgjedhësve në shkallë

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

kombëtare. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.

2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3,000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.

3. Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit.

Neni 69*

Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit
për zgjedhjet në Kuvend

1. Një grup zgjedhësish në një zonë zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për atë zonë zgjedhore, i cili përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 45 të Kushtetutës dhe në nenin 63 të këtij Kodi, jo më vonë se 50 ditë nga data e zgjedhjeve.

2. Kandidati i propozuar nga një grup zgjedhësish nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurron në zgjedhje dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurron në zgjedhje.

3. Për paraqitjen e një kandidati nga zgjedhësit krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar të organizojnë punën për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin, sipas këtij Kodi. Jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve komiteti nismëtar regjistrohet në KQZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për deputet vetëm në rast se ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por në çdo rast jo më shumë se 3,000 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në Kod.

4. Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni nëse janë deputetë. Në këtë rast, kandidati paraqet një vërtetim me shkrim të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit.

Neni 70*

Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore

1. Një grup zgjedhësish me banim në zonën zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për kryetar të bashkisë apo komunës ose një kandidat për këshillin vendor jo më vonë se 50 ditë nga data e zgjedhjeve.

2. Kandidati i propozuar nga një grup zgjedhësish nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurron në atë zonë zgjedhore dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurron në atë zonë zgjedhore.

3. Për paraqitjen e kandidatit nga zgjedhësit krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin. Jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve, komiteti nismëtar regjistrohet në KZAZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë apo komunës vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por, në çdo rast, jo më pak se 50 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

4. Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse janë kryetarë bashkie apo komune, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputetë. Në këtë rast kandidati paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit.

Neni 71*

Procedura e mbledhjes së nënshkrimeve

1. KQZ-ja, jo më vonë se 100 ditë para datës së zgjedhjeve, miraton dhe pajis subjektet e përcaktuara në nenet 68 dhe 69 të këtij Kodi me formularin tip për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për kandidatët e propozuar nga një grup zgjedhësish apo për partitë dhe koalicionet.

2. Zgjedhësit depozitojnë personalisht nënshkrimet e tyre në formularin tip. Formulari duhet të përmbajë identitetin e plotë të zgjedhësit, datëlindjen e tij dhe numrin telefonik të kontaktit. Bashkë me nënshkrimin, çdo zgjedhës depoziton edhe fotokopjen e letërnjoftimit të vlefshëm, të nënshkruar prej tij, e cila i bashkëngjitet listës. Në zbatim të nenit 69 të këtij Kodi, zgjedhësi duhet të jetë i regjistruar në zonën zgjedhore përkatëse.

3. Verifikimi i nënshkrimeve për zgjedhjet për Kuvendin kryhet nga administrata e KQZ-së dhe për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore kryhet nga KZAZ-ja përkatëse, duke verifikuar 5 për qind të listës mbështetëse të kërkuar sipas ligjit, nëse janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit. Pas verifikimit administrata paraqet një raport të detajuar mbi mangësitë e konstatuara. Raporti shqyrtohet në seancë publike, në prani të palës së interesuar. KQZ-ja vendos për pranimin ose refuzimin e listës mbështetëse. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve mbështetëse, duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të parregullta, është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas këtij Kodi.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Neni 72*
Dokumentet e kandidimit

1. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e këtij Kodi dhe sipas formës së përcaktuar në udhëzimet e KQZ-së.

2. Dokumentet e kandidimit duhet të përmbajnë këto të dhëna:

a) listën e plotë të kandidatëve me renditjen përkatëse, të nënshkruar nga kryetari i partisë, ose propozimin nga komiteti nismëtar i një grupi zgjedhësish;

b) emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë, adresën e kandidatit dhe një kopje të dokumentit të identifikimit;

c) deklarimin e kandidatit se gëzon të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar, në të cilin përfshihet, sipas rastit, deklarimi i dorëheqjes nga funksionet e përcaktuara në nenin 63 të këtij Kodi, shoqëruar me kopjen e deklaratës së dorëheqjes, të depozituar pranë institucionit përkatës;

ç) deklarimin e kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish se nuk do të mbështetet apo nuk do të mbështesë asnjë subjekt zgjedhor në zgjedhje;

d) një listë të nënshkruar nga zgjedhësit e zonës përkatëse, që mbështesin kandidatin ose partinë, sipas neneve 69, 70 dhe 71 të këtij Kodi.

3. Për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore, kërkesa e pikës 2 shkronja “a” të këtij neni mund të nënshkruhet edhe nga një person i autorizuar nga kryetari i partisë.

Neni 73*
Verifikimi i dokumentacionit

1. KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të këtij Kodi, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

2. Dokumentacioni i korrigjuar depozitohet jo më vonë se 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre.

3. KQZ-ja e publikon listën e plotë të kandidatëve në media dhe në faqen zyrtare të saj në internet. Një kopje e listës për çdo zonë zgjedhore i dërgohet prefektit, këshillit të qarkut dhe KZAZ-ve, të cilat e publikojnë atë në mediat vendore dhe e shpallin në vende publike në zonën e tyre, sipas udhëzimeve të marra nga KQZ-ja.

4. Emrat në listat shumemërore dhe renditja e tyre nuk mund të ndryshohen pas miratimit përfundimtar nga ana e KQZ-së ose, sipas rastit, KZAZ-së, sipas pikës 2 të këtij neni.

5. Jo më vonë se 24 orë nga miratimi përfundimtar i listës, KZAZ-ja depoziton një kopje të listës për këshillat e komunave dhe bashkive në KQZ.

6. Jo më vonë se 90 ditë nga data e zgjedhjeve, KQZ-ja përcakton me udhëzim të veçantë rregullat për verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për zbatimin e pikës 3 të këtij neni.

PJESA V
ZONA ZGJEDHORE DHE NUMRI I MANDATEVE PËR ÇDO ZONË

Neni 74
Zona zgjedhore për Kuvendin

1. Zona zgjedhore përputhet me territorin e qarkut dhe shërben si njësi zgjedhore për zgjedhjen e një numri të caktuar mandatesh, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.

2. Kufijtë administrativë të qarqeve vendosen me ligjin për ndarjen administrative e territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Neni 75
Kriteret dhe procedura për caktimin e numrit të mandateve

1. Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore përcaktohet në raport me numrin e shtetasve të secilës zonë zgjedhore. Çdo mandat përfaqëson një numër afërsisht të njëjtë shtetasish.

2. Numri total i shtetasve, sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, pjesëtohet me numrin 140 të mandateve të Kuvendit, duke përcaktuar numrin mesatar të shtetasve që i takojnë çdo mandati të Kuvendit.

3. Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore përcaktohet duke pjesëtuar numrin e shtetasve me vendbanim në zonën zgjedhore, me numrin mesatar, të përftuar sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Çdo zone zgjedhore i caktohet fillimisht një numër mandatesh i barabartë me numrin e plotë të përftuar nga pjesëtimi, sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Në rast se në përfundim të veprimit të kryer, sipas pikës 4 të këtij neni, një apo më shumë mandate mbeten pa u shpërndarë, ato u shpërndahen zonave mbi bazën e presjes dhjetore me të madhe të përftuar nga pjesëtimi, sipas pikës 3 të këtij neni. Shpërndarja e mandateve të mbetura kryhet në rend zbritës, duke filluar nga zona me presjen dhjetore më të madhe.

6. Në rast se edhe pas zbatimit të pikës 5 të këtij neni presja dhjetore e dy apo më shumë zonave është e njëjtë, mandati i fundit i caktohet asaj zone që, pas përllogaritjes sipas pikës 3 të këtij neni, ka numrin më të madh të mbetur të shtetasve që nuk kanë prodhuar mandat të plotë.

7. Në rast se dy apo më shumë zona zgjedhore, edhe pas zbatimit të pikës 6 të këtij neni, kanë numër të njëjtë shtetasish, të cilët nuk kanë prodhuar mandat të plotë, mandatet ndahen me short nga KQZ-ja. Hedhja e shortit bëhet kurdoherë publike dhe në prani të subjekteve që kanë përfaqësues të përhershëm në KQZ.

Neni 76

Procedura dhe periudha e përcaktimit të mandateve

1. Si rregull 4 muaj para datës së fillimit të periudhës zgjedhore, që i paraprin fundit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me kërkesë të KQZ-së, dërgon numrin e përgjithshëm të shtetasve, si dhe numrin e shtetasve për çdo qark, bazuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e të dhënave, KQZ-ja kryen llogaritjen për caktimin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në nenin 75 të këtij

Kodi dhe ia dërgon menjëherë Kuvendit. Kuvendi, me procedurë të përshpejtuar, miraton me vendim ndarjen e mandateve.

3. Në cdo rast numri i mandateve për cdo zonë zgjedhore miratohet jo më vonë se 6 muaj përpara fundit të mandatit të Kuvendit. Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore nuk rishikohet në rast të zgjedhjeve të parakohshme.

PJESA VI
FUSHATA ZGJEDHORE DHE MEDIA

Neni 77
Periudha e fushatës dhe e heshtjes zgjedhore

1. Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve.

2. Dita përpara datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve, deri në orën e mbylljes së votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore nëpërmjet organeve të medias, si dhe zhvillimi i mitingjeve ose i veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore.

Neni 78*
Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës

1. Gjatë fushatës zgjedhore, çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme.

2. Çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të transmetojë programet dhe mesazhet e tij zgjedhore nga të gjithë operatorët radiotelevizivë në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe pa censurë.

3. Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë dhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit.

4. Publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore duhet të përfshijë edhe emrin e organizatorit të sondazhit, porositësin e tij,

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e zhvillimit të sondazhit.

5. Ndalohet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet publike.

Neni 79

Materialet propagandistike

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore cakton, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike.

2. KQZ-ja miraton, me udhëzim të veçantë, kriteret për përzgjedhjen e këtyre vendeve.

3. Çdo afishim i materialeve propagandistike jashtë vendeve publike të autorizuara sjell heqjen e tyre nga organet e zbatimit të ligjit, në varësi të njësisë qeverisjes vendore.

Neni 80*

Fushata zgjedhore e subjekteve zgjedhore
në radiotelevizionin publik

1. Gjatë fushatës zgjedhore, radiotelevizioni publik më minutazh falas në dispozicion të partive politike të regjistruara dhe të KQZ-së për të bërë fushatë, e cila ndahet sipas rregullave të mëposhtme:

a) KQZ-së i vihen në dispozicion gjithsej dy orë, sipas segmenteve orare të kërkuara prej saj. Të paktën dy të tretat e këtij minutazhi duhet të jenë brenda segmentit orar 18^{00}-22^{00};

b) për partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, KQZ-ja cakton një minutazh të barabartë prej jo më pak se 30 minutash në televizionin publik dhe po aq në radion publike, kurse për partitë e tjera parlamentare, kjo kohë është jo më pak se 15 minuta. Rritja e kohës së transmetimit një partie apo një koalicioni përkatës, rrit proporcionalisht kohën në dispozicion të partisë apo koalicionit tjetër;

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

c) çdo parti joparlamentare, që merr pjesë në zgjedhje, përfiton 10 minuta në televizionin publik dhe 10 minuta në radion publike;

ç) në çdo program ose reklamë politike, në shërbim të propagandës zgjedhore, duhet të përcaktohet qartë subjekti zgjedhor përkatës. Në rast se programi ose reklama politike nuk është e identifikuar qartë, KQZ-ja urdhëron pezullimin e menjëhershëm të transmetimit të saj derisa të bëhet identifikimi i kërkuar nga kjo pikë.

2. Radiotelevizioni publik e pasqyron fushatën zgjedhore nëpërmjet lajmeve dhe programeve informative, në përputhje me parimet e paanshmërisë, plotësisë, vërtetësisë dhe pluralizmit të informacionit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon fushën e mediave elektronike. Minutazhi falas që përfitojnë partitë politike, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk mund të caktohet si pjesë e lajmeve dhe programeve informative.

3. Radiotelevizioni publik transmeton reklama politike pa pagesë, duke llogaritur kohën e transmetimit brenda minutazhit, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohen reklamat e institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor, me përjashtim të atyre që i shërbejnë qëllimit të ndërgjegjësimit të zgjedhësve për aspekte të procesit zgjedhor dhe/ose njoftime të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 81*

Edicionet informative të radiotelevizionit publik

1. Në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

2. Në rast të shkeljes së raporteve të pasqyrimit në favor të një partie ose të një koalicioni, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve urdhëron reduktimin në të njëjtën masë të kohës në dispozicion të partisë ose koalicionit politik ose kompensimin e partive apo koalicioneve të tjera politike me minutazh shtesë brenda 48 orëve.

3. Transmetimi i veprimtarive të institucioneve publike, qendrore ose vendore, llogaritet në kohën e transmetimit të subjektit zgjedhor, të cilit i përket titullari i institucionit, nëse veprimtaria ndjek qëllime elektorale. Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektoral të subjektit zgjedhor.

4. Për pasqyrimin e veprimtarive të partive joparlamentare radiotelevizioni publik zbaton kriteret profesionale të lajmit. Koha në dispozicion nuk mund të jetë më e madhe se koha e dhënë për partitë parlamentare, të cilat kanë marrë jo më pak se 20 për qind të vendeve në Kuvend.

5. Brenda edicioneve informative gazetarët e radiotelevizionit publik e kanë të ndaluar propagandën, komentet ose qëndrimet politike.

6. Në rast të shkeljes së kërkesave të përcaktuara në këtë nen, KQZ-ja gjobit, sipas rastit dhe shkallës së përgjegjësisë, me 20,000 lekë reporterin që ka përgatitur kronikën, me 30,000 lekë redaktorin përgjegjës, me 35,000 lekë drejtorin e informacionit dhe me 60,000 lekë drejtorin e përgjithshëm.

7. Vendimi i KQZ-së përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga drejtoria e financës e radiotelevizionit publik. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Neni 82

Minutazh falas për KQZ-në

Përveç minutazhit, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 80 të këtij Kodi, radioja dhe televizioni publik vënë 90 minuta falas në vit në dispozicion të KQZ-së për informimin e zgjedhësve. Ky minutazh caktohet në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 80 të këtij Kodi.

Neni 83
Orari i transmetimeve

1. Jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Publik, në bazë të të dhënave të paraqitura nga KQZ-ja për partitë e regjistruara, cakton minutazhin në dispozicion të çdo partie dhe organizon, nën mbikëqyrjen e KQZ-së, shortin për caktimin e segmenteve orare për çdo parti të regjistruar.

2. Minutazhi në dispozicion të partive politike caktohet në intervalin kohor nga ora 18^{00} deri 22^{00} të çdo dite të fushatës zgjedhore deri 24 orë para fillimit të votimit.

Neni 84*
Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private

1. Në radiot dhe televizionet private, pasqyrimi i fushatës zgjedhore bëhet vetëm në edicionet e zakonshme dhe të posaçme informative. Radiot dhe televizionet private nuk vënë kohë transmetimi në dispozicion të subjekteve politike për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të tyre. Informacionet mbi aktivitete të fushatës zgjedhore, që përgatiten dhe transmetohen në edicionet informative, bazuar në materiale të vëna në dispozicion nga subjektet zgjedhore, duhet të identifikohen qartë, në përputhje me udhëzimet e KQZ-së.

2. Radiot dhe televizionet private, në edicionet e tyre të zakonshme dhe të posaçme informative, duhet të respektojnë kushtet e mëposhtme:

a) minutazhi politik i edicioneve informative ndahet në raporte kohore, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 81 të këtij Kodi. Në rast të shkeljes së raporteve të pasqyrimit në favor të një partie, KQZ-ja, kryesisht ose me propozimin e KZAZ-ve, e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1,500,000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 3,000,000 lekë. Vendimi i KQZ-së përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, KQZ-ja urdhëron KKRT-në të bëjë bllokimin e transmetimit

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18^{00} e ditës pasardhëse;

b) transmetimi i veprimtarive të institucioneve publike, qendrore ose vendore, do të llogaritet në kohën e transmetimit të subjektit zgjedhor, të cilit i përket titullari i institucionit, nëse veprimtaria ndjek qëllime elektorale. Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektoral të subjektit zgjedhor;

c) për pasqyrimin e veprimtarive të partive joparlamentare dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, radiot dhe televizionet private zbatojnë kriteret profesionale të lajmit;

ç) brenda edicioneve informative, gazetarët e kanë të ndaluar propagandën, komentet ose qëndrimet politike. Në rast shkeljeje, KQZ-ja e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1,000,000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 2,500,000 lekë. Vendimi i KQZ-së përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, KQZ-ja urdhëron KKRT-në të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv vendor për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18^{00} e ditës pasardhëse.

3. Radiot dhe televizionet private kanë të drejtë të organizojnë debate zgjedhore midis partive politike ose kandidatëve konkurrentë. Në organizimin dhe zhvillimin e debatit, radiotelevizionet private janë të detyruara të ruajnë baraspeshën mes partive politike në debat.

Në rast shkeljeje, KQZ-ja urdhëron KKRT-në të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18^{00} e ditës pasardhëse.

4. Vetëm subjektet zgjedhore të regjistruara për zgjedhje kanë të drejtë të transmetojnë reklama politike gjatë periudhës zgjedhore në radiot, televizionet apo mediat audiovizive private, qofshin këto numerike, kabllore, analoge, satelitore apo të çdo lloj forme dhe mënyre të transmetimit të sinjalit. Reklamat politike të koalicioneve zgjedhore llogariten brenda kohës së partive politike anëtare të koalicionit, sipas marrëveshjes individuale të secilës parti me operatorin radioteleviziv. Reklama politike duhet të identifikojë qartë subjektin porositës. Në rast se reklama politike nuk është

identifikuar qartë, KQZ-ja urdhëron pezullimin e menjëhershëm të transmetimit të saj derisa të bëhet identifikimi i kërkuar nga kjo pikë.

5. Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje. Operatorët radiotelevizivë në çdo rast zbatojnë tarifa të njëjta brenda të njëjtit segment kohor përgjatë gjithë kohës së fushatës. Operatorët radiotelevizivë detyrohen të dorëzojnë 5 ditë përpara fillimit të fushatës tarifat për çdo segment kohor pranë KQZ-së. Tarifat publikohen në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

6. Për zgjedhjet në Kuvend radiot dhe televizionet private kombëtare dhe satelitore, të cilat pranojnë reklama me pagesë, sipas këtij neni, detyrohen që gjysmën e kohës totale të reklamës së parashikuar në pikën 5 të këtij neni t'ua vënë në dispozicion falas subjekteve zgjedhore. Kostoja për vënien e kohës në dispozicion falas subjekteve zgjedhore nga ana e radiove dhe televizioneve private llogaritet si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore. Ngarkohen KQZ-ja, KKRT-ja dhe Ministri i Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse.

7. Reklamat politike të subjekteve zgjedhore transmetohen ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15^{00} deri 18^{00} dhe nga ora 21^{00} deri 24^{00} të programit ditor.

8. Reklamat për kandidatët për kryetar të njësive të qeverisjes vendore llogariten në kohën e subjektit politik që ata përfaqësojnë.

9. Për partitë joparlamentare dhe për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, radiot dhe televizionet private vënë në dispozicion kohë transmetimi shtesë për reklamat mbi kohën që zbatohet, sipas pikës 5 të këtij neni. Koha e transmetimit të reklamave për secilën parti joparlamentare dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit nuk mund të jetë më e madhe se 10 minuta për gjithë fushatën zgjedhore. Për partitë joparlamentare dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit zbatohen tarifa të njëjta me ato që zbatohen për partitë parlamentare, si dhe kritere të njëjta për kohën falas, sipas pikës 6 të këtij neni. Në rast shkeljeje, KQZ-ja gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 2,000,000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 3,500,000 lekë. Vendimi i KQZ-së përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit gjyqësor. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Në rast shkeljeje, KQZ-ja urdhëron KKRT-në të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv vendor për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18^{00} e ditës pasardhëse.

10. Institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor, 60 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, u ndalohen reklamat, me përjashtim të atyre që i shërbejnë qëllimit të ndërgjegjësimit të zgjedhësve për aspekte të procesit zgjedhor ose njoftime të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 84/1†

Mbulimi i fushatës zgjedhore në zgjedhjet vendore

1. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, partia politike e regjistruar si subjekt zgjedhor ka të drejtë t'i kërkojë KQZ-së që të miratojë me vendim raporte për ndarjen e kohës që i takon subjektit përkatës, sipas neneve 80, 81 dhe 84 të këtij Kodi, sipas propozimit të bërë nga vetë subjekti. Partia ka të drejtë të përcaktojë raportet kohore për mbulim të fushatës për këshillat dhe fushatës së kandidatëve të saj për kryetarë të njësive të qeverisjes vendore. Kërkesa përkatëse i paraqitet KQZ-së jo më vonë se 15 ditë para fillimit të fushatës zgjedhore.

2. KQZ-ja i publikon raportet kohore të secilit subjekt në faqen e saj zyrtare të internetit. Këto raporte kohore zbatohen nga operatorët radiotelevizivë, jo më vonë se 10 ditë para fillimit të fushatës zgjedhore.

Neni 85*

Monitorimi i fushatës zgjedhore

1. KQZ-ja, 40 ditë përpara fillimit të fushatës zgjedhore, ngre Bordin e Monitorimit të Medias, i cili ka për detyrë monitorimin e zbatimit të dispozitave të këtij Kodi për fushatën zgjedhore në radion dhe televizionin publik dhe ato private. Bordi i Monitorimit të Medias e ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin zgjedhor. Për kryerjen e monitorimit bordi shfrytëzon kapacitetet teknike

† Shtuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

që disponon Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit. Për transmetuesit vendorë, që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese të KKRT-së, bordi cakton monitorues vendorë. Monitoruesit vendorë të bordit vendosen pranë KZAZ-së ku ka qendrën e transmetimit operatori radioteleviziv që monitorohet. Për rregullat, mënyrën dhe afatet e shfrytëzimit të kapaciteteve teknike të KKRT-së për nevojat e monitorimit, KQZ-ja dhe KKRT-ja lidhin marrëveshje bashkëpunimi jo më vonë se 3 muaj përpara datës së zgjedhjeve.

2. Bordi i paraqet KQZ-së çdo ditë raport për përfundimet e monitorimit për ditën pararendëse. Raporti shoqërohet, sipas rastit, me propozimet për masa administrative. Bordi kolegjialisht ose secili nga anëtarët e tij ka të drejtë të propozojë marrjen e masave administrative. Monitoruesit vendorë raportojnë përpara KZAZ-së ku janë vendosur. Kopja e raportit, së bashku me opinionin e KZAZ-së, i dërgohet menjëherë Bordit të Monitorimit të Medias dhe bëhet pjesë e raportit ditor për KQZ-në.

3. Ankesat e subjekteve zgjedhore shqyrtohen së bashku me raportin e bordit të monitorimit.

4. KQZ-ja shqyrton raportet e Bordit të Monitorimit jo më pak se një herë në javë. KQZ-ja merr vendim lidhur me raportet sa herë që propozohet marrja e masave administrative. Vendimet e KQZ-së ankimohen sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod.

5. Shfuqizuar

6. Radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto regjistrime ruhen për një periudhë tremujore pas përfundimit të zgjedhjeve dhe vihen, me kërkesë të KQZ-së, menjëherë në dispozicion të komisionit.

Neni 85/1*

Mënyra e formimit të Bordit të Monitorimit të Medias

Bordi i Monitorimit të Medias përbëhet nga 7 anëtarë. Secili nga anëtarët e KQZ-së cakton një anëtar të Bordit të Monitorimit të Medias nga lista e propozuar nga organizatat jofitimprurëse kombëtare të mediave, sipas procedurës së mëposhtme:

* Shtuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

a) KQZ-ja i kërkon jo më vonë se 4 muaj përpara fillimit të fushatës zgjedhore, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, listën e organizatave jofitimprurëse që operojnë në sektorin e medias, të cilat janë regjistruar të paktën 1 vit përpara datës së zgjedhjeve të radhës;

b) jo më vonë se 80 ditë përpara fillimit të fushatës zgjedhore, KQZ-ja i dërgon organizatave jofitimprurëse, të identifikuara sipas shkronjës "a" të këtij neni, kërkesën për të propozuar anëtarë për Bordin e Monitorimit të Medias;

c) brenda 30 ditëve nga kërkesa e KQZ-së, secila nga këto organizata jofitimprurëse propozon jo më pak se tre kandidatë për anëtarë të bordit. Personat e propozuar duhet të jenë me profesion ose përvojë pune si gazetarë, analistë ose studiues të mediave;

ç) jo më vonë se 45 ditë përpara fillimit të fushatës zgjedhore, secili anëtar i KQZ-së zgjedh një emër nga propozimet e bëra, sipas shkronjës "c" të këtij neni, për anëtar bordi dhe ia paraqet KQZ-së. KQZ-ja miraton Bordin e Monitorimit të Medias në përputhje me afatin e pikës 1 të nenit 85. Në rast se krijohet vakancë në përbërjen e bordit, anëtari përkatës i KQZ-së i propozon menjëherë KQZ-së për anëtar të ri të bordit një prej emrave të listës së propozuar, sipas shkronjës "c" të këtij neni.

PJESA VII
FINANCIMI I ZGJEDHJEVE DHE I FUSHATËS

KREU I
FINANCIMI I ZGJEDHJEVE

Neni 86*
Fondet për përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve

1. Buxheti i KQZ-së përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit.

2. Në buxhetin e vitit kur do të zhvillohen zgjedhje, Kuvendi vë në dispozicion të KQZ-së dhe të institucioneve të tjera përkatëse fondet për përgatitjen, zhvillimin, mbikëqyrjen, si dhe çdo aspekt tjetër të procesit zgjedhor.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

3. Në rastin kur viti buxhetor nuk është vit zgjedhor, KQZ-së i vihen në dispozicion fonde të mjaftueshme për funksionimin e këtij institucioni, si dhe për ushtrimin e përgjegjësive të tij sipas ligjit.

4. KQZ-ja administron fondet e caktuara për zhvillimin e zgjedhjeve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.

5. Në rastin e zgjedhjeve të parakohshme, Këshilli i Ministrave vë në dispozicion të KQZ-së fondet, sipas pikës 1 të këtij neni, jo më vonë se 5 ditë nga dita e shpërndarjes së Kuvendit apo organit përkatës të pushtetit vendor.

KREU II
FINANCIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Neni 87*
Fondet nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje

1. Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 0,5 për qind të votave në shkallë vendi, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje. Fondi për këtë qëllim përcaktohet me vendim të Kuvendit dhe përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit për vitin zgjedhor përkatës. Ky fond nuk mund të jetë më pak sesa totali i shumave të shpërndara partive politike në zgjedhjet pararendëse.

2. KQZ-ja, brenda 5 ditëve nga nxjerrja e rezultatit përfundimtar në shkallë vendi, përcakton me vendim vlerën në para të një vote të vlefshme, duke pjesëtuar fondin e përgjithshëm të miratuar, me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e radhës, që kanë fituar jo më pak se 0,5 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore llogaritja bëhet mbi bazën e votave të marra për këshillat vendorë në shkallë vendi.

3. KQZ-ja përllogarit shumën që i takon secilës parti, duke shumëzuar vlerën në para të një vote të vlefshme, të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij neni, me numrin e votave të vlefshme që ka marrë secila parti në zgjedhjet e radhës.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

4. KQZ-ja zbret nga shuma e përllogaritur sipas pikës 3 sanksionet financiare që janë bërë titull ekzekutiv, të vëna për partinë përkatëse, sipas këtij ligji.

5. Shuma e mbetur pas përllogaritjeve të pikës 4 është shuma e cila përfiton partia pjesëmarrëse në zgjedhje nga Buxheti i Shtetit.

6. Në rast se shuma e përfituar, sipas pikës 5 të këtij neni, është më e vogël se shuma e dhënë paradhënie për financimin e fushatës zgjedhore, sipas nenit 87/2, partia është e detyruar të kthejë diferencën e përfituar. Partitë që nuk kalojnë pragun e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni nuk përfitojnë fonde sipas pikës 5.

7. Në rast se shuma e përfituar, sipas pikës 5 të këtij neni, është më e madhe se shuma e dhënë paradhënie për financimin e fushatës zgjedhore, sipas nenit 87/2, partia do të përfitojë nga Buxheti i Shtetit diferencën përkatëse.

8. Partia, e cila nuk kthen fondet përkatëse, sipas pikës 6 të këtij neni, brenda 90 ditëve, humbet të drejtën e financimeve të tjera nga fondet publike për një periudhë kohe jo më pak se 5 vjet, si dhe nuk regjistrohet si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e radhës, pavarësisht llojit të tyre, as vetëm dhe as si pjesëtare e ndonjë koalicioni.

Neni 87/1*

Burimet e financimit të fushatës zgjedhore

Burimet e financimit të fushatës për subjektet zgjedhore janë:

a) fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore;

b) të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor të krijuara sipas ligjit;

c) dhuratat në vlerë monetare, natyrë ose shërbime të dhëna, sipas nenit 89 të këtij ligji;

ç) kreditë e marra nga partitë politike sipas ligjit. Në asnjë rast vlera e një kredie nuk duhet të kalojë shumën e parave, sipas pikës 2 të nenit 89 të këtij Kodi.

---

* Shtuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Neni 87/2*

Fondet e dhëna nga Buxheti i Shtetit për fushatën zgjedhore

Fondi i përcaktuar me vendim të Kuvendit, sipas pikës 1 të nenit 87, u ndahet si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore si më poshtë:

a) 95 për qind e fondit i shpërndahet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, të cilat kanë përfituar jo më pak se 0,5 për qind të votave të vlefshme në zgjedhjet paraardhëse;

b) 5 për qind e fondit i shpërndahet partive politike që janë regjistruar si subjekte zgjedhore dhe që nuk përfitojnë sipas shkronjës "a" të këtij neni.

Neni 87/3*

Mënyra e përllogaritjes së fondit paradhënie

1. Fondi i përcaktuar sipas shkronjës "a" të nenit 87/2 llogaritet duke pjesëtuar këtë fond me totalin e votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike, që përfitojnë sipas shkronjës "a" të nenit 87/2 të këtij Kodi. Herësi i dalë nga ky pjesëtim shumëzohet me numrin e votave të vlefshme që ka marrë partia politike përkatëse në zgjedhjet paraardhëse.

2. Fondi i përcaktuar sipas shkronjës "b" të nenit 87/2 ndahet duke pjesëtuar këtë fond me numrin e partive politike që përfitojnë, por në asnjë rast kjo shumë nuk mund të jetë më e madhe se shuma më e vogël e përfituar nga një parti, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Për zgjedhjet e përgjithshme si kriter përdoret rezultati në shkallë vendi, i shpallur nga KQZ-ja për zgjedhjet e përgjithshme paraardhëse. Për zgjedhjet për qeverisjen vendore si kriter përdoret rezultati në shkallë vendi për kështillat vendorë, i shpallur nga KQZ-ja për zgjedhjet paraardhëse për qeverisjen vendore.

4. Fondi i përcaktuar për t'u shpërndarë, sipas nenit 87/2, i jepet secilës parti jo më vonë se 5 ditë nga regjistrimi i listave shumemërore, apo kandidatëve për kryetar të njësive të qeverisjes vendore të partisë përkatëse.

---

* Shtuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Neni 88*

Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore.

3. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.

Neni 89*

Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike

1. Subjektet zgjedhore mund të marrin fonde, për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore, vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Për qëllim të këtij Kodi, konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

2. Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlefta në sende ose shërbime.

3. Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij, nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë;

b) ushtron veprimtari në fushën e medias;

c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;

ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik. Ky detyrim nuk zbatohet nëse aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike.

Neni 90*

Regjistrimi i fondeve jopublike

1. Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të këtij Kodi dhe mban përgjegjësi personale për deklarim të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t'u nënshkruar në çdo rast dhurimi.

2. Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

3. Shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 87/3 të këtij Kodi. Çdo shpenzim i kryer për fushatën zgjedhore dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.

4. Detyrimet e parashikuara në këtë nen vlejnë edhe për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, të regjistruar sipas neneve 69 dhe 70 të këtij Kodi. Shpenzimi total që mund të kryejë kandidati i propozuar nga zgjedhësit nuk duhet të kalojë 50 për qind të shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 87/3 të këtij Kodi.

Neni 91*

Auditimi i fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore

1. Jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, KQZ-ja emëron me short një apo më shumë ekspertë kontabël të licencuar, të përzgjedhur sipas nenit 92 të këtij Kodi, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore. Raporti i auditimit paraqitet në KQZ brenda afatit të përcaktuar në vendimin e emërimit. Raporti nuk mund të përfshijë të dhëna personale të dhuruesve nën vlerën e parashikuar në pikën 2 të nenit 90 të këtij Kodi.

2. Subjektet zgjedhore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni duhet të vënë në dispozicion të auditit të emëruar nga KQZ-ja çdo informacion, dokumente apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore, sipas këtij Kodi.

3. Subjektet zgjedhore që auditohen duhet të vënë në dispozicion çdo informacion që disponojnë nga bankat, institucione apo persona të tretë që kanë lidhje me auditimin ose të autorizojnë auditorin për tërheqjen e tyre nga të tretët. KQZ-ja vë në dispozicion të auditorit në çdo fazë të auditimit informacionet që i paraqiten nga të tretët mbi objektin e auditimit.

4. KQZ-ja publikon raportet e auditimit për subjektet zgjedhore jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga data e mbylljes së verifikimeve përkatëse.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Emri i personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse publikohen bashkë me raportin.

5. Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në këtë kre nga subjektet zgjedhore apo dhuruesit, në rast se nuk përbën vepër penale, është kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas parashikimeve të pjesës XIV të këtij Kodi.

Neni 92

Përzgjedhja e auditëve nga KQZ-ja

1. KQZ-ja përzgjedh me konkurrim një listë të ekspertëve kontabël të licencuar në fillim të vitit zgjedhor.

2. Lista duhet të përmbajë të paktën 20 ekspertë, të cilët e ushtrojnë këtë profesion në 5 vitet e fundit.

3. Procedurat, kriteret e përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të tyre përcaktohen me udhëzim të KQZ-së. Në çdo rast një auditor nuk mund të auditojë të njëjtin subjekt zgjedhor për dy zgjedhje radhazi.

4. Buxheti për zgjedhjet duhet të parashikojë edhe fondin e nevojshëm për auditimin e subjekteve zgjedhore.

PJESA VIII

PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS PËR ZGJEDHJET DHE GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE (GNV)

KREU I

VENDNDODHJA E QENDRAVE TË VOTIMIT, SELIVE TË KZAZ-VE, VENDEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE

Neni 93*

Vendndodhja e qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe Vendeve të Numërimit të Votave

1. Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave, për aq sa është e mundur, krijohen në ndërtesa publike me hyrje të lirë.

2. Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave nuk mund të krijohen:

a) në ndërtesa private, pa vendim të KQZ-së. Në çdo rast qendra e votimit nuk mund të caktohet në banesa private;

b) në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore;

c) në ndërtesa që përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike, kandidati, të afërmve të tij, ose kanë shërbyer si zyra elektorale gjatë fushatës zgjedhore.

3. KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje. Propozimi për caktimin e tyre paraqitet me dy objekte alternative, planimetrinë përkatëse ose fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitë që ofron objekti për zhvillimin normal të zgjedhjeve dhe që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë nen. Bëjnë përjashtim rastet kur nuk është e mundur gjetja e një objekti alternativ.

4. Me kërkesë të një anëtari të saj, KQZ-ja urdhëron administratën për të kryer verifikimin përkatës në terren, e cila paraqet një raport për plotësimin e kushteve të parashikuara në

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

këtë Kod apo në akte të tjera. Vendimi merret në konsultim me përfaqësuesit e akredituar të subjekteve në KQZ. Një kopje e vendimit të KQZ-së afishohet qartë në hyrjen e qendrave të votimit ose vendeve të numërimit të votave përkatëse në ditën e votimit.

Neni 94*

Vendndodhja dhe përgatitja e Vendeve të Numërimit të Votave

1. Jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 93 dhe të këtij neni. Jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, KQZ-ja me vendim cakton Vendin e Numërimit të Votave. Në përcaktimin e Vendit të Numërimit të Votave KQZ-ja mund të përzgjedhë bashkinë qendër rrethi, pavarësisht nëse ndodhet jashtë juridiksionit territorial të ZAZ-së, ose bashkinë brenda territorit të ZAZ-së apo edhe njësinë më të madhe administrative, nëse bashkitë nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 93 dhe në këtë nen. Në përzgjedhjen e vendit të VNV-së, KQZ-ja i jep përparësi lehtësive logjistike të transportit rrugor, distancës nga qendrat e votimit dhe hapësirave të objekteve të mundshme. Si rregull, Vendi i Numërimit të Votave nuk ndryshon nga njëra zgjedhje në tjetrën.

VNV-ja caktohet në salla me përmasa të mëdha ose palestra sportive. Vendet e Numërimit të Votave vihen në dispozicion të KZAZ-ve jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve. KZAZ-ja, jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve, fton për njohje të Vendit të Numërimit të Votave subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve. Në përzgjedhjen e vendit, KQZ-ja duhet të marrë parasysh edhe mundësinë për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave, sipas pikës 4 të këtij neni.

2. Përpara prezantimit të Vendit të Numërimit të Votave subjekteve zgjedhore dhe KQV-ve përkatëse, KQZ-ja përgatit infrastrukturën e nevojshme logjistike të vendit të numërimit, përfshirë edhe ndriçimin e pandërprerë, për fillimin dhe mbarëvajtjen

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

e procesit të numërimit të votave, sipas planvendosjes tip të miratuar nga KQZ-ja dhe udhëzimeve përkatëse të KQZ-së. Për këtë, KQZ-ja vendos tryeza pune për çdo grup numërimi, duke siguruar që ato të kenë hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e procesit të numërimit të votave. Tryezat e punës vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të shikueshme nga anëtarët e KZAZ-së dhe nga vëzhguesit, kandidatët ose përfaqësuesit e medias dhe të mundësojnë aplikimin e teknologjisë mbështetëse, sipas pikës 4 të këtij neni. Vëzhguesit qëndrojnë përballë grupeve të numërimit në një largësi të vogël nga tryezat e punës ose, nëse përdoret teknologjia sipas pikës 4 të këtij neni, përballë monitorëve. Vëzhguesit nuk duhet të kenë kontakt fizik me materialet e votimit. Tryezat e punës së grupeve të numërimit dhe vendi i anëtarëve të KZAZ-së duhet të jenë në të njëjtën sallë ku kryhet procesi i numërimit të votave. Një vend numërimi votash nuk mund të ketë më pak se 5 dhe më shumë se 10 tavolina numërimi. Skema organizative e funksionimit dhe numri i tavolinave të numërimit për çdo vend të numërimit të votave përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.

3. Pajisjet e nevojshme logjistike për procesin e numërimit të votave sigurohen nga KQZ-ja, në bashkëpunim me organet e tjera qendrore ose vendore.

4. KQZ-ja vendos përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve) për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre. Kamerat me rezolucion të lartë instalohen mbi tavolinën e numërimit në mënyrë të tillë që bëjnë të mundur regjistrimin e vlerësimit të çdo flete votimi. Regjistrimi filmik transmetohet në kohë reale në monitorë të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Regjistrimi filmik i procesit ruhet në media elektronike dhe dorëzohet në KQZ së bashku me materialet e tjera zgjedhore. KQZ-ja ose, kur është e mundur, edhe KZAZ-ja, duhet të riprodhojë kopje të tyre dhe t'i vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore kundrejt pagesës së një tarife që mbulon koston e riprodhimit.

Neni 95*

Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV)

1. Për numërimin e votave në rang ZAZ-je, me vendim të KZAZ-së, 10 ditë para ditës së votimit, caktohen Grupe Numërimi të Votave. Numri i grupeve të numërimit është dy për çdo tavolinë numërimi, sipas pikës 2 të nenit 94 të këtij Kodi. Anëtarët e grupeve të numërimit të votave duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e neneve 30 dhe 31 të këtij Kodi. Propozimet për emërimin e anëtarëve duhet të dorëzohen në KZAZ të paktën 12 ditë para datës së zgjedhjeve.

2. Grupet e numërimit të votave përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi.

Në vendimin për emërimin e Grupit të Numërimit të Votave, KZAZ-ja cakton një nga anëtarët si numërues të parë dhe një anëtar si sekretar. Në gjysmën e Grupeve të Numërimit të Votave numëruesi i parë propozohet nga partia më e madhe e shumicës dhe në gjysmën tjetër nga partia më e madhe e opozitës. Sekretari i Grupit të Numërimit të Votave i përket partisë politike të kundërt me partinë që propozon numëruesin e parë. KQZ-ja me udhëzim përcakton mënyrën e hedhjes së shortit.

3. Në rast se ndonjë nga subjektet zgjedhore nuk paraqet propozime brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, KZAZ-ja cakton me short anëtarët zëvendësues midis anëtarëve të KQV-ve që i përkasin këtij subjekti zgjedhor në rang zone zgjedhore. Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave, ai funksionon me jo më pak se dy anëtarë.

4. Një grup numërimi numëron jo më pak se 5 qendra votimi dhe jo më shumë se 10 qendra votimi. Në përfundim të këtij procesi

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

grupi i numërimit zëvendësohet nga grupi tjetër i numërimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

5. KQZ-ja përcakton me akt normativ kriteret për numrin e grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, mënyrën e organizimit të punës, ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit dhe rregullat për radhën e veprimeve.

Neni 96*

Procedura për përcaktimin e partive që propozojnë anëtarë të GNV-ve

1. Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të Grupit të Numërimit të Votave e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare.

1/1. Nëse asnjë nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të tretë dhe të katërt nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar nga ky nen, e drejta e propozimit i kalon, sipas rastit, partisë politike që propozon kryetarin ose zëvendëskryetarin e KZAZ-së brenda të njëjtit grupim politik.

2. Jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, KQZ-ja organizon hedhjen e shortit për çdo ZAZ, në prani të partive politike të interesuara. Procedurat për hedhjen e shortit përcaktohen me udhëzim të veçantë të KQZ-së.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

KREU II
PËRGATITJA E DOKUMETACIONIT ZGJEDHOR DHE DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE

Neni 97*
Fletët e votimit

1. Për zgjedhjet për Kuvendin, zgjedhësi voton me një fletë votimi me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore.

2. Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zgjedhësi voton me dy fleta votimi me formë të njëjtë dhe me ngjyra të ndryshme, një për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe një për këshillin e komunës apo bashkisë.

3. Për Bashkinë e Tiranës zgjedhësi voton më katër fletë votimi me ngjyra të ndryshme, një për kryetarin e Bashkisë së Tiranës, një për Këshillin e Bashkisë së Tiranës, një për kryetarin e njësisë bashkiake dhe një për këshillin e njësisë bashkiake.

3/1. Ngjyra e fletës në zgjedhjet e qeverisjes vendore është e njëjtë në të dyja anët e saj.

4. Sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve, duke i shtuar 2 për qind.

Neni 98*
Përmbajtja e fletëve të votimit

1. Fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së.

Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, si dhe elemente të tjera identifikuese që nuk lexohen me sy të lirë.

2. Fletët e votimit prodhohen në blloqe pa kundërfletë. Numri i serisë së bllokut të fletëve të votimit shënohet në dokumentin që shoqëron bllokun e ambalazhuar, sipas përcaktimeve të KQZ-së.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

3. Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi.

4. Partitë pjesëtare në një koalicion zgjedhor shënohen të renditura njëra pas tjetrës në pjesën e fletës së votimit që i përket koalicionit zgjedhor. Për secilën nga partitë politike të koalicionit shënohen emri i partisë, sigla, shkronjat nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo partie politike anëtare të koalicionit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi. Radha e renditjes së tyre përcaktohet në mënyrë të rastësishme nëpërmjet shortit.

5. KQZ-ja organizon hedhjen e shortit për detyrimet që rrjedhin nga ky nen, menjëherë sapo të ketë përfunduar regjistrimi i listës shumemërore në KQZ apo, sipas rastit, në KZAZ. Rregullat për hedhjen e shortit përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.

Neni 99*

Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KQZ-ja në KZAZ

1. KQZ-ja dërgon në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve, materialet e mëposhtme zgjedhore, të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi:

a) numrin e nevojshëm të fletëve të votimit, në përputhje me numrin e zgjedhësve të regjistruar në atë qendër votimi, së bashku me fletët shtesë. Si rregull fletët dorëzohen të ambalazhuara në blloqe prej 100 fletësh, së bashku me dokumentin që tregon serinë përkatëse të bllokut të fletëve;

b) vulën e KQV-së;

c) procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë edhe formularët tip të procesverbaleve dhe të vendimeve për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, kërkimin e ndihmës së policisë dhe të largimit të saj, si dhe mbylljen e votimit;

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

ç) Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së;

d) zarfin në të cilin është shënuar “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA”;

dh) zarfin në të cilin është shënuar “FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA”;

e) zarfin në të cilin është shënuar “ZARFI I PROCESVERBALIT TË VULOSJES”; dhe

ë) lëndën e posaçme për timbrimin e zgjedhësit dhe aparatin verifikues të saj.

2. Përveç kutive me materialet zgjedhore, sipas pikës 1 të këtij neni, KZAZ-ve u jepen:

a) kuti votimi për çdo qendër votimi, në përputhje me kërkesat e këtij Kodi;

b) numër i mjaftueshëm kodesh sigurie, sipas vendimit të KQZ-së;

c) numër i mjaftueshëm dhomash të fshehta;

ç) kopje të mjaftueshme të Kodit Zgjedhor dhe të manualeve zgjedhore;

d) numrin e nevojshëm të vulave të kryetarëve të KQV-ve; dhe

dh) mjete të tjera të nevojshme për procesin e votimit.

3. KQZ-ja u dorëzon KZAZ-ve vulat e paketuara, sipas nenit 100 të këtij Kodi, të mbyllura në ambalazhin e sigurisë dhe pa identifikuar numrin serial të vulës.

4. Përveç materialeve për KQV-të, sipas pikës 1 të këtij neni, KQZ-ja i dërgon KZAZ-së Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, Tabelat për Rezultatet e QV-ve nga Grupet e Numërimit, Tabelat për Rezultatet e Zgjedhjeve për Zonën e Administrimit Zgjedhor, vulën e KZAZ-së, si dhe materiale të tjera të nevojshme për të, për administrimin e zgjedhjeve.

Pajisjet dhe materialet teknologjike të parashikuara në pikën 4 të nenit 94 dhe në Shtojcën III të këtij Kodi, dërgohen dhe instalohen sipas procedurave të parashikuara me udhëzim të veçantë të KQZ-së.

Neni 100*

Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV

1. KZAZ-ja, jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit, u shpërndan materialet zgjedhore KQV-ve nën juridiksionin e saj. Kryetari dhe sekretari i KQV-së, të shoqëruar nga çdo anëtar tjetër që kërkon, paraqiten në selinë e KZAZ-së dhe tërheqin:

a) kutinë me materialet zgjedhore, sipas nenit 99 pika 1 të këtij Kodi;

b) kutinë/kutitë e votimit;

c) listën e zgjedhësve;

ç) dhomat e fshehta;

d) vulat me kodet e sigurisë; dhe

dh) mjete të tjera të nevojshme për procesin e votimit.

2. Kryetari i KQV-së merr në dorëzim vulën e kryetarit nga KZAZ-ja. Kryetari i KQV-së përkatëse, në praninë e anëtarëve të KZAZ-së, kryen sipas radhës veprimet e mëposhtme:

a) merr me zgjedhje rastësore një vulë nga grumbulli përkatës i vulave të paketuara;

b) gris ambalazhin e vulës;

c) në një letër të bardhë vulos modelin e krahasimit të vulës; dhe

ç) poshtë secilës vulë shënon me shkrim dore emrin dhe mbiemrin e tij dhe nënshkruan në prani të anëtarëve të KZAZ-së.

3. Letra e bardhë me modelin krahasues të secilës vulë, sipas pikës 2 të këtij neni, nënshkruhet në pjesën e pasme të saj nga anëtarët e KZAZ-së dhe mbahet në ruajtje nga sekretari i KZAZ-së.

4. Vulat me kodet e sigurisë dorëzohen me procesverbal të veçantë, në të cilin shënohen kodet e sigurisë për çdo vulë. KQV-ja merr në dorëzim aq vula me kode sigurie sa duhen për mbylljen e kutive të votimit dhe për mbylljen e kutisë me materiale zgjedhore, si dhe tri vula shtesë për përdorim vetëm në rast dëmtimi. Vulat shtesë duhet të kenë ngjyrë të ndryshme nga ato që do të përdoren si rregull për mbylljen e kutisë së votimit. Një kopje e procesverbalit,

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

ku janë shënuar kodet e sigurisë, duke përfshirë edhe kodet shtesë të sigurisë, mbahet nga KZAZ-ja dhe një kopje i jepet KQV-së.

5. Vulat e KQV-ve dhe vulat e kryetarëve të KQV-ve, secila veçmas, prodhohen dhe i dorëzohen KQZ-së të paketuara me ambalazh sigurie. Vulat e KQV-ve dhe të kryetarëve të KQV-ve prodhohen në numër të barabartë me numrin e KQV-ve dhe të kryetarëve të KQV-ve në shkallë vendi.

PJESA IX
VOTIMI

KREU I
PROCEDURAT PËR HAPJEN E VOTIMIT

Neni 101*
Veprime paraprake të KQV-së

1. KQV-ja, nën drejtimin e kryetarit dhe sekretarit dhe në prani të vëzhguesve të subjekteve, një orë përpara hapjes së votimit, kryen këto detyra:

a) vendos tryezat, karriget dhe dhomat e fshehta në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit dhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;

b) heq materialet propagandistike që mund të ndodhen në qendrën e votimit dhe rreth saj në një rreze prej 150 m;

c) afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit;

ç) vendos materiale të tjera të kërkuara nga KQZ-ja;

d) kontrollon të gjitha materialet e marra në dorëzim;

dh) u tregon vëzhguesve kutitë e votimit të zbrazëta dhe i mbyll ato, sipas procedurës së përcaktuar në shkronjën “e” të kësaj pike;

e) vulos kutitë e votimit me kodet e sigurisë dhe numrat e vulave të sigurisë i shënon në Procesverbalin e Vulosjes së kutive të votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, të cilat

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Në rast se ndonjë nga vulat me kodet e sigurisë dëmtohet gjatë mbylljes së kutisë, ajo zëvendësohet me një nga vulat shtesë. Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe në Procesverbalin e Vulosjes shënohet numri i kodit të sigurisë së vulës së dëmtuar dhe numri i kodit të sigurisë së vulës shtesë. Origjinali i procesverbalit mbyllet në zarfin ku është shkruar "ZARFI I PROCESVERBALIT TË VULOSJES", i cili futet në kutinë e votimit për subjektet zgjedhore para fillimit të procesit të votimit. Kopje e Procesverbalit të Vulosjes me vulën e KQV-së u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare;

ë) në një nga faqet anësore të kutisë shënon qartë numrin e qendrës së votimit, si dhe vendos shenja dalluese, që i bëjnë të qartë zgjedhësit se ku duhet të hedhë çdonjërën nga fletët e votimit.

2. Anëtarët e KQV-së, në prani të vëzhguesve, marrin vendim për hapjen e votimit dhe e nënshkruajnë atë.

3. Kur përdoret Sistemi Elektronik i Verifikimit (SEV), sipas shtojcës III të këtij Kodi, procedurat, afatet, veprimet përpara dhe pas mbylljes së votimit me pajisjen, të personelit përgjegjës për përdorimin e pajisjeve elektronike në qendrën e votimit, përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.

Neni 102

Hapja e votimit dhe prania e anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së

1. Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara në nenin 101 të këtij Kodi, kryetari i KQV-së deklaron hapjen e votimit jo më përpara orës së parashikuar në nenin 11 të këtij Kodi.

2. Sekretari i KQV-së shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së kohën e largimit dhe të kthimit të çdo anëtari të KQV-së që largohet prej qendrës së votimit. Kur kryetari largohet nga qendra e votimit, ai i kalon vulën e kryetarit për përdorim anëtarit tjetër me të njëjtën përkatësi politike deri në çastin e rikthimit të tij. Sekretari i KQV-së bën shënimin përkatës në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Kur sekretari largohet nga qendra e votimit, vula e KQV-së dhe Libri i Protokollit të Mbledhjeve i kalojnë për përdorim zëvendëskryetarit deri në rikthimin e sekretarit të KQV-së. Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së bëhet shënimi përkatës për pasqyrimin e këtij fakti.

Neni 103*

Vulosja e fletëve të votimit

1. Në pjesën e pasme, fletët e votimit vulosen me vulën e KQV-së dhe me vulën e kryetarit të KQV-së. Në rast se një nga vulat është dëmtuar ose nxjerrë jashtë qendrës së votimit, KQV-ja pajiset menjëherë me vulë rezervë për zëvendësimin e vulës së nxjerrë nga përdorimi. Rregullat për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë përcaktohen me akt normativ të KQZ-së. Fakti i nxjerrjes së vulës nga përdorimi shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së bashkë me orën përkatëse. Dëmtimi i qëllimshëm ose nxjerrja e vulës jashtë qendrës së votimit përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 326/a të Kodit Penal.

2. Vula e KQV-së përmban tekstin "KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT" dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit. Vula e kryetarit të KQV-së përmban tekstin "KRYETARI" dhe një numër serial pesëshifror. Teksti i vulës rezervë përcaktohet nga KQZ-ja dhe është unik për secilën vulë.

3. Vula e kryetarit të KQV-së përdoret vetëm për vulosjen e fletëve të votimit dhe për asnjë dokument tjetër zgjedhor.

4. Kur është vendosur përdorimi i Sistemit Elektronik të Numërimit (SEN), sipas shtojcës II të këtij Kodi, fleta vuloset vetëm me vulën e KQV-së.

KREU II

PROCEDURAT GJATË VOTIMIT

Neni 104

Numri i kutive të votimit

1. Në zgjedhjet për Kuvendin, në qendrën e votimit vendoset vetëm një kuti votimi.

2. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore në qendrën e votimit vendosen dy kuti votimi, një për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe një për këshillin e bashkisë apo të komunës.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

3. Për zgjedhjet vendore në Bashkinë e Tiranës në qendrën e votimit vendosen katër kuti votimi, një për kryetarin e Bashkisë së Tiranës, një për Këshillin e Bashkisë së Tiranës, një për kryetarin e njësisë bashkiake dhe një për këshillin e njësisë bashkiake.

Neni 105*

Paraqitja e zgjedhësit në qendrën e votimit

1. Pas hyrjes së zgjedhësit në qendrën e votimit:

a) zgjedhësi thotë emrin dhe paraqet para KQV-së një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit me të dhëna biometrike, si më poshtë:

i) letërnjoftim; ose

ii) pasaportë;

b) një prej anëtarëve, i caktuar me vendim të KQV-së, kontrollon zgjedhësit në të dy duart, në çastin e paraqitjes para KQV-së dhe para marrjes së fletës së votimit, nëse është timbruar ose jo me lëndën e posaçme. Në rast se zgjedhësi është timbruar, anëtari i KQV-së ia bën të ditur menjëherë këtë fakt anëtarëve të tjerë të KQV-së, të cilët e verifikojnë menjëherë. Emri dhe mbiemri i këtij zgjedhësi shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe atij nuk i jepet fletë votimi;

c) kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë të dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;

ç) zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;

d) fleta e votimit vuloset në pjesën e pasme të saj me vulën e KQV-së dhe vulën e kryetarit të KQV-së. Kur është vendosur përdorimi i SEN-it, sipas këtij Kodi, fleta vuloset vetëm me vulën e KQV-së.

dh) zgjedhësi timbroset në dorën e majtë nga një anëtar i caktuar me vendim të KQV-së me një lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë dhe që nuk hiqet për jo më pak se 24 orë, me qëllim

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

shmangien e votimit më shumë se një herë dhe më pas i jepet fleta e votimit. Në rast se zgjedhësi nuk pranon të timbroset me lëndën e posaçme, atij nuk i jepet fleta e votimit dhe identiteti i tij mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

2. Një prej anëtarëve, i caktuar me vendim të KQV-së, kujdeset për ruajtjen e radhës së votimit të zgjedhësve.

3. Kur përpara KQV-së paraqitet një zgjedhës, i cili nuk është regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve, por është i pajisur me vendim gjykate, i cili i jep të drejtë të votojë në atë qendër votimi, sipas nenit 55 të këtij Kodi, KQV-ja shënon emrin e zgjedhësit në një regjistër të posaçëm, numrin e dokumentit të identifikimit dhe bashkëlidhur vendimin e gjykatës.

Neni 106*

Votimi

1. Pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletën votimit shënon në krah të emrit të subjektit zgjedhor apo partisë pjesëtare të një koalicioni shenjën “x” ose “+” apo një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij.

2. Zgjedhësi, pasi bën shënimin në fletën e votimit, palos fletën e votimit, në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, por të paktën një nga vulat në pjesën e pasme të fletës të jetë e dukshme. Zgjedhësi, pasi del nga dhoma e fshehtë, e hedh fletën e votimit në kutinë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.

3. Zgjedhësi voton vetëm për vete, me përjashtim të rastit të përcaktuar në nenin 108 të këtij Kodi.

4. Anëtarët dhe sekretari i KQV-së votojnë pasi kanë votuar të gjithë zgjedhësit e pranishëm në qendrën e votimit brenda orarit të mbylljes së votimit. Rregullat e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për votimin e anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së.

5. Anëtarët e KQV-së, që kanë lejuar një zgjedhës të votojë më shumë se një herë ose në emër të zgjedhësve të tjerë, mbajnë përgjegjësi penale, në përputhje me nenin 248 të Kodit Penal, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 108 të këtij Kodi.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Neni 107
Fletët e votimit të dëmtuara

1. Nëse shënimi në fletën e votimit apo në të paktën një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën/fletët e votimit në kuti. Kryetari i KQV-së merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët "E DËMTUAR" dhe e fut atë në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA". Në këtë rast, zgjedhësit i jepet një fletë votimi tjetër e të njëjtit lloj dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi.

2. Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletë votimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet e dëmtuar dhe futet në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA" dhe zgjedhësit i jepet një fletë votimi e dytë. Rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon ose dëmton përsëri pa dashje fletën e dytë të votimit, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi.

3. Në asnjë rast fletët e votimit të dëmtuara nuk hidhen në kutitë e votimit.

Neni 108
Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë

1. Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë.

2. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

3. Para se të shënojë në fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do

të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.

4. Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve dhe sekretari nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

5. Shënimi në fletën e votimit bëhet detyrimisht në dhomën e fshehtë.

6. Brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve, zgjedhësit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni kanë të drejtë t'i kërkojnë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, që përgatit listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, regjistrimin e tyre si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë. Kërkesa për regjistrim shoqërohet me dokumentacionin zyrtar që provon llojin dhe kategorinë e paaftësisë. Regjistrimi si zgjedhës që nuk mund të votojë vetë bëhet për të lehtësuar votimin e këtyre zgjedhësve.

7. Në çdo rast, kur ka zgjedhës të regjistruar, sipas pikës 6 të këtij neni, të cilët kanë vështirësi hyrjeje në mjedisin e qendrës së votimit, caktimi i qendrës së votimit dhe organizimi i saj bëhen në mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen e lirë për këtë kategori zgjedhësish. Në rast se kjo është e pamundur, në përputhje me udhëzimet dhe me shpenzimet e KQZ-së, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore caktojnë personel apo pajisje ndihmëse për të garantuar hyrjen e lirë.

8. Në rastin e zgjedhësve të verbër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton KQZ-në për numrin e zgjedhësve të verbër dhe qendrat e tyre të votimit. KQZ-ja, në përputhje me procedurat dhe afatet e shpërndarjes së materialeve zgjedhore, pajis komisionet e këtyre qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur. Zgjedhësi i verbër informohet nga KQV-ja për mënyrën e votimit me mjete të posaçme votimi dhe, me kërkesën e tij, pajiset me to. Në rast të kundërt, zgjedhësi voton në përputhje me pikat 1 dhe 3 të këtij neni.

Neni 109*

Rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit

1. Qendra e votimit organizohet në një mënyrë të tillë që të lehtësojë procesin e votimit dhe të sigurojë fshehtësinë e votës. Qendrat e votimit kanë një organizim tip, sipas përcaktimit me udhëzim të KQZ-së.

2. Në qendrën e votimit nuk lejohet përdorimi i telefonisë celulare nga ana e zgjedhësit dhe zgjedhësi nuk duhet të lejohet të votojë duke mbajtur aparatin telefonik në dorë. Nëse zgjedhësi tenton të përdorë aparatin e telefonisë apo çdo pajisje tjetër regjistrimi në dhomën e fshehtë, zbatohet e njëjta procedurë si në pikën 1 të nenit 107.

3. Kur në qendrën e votimit rrezikohet rendi ose zhvillimi i rregullt i votimit, KQV-ja njofton organet e Policisë së Shtetit dhe KZAZ-në, si dhe plotëson procesverbalin e pezullimit të votimit për këtë qëllim. Në procesverbal shënohet ora e njoftimit dhe pezullimit të votimit. KQV-ja shënon, gjithashtu, në Librin e Protokollit të Mbledhjeve incidentin e ndodhur, orën e ndërprerjes së votimit dhe orën e rifillimit të tij.

4. Kryetari ose çdo anëtar i KQV-së njofton menjëherë KZAZ-në për incidentin e ndodhur. KZAZ-ja është e detyruar të shënojë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së njoftimin dhe orën e marrjes së tij. KZAZ-ja ia përcjell kërkesën menjëherë organeve të Policisë së Shtetit.

5. Me rivendosjen e rendit në qendrën e votimit, KQV-ja u kërkon organeve të Policisë së Shtetit të largohen nga qendra e votimit dhe merr masa për rifillimin e menjëhershëm të votimit. Ky fakt pasqyrohet në procesverbalin e rifillimit të votimit.

Neni 110

Personat e pranishëm në qendrën e votimit

1. Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:

a) anëtarët dhe sekretari i KQV-së;

b) zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre; dhe

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

c) vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj.

2. Asnjë person i armatosur nuk lejohet të qëndrojë në mjediset e qendrës së votimit. Përjashtohen nga ky rregull punonjësit e Policisë së Shtetit, kur janë në ushtrim të detyrës, në përputhje me nenin 109 të këtij Kodi, si dhe punonjësit e policisë së burgjeve brenda territorit të burgut ose vendit të paraburgimit, ku është ngritur qendra e posaçme e votimit.

Neni 111

(Shfuqizuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19 korrik 2012)

KREU III
MBYLLJA E VOTIMIT DHE NUMËRIMI I VOTAVE

Neni 112
Mbyllja e votimit

1. Qendrat e votimit mbyllen në orën e caktuar, në përputhje me pikat 1 dhe 2 të nenit 11 të këtij Kodi. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari ka zgjedhës që presin në radhë, KQV-ja mbledh dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit.

2. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, KQV-ja merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin tip përkatës, duke shënuar në të edhe orën e mbylljes së votimit. Vendimi për mbylljen e votimit dhe ora e saktë e mbylljes së tij shënohen edhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i KQV-së, si dhe vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe/ose të huaj dhe përfaqësuesit e akredituar të medias.

Neni 113*

Veprimet pas mbylljes së votimit

Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, kryetari së bashku me anëtarët e KQV-së kryejnë, sipas radhës, veprimet e mëposhtme:

1. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së:

a) shënon numrin e zgjedhësve që kanë votuar, bazuar në nënshkrimet e bëra në listën e zgjedhësve, si dhe atyre që janë në regjistrin e posaçëm, sipas nenit 57 të këtij Kodi;

b) ia deklaron shifrën me zë të lartë anëtarëve të tjerë të KQV-së dhe vëzhguesve të pranishëm;

c) i fton ata të verifikojnë shifrën e thënë prej tij; dhe

ç) urdhëron sekretarin e KQV-së të shënojë në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së numrin e personave që kanë votuar në qendrën e votimit, sipas shkronjës "a" të kësaj pike. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në procesverbal. Sekretari i KQV-së shënon pretendimin në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

2. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së, pasqyron në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, numrin e plotë të fletëve të votimit të qendrës së votimit, duke u bazuar tek të dhënat që kanë shoqëruar marrjen në dorëzim të fletëve të votimit nga KZAZ-ja.

3. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së, fillon numërimin e fletëve të votimit të papërdorura dhe në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të KQV-së. Nëse kërkohet nga një anëtar i KQV-së ose ndonjë nga vëzhguesit, kryetari është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të papërdorura. Në përfundim të numërimit, fletët e votimit të papërdorura mbyllen në zarfin ku është shënuar "FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA". Numri i fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

4. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së, numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin "FLETË

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

VOTIMI TË DËMTUARA”. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

Nëse ndonjë nga vëzhguesit ka vërejtje, ato shënohen menjëherë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve ose paraqiten nga vëzhguesit me shkrim. Vërejtjet me shkrim administrohen nga sekretari dhe mbyllen në kutinë e materialeve të votimit së bashku me dokumentacionin tjetër të qendrës së votimit.

5. Në përfundim të veprimeve të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, mbyllen në kutinë e materialeve zgjedhore:

a) zarfi “FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA”;

b) zarfi “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA”;

c) lista e zgjedhësve, përfshirë edhe regjistrin e posaçëm, sipas nenit 57 të këtij Kodi;

ç) origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të papërdorur të vendimeve të KQV-së;

d) vula e KQV-së;

dh) vula e kryetarit të KQV-së;

e) vulat me kodet e sigurisë të papërdorura;

ë) vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara; dhe

f) Libri i Protokollit të Mbledhjeve.

6. Numrat e kodeve të sigurisë, me të cilët do të mbyllet kutia e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, shënohen paraprakisht në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Pasi hidhen të gjitha të dhënat në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, shënohet ora e saktë e mbylljes së procesverbalit. Origjinali i Procesverbalit për Mbylljen e Votimit futet në kutinë e votimit, e cila vuloset menjëherë me kodin e fundit të sigurisë, ndërsa kopja futet në kutinë e materialeve të votimit, e cila më pas vuloset me kodet përkatëse të sigurisë. Kopje të Procesverbalit për Mbylljen e Votimit u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare.

7. Në rast se gjatë mbylljes së kutisë së votimit vula me kodet e sigurisë dëmtohet gjatë mbylljes së kutisë, ajo zëvendësohet me një nga vulat shtesë. Në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve shënohet numri i kodit të sigurisë së vulës së dëmtuar.

8. Procesverbali i Mbylljes së Votimit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Nëse ndonjë nga anëtarët e KQV-së ka vërejtje, ato shënohen në hapësirën e posaçme për vërejtjet në procesverbal.

Neni 114

Shoqërimi i kutive të votimit dhe i materialeve të votimit në Vendin e Numërimit të Votave

1. Menjëherë pas përfundimit të veprimeve të parashikuara në nenin 113 të këtij Kodi, kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit dërgohen në Vendin e Numërimit të Votave, të caktuar sipas nenit 94 të këtij Kodi. Materialet e tjera të përdorura gjatë procesit të votimit i dorëzohen KZAZ-së brenda afateve dhe në mënyrën e përcaktuar nga KQZ-ja.

2. Kutia/kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit dorëzohen në Vendin e Numërimit të Votave sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 3 orë nga mbyllja e votimit në qendrën e votimit. Dërgimi i tyre bëhet me automjet, në të cilin ndodhen anëtarët dhe sekretari i KQV-së, si dhe një punonjës policie, i cili ka detyrë të garantojë shoqërimin dhe mosprekjen e kutisë/kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë së materialeve të votimit. KQZ-ja autorizon KZAZ-në, duke i dhënë edhe fondet e nevojshme financiare, për të siguruar transportimin me automjet të kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutinë me materialet e votimit.

3. Punonjësi i policisë, sipas pikës 2 të këtij neni, është efektiv i përhershëm i Policisë së Shtetit, përjashtuar policinë kriminale, i ngarkuar me detyrën e shoqërimit nga KQZ-ja, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Polici i shoqërimit duhet në çdo moment të mbajë uniformën e Policisë së Shtetit dhe të ketë në një vend të dukshëm numrin rendor të caktuar nga KQZ-ja dhe mbiemrin e tij me përmasa të dukshme.

KREU IV
DORËZIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE DHE NUMËRIMI I VOTAVE

Neni 115*
Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor nga KZAZ-ja

1. KZAZ-ja cakton për marrjen në dorëzim të kutisë/kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë/kutive me materialet e votimit një ose më shumë grupe të marrjes në dorëzim. Grupet e marrjes në dorëzim përbëhen nga 2 anëtarë të KZAZ-së me përkatësi të ndryshme politike, të propozuar përkatësisht nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së.

Nëse gjykohet e nevojshme, KZAZ-ja mund të caktojë 2 persona për çdo grup në ndihmë të grupit për marrjen në dorëzim të kutive, të cilët merren kryesisht me sistemimin e kutive nën drejtimin e KZAZ-së. Personeli ndihmës zgjidhet nga lista e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave, duke garantuar në çdo rast baraspeshën politike shumicë-opozitë. Kutia/kutitë me fletët e votimit dhe kutia/kutitë me materialet e votimit merren në dorëzim sapo ato mbërrijnë në Vendin e Numërimit të Votave, sipas rregullave të përcaktuara nga KQZ-ja.

2. Gjatë marrjes në dorëzim, grupet e marrjes në dorëzim:

a) shënojnë në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim numrat e kodeve të sigurisë së vulave, me të cilat është mbyllur kutia e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit;

b) verifikojnë në çast përputhjen e numrave të kodeve të sigurisë së vulave, me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, me numrat e kodeve të sigurisë, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qendër votimi, në zbatim të nenit 113 të këtij Kodi. Në rast mospërputhjeje të këtyre kodeve, grupi i marrjes në dorëzim informon KZAZ-në për mospërputhjen dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet “KUTI E PARREGULLT”. KZAZ-ja verifikon menjëherë mospërputhjen dhe merr vendim, sipas pikës 4 të këtij neni. Në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së shënohen mospërputhjet e konstatuara.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

3. Në rast se gjatë marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë me materialet e votimit, grupi i marrjes në dorëzim konstaton se:

a) mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode sigurie;

b) vendosja e vulave me kode sigurie është bërë në mënyrë të tillë që lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj;

c) kutia ka në trupin ose në kapakun e saj thyerje ose çarje që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit ose materialit tjetër të votimit; ose

ç) kutia është e llojit, formës ose përmasave të ndryshme nga ato të përcaktuara nga KQZ-ja;

atëherë grupi i marrjes në dorëzim informon menjëherë për parregullsinë KZAZ-në dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet "KUTI E PARREGULLT". KZAZ-ja verifikon menjëherë parregullsinë dhe vendos, sipas pikës 4 të këtij neni. Parregullsia e konstatuar shënohet në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së.

4. Në rastet kur për një qendër votimi, gjatë marrjes në dorëzim të kutive nga grupet e marrjes në dorëzim për kutitë me fletët e votimit, konstatohet parregullsi, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, për njërën nga kutitë me fletët e votimit, atëherë ajo kuti vlerësohet si "KUTI E PARREGULLT" dhe dërgohet në këndin e kutive të parregullta, ndërsa kutia me materialet e votimit dhe në rastin e zgjedhjeve vendore kutia tjetër me fletët e votimit i nënshtrohen procedurave, sipas neneve 116 deri në 119 të këtij Kodi.

Në rastin kur për zgjedhjet vendore të dy kutitë me fletët e votimit janë vlerësuar si të parregullta, atëherë të dy kutitë me fletët e votimit dhe kutia përkatëse e materialeve të votimit vendosen në këndin e kutive të parregullta. Në rastin kur vetëm kutia e materialeve të votimit përcaktohet si "KUTI E PARREGULLT", ajo i nënshtrohet procedurave të hapjes dhe numërimit së bashku me kutitë e votimit me fletët e votimit.

5. Kutitë e votimit të përcaktuara si "KUTI E PARREGULLT" në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapen nga KZAZ-ja dhe as nuk i kalojnë Grupit të Numërimit. Ato dërgohen së bashku me kutinë e materialeve të votimit në KQZ për nevoja të hetimit administrativ, sipas nenit 136 dhe nenit 138 pika 4 të këtij Kodi.

6. KZAZ-ja mban Procesverbal Konstatimi, në të cilin shënohen të dhënat për kutitë e votimit me fletët e votimit ose kutitë me materialet e votimit të deklaruara të parregullta, sipas pikave 2, 3 dhe 4 të këtij neni, si dhe të dhëna për pasaktësitë ose parregullsitë e konstatuara gjatë zbatimit të procedurave të nenit 116 të këtij Kodi. Kopje të Procesverbalit të Konstatimit u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare.

7. Anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim, kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KQV-së, si dhe punonjësi i policisë i caktuar për shoqërim nënshkruajnë Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim. Origjinali i Procesverbalit të Marrjes në Dorëzim administrohet nga KZAZ-ja, e cila u jep nga një kopje përkatësisht kryetarit, zëvendëskryetarit të KQV-së dhe punonjësit të policisë të caktuar për shoqërimin. Punonjësi i policisë duhet të largohet menjëherë pas marrjes së kopjes së procesverbalit, e cila dorëzohet së bashku me raportin e shërbimit në komandën e strukturës ku ai bën pjesë.

8. Procesverbali i Marrjes në Dorëzim përgatitet nga KQZ-ja në formën e një formulari tip dhe duhet të përmbajë kohën e marrjes në dorëzim, numrin e qendrës së votimit, vulave me kodet e sigurisë, me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit, hapësirën për përshkrimin e mospërputhjeve ose parregullsive të konstatuara, si dhe hapësirën për nënshkrimet.

9. Kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit, të marra në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim, vendosen në vendin e përcaktuar paraprakisht nga KZAZ-ja. Ky vend duhet të jetë në të njëjtin mjedis ku kryhet numërimi i votave dhe duhet të jetë i garantuar nga çdo ndërhyrje e personave të paautorizuar.

10. Kutitë me fletët e votimit të pranuara si të rregullta në çdo rast u nënshtrohen procedurave të hapjes dhe numërimit në Vendin e Numërimit të Votave, sipas dispozitave të këtij Kodi. Refuzimi për të numëruar sjell shkarkimin e menjëhershëm të personave të ngarkuar për numërimin ose, sipas rastit, KZAZ-së. Refuzimi për të numëruar kutinë e pranuar si të rregullt përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 330/a të Kodit Penal.

Neni 116*

Numërimi i votave

1. KZAZ-ja merr vendim për fillimin e numërimit të votave vetëm pasi të ketë marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit nga të gjitha qendrat e votimit nën juridiksionin e saj. Për Bashkinë e Tiranës, KZAZ-ja e njësisë bashkiake fillon numërimin sipas këtij rendi:

a) kutitë e votimit për Kryetar të Bashkisë së Tiranës;

b) kutitë e votimit për Këshillin Bashkiak të Tiranës;

c) kutitë e votimit për kryetarin e njësisë bashkiake;

ç) kutitë e votimit për këshillin e njësisë bashkiake.

2. Anëtarët e grupeve të numërimit, me radhë dhe vetëm sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, marrin nga stiva e kutive të votimit kutitë e votimit me fletët e votimit të vetëm një qendre votimi dhe i vendosin pranë tryezës së Grupit të Numërimit përkatës. Në vijim, anëtarët e Grupit të Numërimit marrin nga sekretari i KZAZ-së modelin krahasues të vulës së kryetarit të KQV-së, të depozituar në përputhje me pikën 2 të nenit 100 të këtij Kodi.

3. Në vijim, numëruesi i parë vendos mbi tryezë kutinë e votimit me fletët e votimit dhe e hap atë, duke këputur vulat me kodet e sigurisë. Fillimisht Grupi i Numërimit kryen procedurat e verifikimit të të dhënave në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit.

4. Në rast se Procesverbali i Mbylljes së Votimit gjendet në kuti dhe është plotësuar sipas nenit 113 të këtij Kodi, atëherë numërimi vazhdon sipas procedurave të përcaktuara nga ky nen. Në rast se Procesverbali i Mbylljes së Votimit mungon apo të dhënat sipas nenit 113 të këtij Kodi nuk janë plotësuar, zbatohet procedura sipas nenit 116/1 të këtij Kodi.

5. Pas nxjerrjes së Procesverbalit të Mbylljes së Votimit apo plotësimit të Procesverbalit të Konstatimit, numëruesi i parë dhe anëtarët e Grupit të Numërimit nxjerrin nga kutia fletët e votimit dhe zarfin me Procesverbalin e Vulosjes, i shpalosin fletët e votimit dhe i vendosin mbi tryezë me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme.

6. Fletët e votimit të stivuara numërohen nga numëruesi i parë, i cili, në përfundim të numërimit, ia bën të ditur shifrën

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

anëtarëve të grupit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Shifra e deklaruar verifikohet me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve të shënuar në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit. Nëse shifrat nuk përputhen ose nëse kërkohet nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit.

7. Në rast se nga verifikimet e kryera konstatohen mospërputhje, atëherë Grupi i Numërimit ose cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, që bën konstatimin, njofton menjëherë KZAZ-në për mospërputhjet. Njoftimi bëhet me ngritjen e dorës dhe pa lëvizur nga vendi. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të Grupit të Numërimit, derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë. Në rast se KZAZ-ja konfirmon pasaktësinë, e pasqyron atë në Procesverbalin e Konstatimit. Vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në Procesverbalin e Konstatimit, KZAZ-ja merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave nga Grupi i Numërimit. Vendimi i marrë nga KZAZ-ja i bëhet i ditur menjëherë Grupit të Numërimit.

Neni 116/1*

Hapja e kutive të materialeve të votimit

1. Kutia e materialeve të votimit hapet gjatë procesit të numërimit në vendin e numërimit të votave vetëm në rastet kur Procesverbali i Mbylljes së Votimit mungon në kutinë e fletëve të votimit, ose të dhënat sipas nenit 113 të Kodit nuk janë plotësuar në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit.

2. Në këtë rast Grupi i Numërimit ose cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore që bën konstatimin, njofton menjëherë KZAZ-në për problemin. Njoftimi bëhet me ngritjen e dorës dhe pa lëvizur nga vendi. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të Grupit të Numërimit, derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë. Në rast se KZAZ-ja konfirmon pasaktësinë ose parregullsinë, e pasqyron atë në Procesverbalin e Konstatimit. Vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në Procesverbalin e Konstatimit, KZAZ-ja merr vendim për vazhdimin e procedurave të verifikimit të

* Shtuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

materialit të votimit dhe pezullimin e numërimit të votave nga Grupi i Numërimit. Vendimi i marrë nga KZAZ-ja i bëhet i ditur menjëherë Grupit të Numërimit.

3. Kutia me fletët e votimit, numërimi i së cilës është pezulluar, vendoset pranë tavolinës së numërimit dhe numëruesi i parë merr kutinë e materialeve të votimit të qendrës së votimit përkatëse. Më pas Grupi i Numërimit hap kutinë e materialeve të votimit, duke këputur vulat me kodet e sigurisë. Në fillim verifikohet nëse në kuti ndodhet Procesverbali për Mbylljen e Votimit, i plotësuar sipas kërkesave të këtij Kodi. Në këtë rast plotësohet Procesverbali i Konstatimit dhe Procesverbali për Mbylljen e Votimit i jepet KZAZ-së. Më pas kutia mbyllet me kode sigurie dhe Grupi i Numërimit vazhdon me numërimin e votave, sipas procedurave të përcaktuara në pikën 5 e në vijim të nenit 116 të këtij Kodi.

4. Kur Procesverbali për Mbylljen e Votimit nuk gjendet as në kutinë e materialeve të votimit apo nuk është plotësuar sipas nenit 113, Grupi i Numërimit plotëson Procesverbalin e Konstatimit dhe më pas ndjek këto procedura:

a) verifikon nëse në kuti ndodhen:

i) zarfi “FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA”;

ii) zarfi “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA”;

iii) lista e zgjedhësve, përfshirë edhe regjistrin e posaçëm, sipas nenit 57 të këtij Kodi;

iv) origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të papërdorur të vendimeve të KQV-së;

v) vula e KQV-së;

vi) vula e kryetarit të KQV-së;

vii) vulat me kodet e sigurisë të papërdorura;

viii) vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara, nëse ka;

ix) Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së; dhe

x) dokumentacioni shoqërues i fletëve të votimit me seritë përkatëse;

b) numëruesi i parë fillimisht krahason vulën e kryetarit të KQV-së me modelin krahasues dhe mendimin e tij ua bën të ditur anëtarëve të grupit;

c) numëruesi i parë numëron fletët e votimit të papërdorura dhe në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të

Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të papërdorura;

ç) numëruesi i parë numëron fletët e votimit të dëmtuara dhe në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtareve të Grupit të Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të dëmtuara;

d) numëruesi i parë numëron zgjedhësit që kanë votuar, sipas nënshkrimeve që kanë bërë në listën e zgjedhësve, përfshirë edhe ata sipas nenit 57 të këtij Kodi, dhe në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit. Nëse shifrat nuk përputhen ose nëse kërkohet nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e zgjedhësve që kanë votuar. Vërejtjet shënohen në Procesverbalin e Konstatimit;

dh) numëruesi i parë hedh të dhënat për numrin total të fletëve të votimit të dorëzuara në KQV, sipas dokumentacionit shoqërues të tyre;

e) më pas kutia mbyllet me kode sigurie dhe Grupi i Numërimit vazhdon me numërimin e votave, sipas procedurave të përcaktuara në pikën 5 e në vijim të nenit 116 të këtij Kodi.

5. Në përfundim të numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të ZAZ-së, kutitë e materialeve të votimit dërgohen në KQZ së bashku me kutitë e votimit. Kutitë e materialeve të votimit hapen në KQZ gjatë fazës së shqyrtimit të ankimit, në përputhje me nenin 136 dhe/ose pikën 1 të nenit 138 të Kodit, nëse provat e kërkuara administrohen sipas këtij Kodi, në kutinë e materialeve të votimit.

Neni 117*

Llojet e votave dhe kriteret për vlerësimin e votës

1. Fletët e votimit ndahen në vota të vlefshme ose në vota të pavlefshme.

2. Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore apo partinë politike pjesëtare të koalicionit në fletën përkatëse të votimit.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja;

b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në nenin 103 të këtij Kodi;

c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;

ç) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;

d) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;

dh) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;

e) nuk është e qartë se për kë është votuar; ose

ë) zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.

4. Vlerësimi i votave synon të identifikojë, sa të jetë e mundur, qëllimin e zgjedhësit. Në zbatim të këtij neni, KQZ-ja përgatit udhëzues të veçantë për të lehtësuar punën dhe unifikuar praktikën e vlerësimit të fletëve nga ana e komisioneve dhe personave të ngarkuar nga ky Kod për numërimin dhe vlerësimin e votave.

Neni 118*

Vlerësimi i votave

1. Vlerësimi i votave fillon menjëherë pas kryerjes së numërimit të fletëve të votimit. Numëruesi i parë i Grupit të Numërimit hap në mënyrë të plotë çdo fletë votimi, bën vlerësimin e saj me zë të lartë, duke vepruar sipas kësaj radhe:

a) verifikon nëse fleta e votimit ka të njëjtën madhësi, formë dhe ngjyrë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja; në rast të kundërt e vlerëson votën të pavlefshme;

b) verifikon nëse në fletën e votimit është vula e KQV-së dhe vula e kryetarit të KQV-së; në rast të kundërt e vlerëson votën të pavlefshme;

c) verifikon nëse ekziston ndonjë nga shkaqet e tjera për

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

deklarimin e votës së pavlefshme, të parashikuara në shkronjat “c” deri “ë” të nenit 117 të këtij Kodi; nëse ekziston një nga këto shkaqe, e vlerëson votën të pavlefshme.

2. Numëruesi i parë i Grupit të Numërimit, në rast se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, çmon dhe pastaj u propozon për vlerësim anëtarëve të tjerë se cilës partie politike apo kandidati i është hedhur vota. Numëruesi i parë është i detyruar t’ia tregojë fletët e votimit anëtarëve të grupit të numërimit, si dhe të mundësojë leximin e fletës nga ana e kamerës regjistruese të vendosur sipas pikës 4 të nenit 94 të këtij Kodi.

Nëse anëtarët e Grupit të Numërimit dhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhore në numërim janë dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, fleta e votimit ndahet sipas vlerësimit dhe numëruesi i parë merr fletën tjetër të votimit.

Nëse ndonjë anëtar i grupit të numërimit ose ndonjë prej vëzhguesve të subjekteve zgjedhore s’është dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, ky i fundit e vendos fletën e votimit të kundërshtuar në një vend të veçantë për fletët e votimit të kontestuara dhe vijon me fletën tjetër të votimit.

3. Fletët e votimit, sipas vlerësimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ndahen mbi tryezën e punës në vende të caktuara dhe të veçanta në grupime të votave për çdo subjekt zgjedhor, në vota të pavlefshme dhe vota të kontestuara. Në rastin e koalicioneve votat e vlefshme të secilës prej partive anëtare të koalicionit grupohen veçmas dhe pranë njëra-tjetrës, duke identifikuar votat për secilën prej partive anëtare të koalicionit.

4. Në përfundim të numërimit të fletëve të votimit për çdo kuti votimi, Grupi i Numërimit rivlerëson fletët e votimit të kontestuara, sipas paragrafit të tretë të pikës 2 të këtij neni.

Në rast se edhe pas rivlerësimit ka fletë votimi të kontestuara, numëruesi i parë ose çdo anëtar thërret KZAZ-në për vlerësimin e votave të kontestuara të asaj kutie. KZAZ-ja bën vlerësimin në çast të secilës fletë votimi të kontestuar dhe merr vendim në lidhje më të. Rezultati i shpallur nga KZAZ-ja shënohet në librin e protokollit të KZAZ-së dhe përfshihet në tabelën përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit që harton grupi i numërimit të votave.

5. Për secilën fletë të kontestuar, në pjesën e prapme të saj numëruesi i parë i Grupit të Numërimit shënon qartë arsyet e kontestimit.

Për votat e kontestuara mbahet një procesverbal i veçantë, sipas modelit të përcaktuar me vendim të KQZ-së, në të cilin pasqyrohet numri i përgjithshëm i fletëve të votimit të kontestuara për QV-në përkatëse. Në përfundim të nxjerrjes së rezultatit, sipas nenit 119 të këtij Kodi, fletët e votimit të kontestuara dhe procesverbali përkatës futen në zarfin e "FLETËVE TË VOTIMIT TË KONTESTUARA".

6. Pas numërimit dhe vlerësimit të votave, sipas këtij neni, për çdo kuti me fletët e votimit, numëruesi i parë numëron votat për çdo subjekt zgjedhor, duke filluar sipas renditjes së subjekteve në fletën e votimit. Pas çdo numërimi, shifrën ia bën të ditur anëtarëve të Grupit të Numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Nëse kërkohet nga ndonjë anëtar i Grupit të Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e votave për atë subjekt.

Në rast se pas edhe këtij numërimi të dytë ka përsëri kundërshtime, numëruesi i parë i Grupit të Numërimit ose anëtari kundërshtues njofton KZAZ-në nëpërmjet ngritjes së dorës. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të Grupit të Numërimit deri në marrjen e vendimit nga KZAZ-ja. KZAZ-ja numëron në vend votat për subjektin zgjedhor, objekt kundërshtimi dhe urdhëron Grupin e Numërimit të shënojë shifrën e vendosur prej saj në tabelën e rezultateve për atë qendër votimi.

7. Numëruesi i parë dhe sekretari i Grupit të Numërimit të Votave përgjigjen për zbatimin e detyrimeve që lindin nga kontestimi i fletës së votimit, sipas këtij neni. Shkelja e këtij detyrimi ndëshkohet me gjobë sipas nenit 171 të këtij Kodi.

Neni 119*

Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve nga Grupi i Numërimit

1. Në përfundim të procedurës së përcaktuar në nenin 118 të këtij Kodi, numëruesi i parë, së bashku me anëtarët e tjerë të Grupit

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

të Numërimit, plotëson tabelën e rezultateve për atë qendër votimi, sipas formularit tip të përcaktuar nga KQZ-ja.

2. Tabela origjinale e rezultateve të votimit, sipas pikës 1 të këtij neni, duke përfshirë edhe kundërshtimet, nëse ka, të anëtarit të Grupit të Numërimit, i dorëzohet menjëherë dorazi KZAZ-së nga Grupi i Numërimit. Kopje e tabelës së rezultateve i jepet çdo anëtari të Grupit të Numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Nëse ndonjë nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore ka kundërshtime në lidhje me rezultatet e pasqyruara në tabelë, ato shënohen menjëherë në librin e protokollit të KZAZ-së.

Një kopje dërgohet menjëherë në rrugë elektronike në KQZ. KQZ-ja i publikon në faqen e internetit menjëherë rezultatet zyrtare për çdo qendër votimi sapo i merr ato zyrtarisht nga KZAZ-ja. Publikimi duhet të saktësojë se rezultati është paraprak.

3. Pas kryerjes së procedurave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, fletët e votimit futen në zarfe të ndara, sipas subjekteve zgjedhore, me përjashtim të fletëve të votimit të kontestuara, kurse votat e pavlefshme në zarfin me shënimin "VOTA TË PAVLEFSHME". Zarfet me fletët e votimit për subjektet zgjedhore, zarfi me fletët e votimit të pavlefshme, zarfi me fletët e votimit të kontestuara dhe zarfi me Procesverbalin e Vulosjes futen në kutinë e votimit. Kutia mbyllet me vula me kode sigurie të reja. Numrat e kodeve shënohen në tabelën e rezultateve.

Një kopje e Procesverbalit të Vulosjes, së bashku me Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, i dorëzohet sekretarit të KZAZ-së, i cili përgjigjet për administrimin e tyre. Kutia mbyllet me vula me kode sigurie të reja. Një kopje e Procesverbalit të Vulosjes i jepet dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.

Pas kësaj, në rastet e zgjedhjeve vendore kutia rivendoset pranë tryezës së Grupit të Numërimit dhe merret kutia me fletët e votimit për këshillin. Grupi i Numërimit, për kutitë e votimit me fletët e votimit për partitë politike ose koalicionet zgjedhore, në rastin e zgjedhjeve vendore, kryen të njëjtat veprime të përcaktuara në nenet 116 deri në 119 të këtij Kodi.

4. Grupi i Numërimit merr nga stiva e kutive të votimit kutitë me fletët e votimit të qendrës tjetër të votimit, vetëm pasi ka dërguar në vendin e caktuar brenda sallës së Vendit të Numërimit të Votave kutitë e përpunuara dhe i ka dorëzuar KZAZ-së tabelën e rezultateve përkatëse për qendrën e votimit të numëruar.

5. Procesi i numërimit vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në numërimin e të gjitha kutive të pranuara të rregullta nga ana e KZAZ-së. Procesi i numërimit ndërpritet me vendim të KZAZ-së, vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore dhe që pengojnë procesin normal të numërimit. Shkaqet argumentohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, përfshirë dhe vendimin për rifillimin e numërimit.

Neni 120*

Radha e numërimit për zgjedhjet e pushtetit vendor

1. Për zgjedhjet e pushtetit vendor KZAZ-ja i vendos kutitë të grupuara sipas njësive të qeverisjes vendore dhe brenda njësisë, sipas organit përkatës. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të Tiranës, kutitë grupohen sipas organit për të cilin është votuar.

2. Procesi i numërimit, sipas këtij kreu, fillon nga njësia e qeverisjes vendore me numrin më të madh të zgjedhësve dhe vazhdon në rend zbritës. Për çdo njësi të qeverisjes vendore, numërimi fillon me votat për kryetarin dhe më pas vijon me numërimin e votave për këshillin përkatës. Në zgjedhjet për njësitë e qeverisjes vendore të Tiranës numërimi fillon me votat për Kryetarin e Bashkisë, vijon me këshillin bashkiak, pastaj me kryetarin e njësisë bashkiake dhe përfundon me ato të këshillit të njësisë bashkiake.

3. Numërimi i votave për një organ nuk fillon pa mbaruar numërimi i të gjitha kutive të organit pararendës.

4. Në përfundim të numërimit të një kutie, plotësohet tabela e rezultatit të saj, sipas nenit 122 të këtij Kodi. Tabela e rezultatit të qendrës së votimit përmban edhe një rubrikë për votat për organet e tjera, por të hedhura gabim në atë kuti, e cila specifikon qartë numrin e fletëve të hedhura gabim në atë kuti, të ndara sipas organit për të cilin janë hedhur.

5. Grupi i numërimit, kur konstaton fletë të tilla i lë ato mënjanë të palosura dhe pa bërë vlerësim. Në përfundim të numërimit të kutisë, këto fletë futen në zarfin me shënimin “VOTA TË HEDHURA

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

GABIM”, të ndara në zarfe të veçanta, sipas llojit të organit për të cilin janë hedhur. Në tabelën e rezultatit shënohet në rubrikën e veçantë numri i votave të hedhura gabim për secilin organ tjetër të gjendur në atë kuti. Kutia vijuese hapet vetëm pasi të kenë përfunduar procedurat dhe të jetë vulosur kutia paraardhëse.

6. Në përfundim të kutisë së fundit që numëron GNV-ja përkatëse, numëruesi i parë plotëson një procesverbal konstatimi, ku shënon numrin e fletëve të hedhura gabim për secilin organ, që gjenden në secilin zarf. Zarfet me votat e hedhura gabim mbyllen dhe i dorëzohen KZAZ-së bashkë me procesverbalin e konstatimit. Kjo e fundit hap zarfet, bën shënimet përkatëse në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe hedh këto vota në kuti të posaçme, pa i hapur fletët e votimit. Këto kuti janë të njëjta me kutitë e votimit, si dhe hapen dhe mbyllen sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod për kutitë e votimit. KZAZ-ja disponon nga një kuti për votat e hedhura gabim për secilin organ për të cilin votohet në territorin e saj.

7. Në përfundim të numërimit të të gjitha kutive për një organ, KZAZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse Provizore të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, në të cilën pasqyrohet rezultati për organin për secilën qendër votimi. Kjo tabelë nuk përmban rezultatin e kutisë me vota për organin përkatës, por të hedhura në kutinë e gabuar, i cili përcaktohet sipas pikës 8 të këtij neni.

Rezultati i pasqyruar në Tabelën Përmbledhëse Provizore të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së nuk është përfundimtar. Tabela dhe çdo publikim i saj duhet të mbajë shënimin që ky rezultat nuk është përfundimtar.

8. Në përfundim të numërimit të votave për të gjitha kutitë e ZAZ-së, KZAZ-ja cakton menjëherë një prej Grupeve të Numërimit të Votave për kryerjen e vlerësimit dhe numërimit të votave të hedhura në kutitë e gabuara për secilin organ, të administruara sipas këtij neni. Numërimi i këtyre votave bëhet sipas procedurave të neneve 116, 117 dhe 118 të këtij Kodi. Kutia me vota të hedhura gabim për një organ hapet në përfundim të numërimit të kutive për organin përkatës.

9. Rezultati i kutisë hidhet në një tabelë rezultatesh të veçantë për votat e hedhura gabim, e cila përcakton organin për të cilin janë hedhur ato vota. Tabela plotësohet dhe nënshkruhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 119 të këtij Kodi.

10. Në përfundim të procedurës së përcaktuar në pikën 8 të këtij neni, KZAZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, e cila plotësohet duke pasqyruar rezultatin e çdo kutie të numëruar dhe atë për kutinë e votave të hedhura gabim, të plotësuar sipas pikës 8 të këtij neni.

Neni 121

Personat e pranishëm gjatë procesit të numërimit të votave

1. Gjatë procesit të numërimit të votave, në Vendin e Numërimit të Votave janë të pranishëm vetëm anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së, anëtarët e grupeve të numërimit, kandidatët, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, vëzhgues të tjerë të akredituar, përfaqësuesit e akredituar të medias, si dhe personeli teknik për mbarëvajtjen e sistemit të kamerave, i autorizuar nga KQZ-ja.

2. KZAZ-ja merr masa dhe është përgjegjëse për moslejimin e personave të tjerë në Vendin e Numërimit të Votave, përveç atyre të parashikuar në pikën 1 të këtij neni. Në rast të pranisë së personave të tjerë, përveç atyre sipas pikës 1 të këtij neni, KZAZ-ja, me vendim, njofton menjëherë punonjësit e Policisë së Shtetit dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, duke përfshirë edhe orën e saktë të ardhjes dhe largimit të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Neni 122*

Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve nga KZAZ-ja

1. Tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZAZ-ja jo më vonë se ora 22^{00} e ditës së nesërme të votimit.

2. Menjëherë pas përfundimit të numërimit, sipas procedurave të përcaktuara në nenet 116 deri në 119 të këtij Kodi, KZAZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve për zonën që administron, në të cilën pasqyrohen rezultatet e çdo subjekti për çdo qendër votimi, sipas origjinaleve të tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi të plotësuar nga grupet e numërimit.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

3. Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së miratohet me vendim të KZAZ-së. Në rast të kundërt veprohet në përputhje me nenin 35 pika 5 të këtij Kodi. Një kopje e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve dhe tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi, dërgohet menjëherë në KQZ, përfshirë edhe rrugët elektronike të komunikimit.

4. Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, tabelave të rezultateve të qendrave të votimit dhe kopje të Procesverbalit të Konstatimit u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, ndërsa origjinalet e tyre, vulat dhe çdo material tjetër zgjedhor dorëzohen në KQZ.

5. Në rast të zgjedhjeve vendore, KZAZ-ja miraton me vendim tabelat e rezultateve për çdo njësi të qeverisjes vendore, sipas të njëjtave kritere dhe procedura të përshkruara në këtë nen. Vendimi ankimohet sipas procedurave të përcaktuara në pjesën X të këtij Kodi.

6. Për zgjedhjet e Kryetarit dhe Këshillit Bashkiak të Bashkisë së Tiranës, KZAZ-ja miraton Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Qendrave të Votimit të njësisë bashkiake përkatëse. Kopja origjinale e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve dhe Tabelat e Rezultateve për çdo qendër votimi i dërgohen KQZ-së për të nxjerrë rezultatin, sipas nenit 123 të këtij Kodi.

Neni 123*

Nxjerrja e rezultateve nga KQZ-ja

1. KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për zonën zgjedhore për Kuvendin apo për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse. Për këtë, KQZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore dhe e miraton atë me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbërritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore.

2. Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për Zonën Zgjedhore, sipas pikës 1 të këtij neni, KQZ-ja kontrollon kryesisht ose me kërkesë të palëve përpara marrjes së vendimit, sipas këtij neni, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone. Kur KQZ-ja konstaton se tabela e rezultateve të një ZAZ-je nuk përfshin tabelat e të gjitha qendrave të votimit të asaj ZAZ-je, kutitë e së cilës janë pranuar të rregullta, urdhëron KZAZ-në që të plotësojë menjëherë tabelën dhe ta ridërgojë në KQZ brenda 24 orëve. Në rast mosplotësimi brenda këtij afati, tabela plotësohet nga KQZ-ja. Në rast se votat e një kutie të pranuar si të rregullt nuk janë numëruar, KQZ-ja urdhëron numërimin fillestar të votave të panumëruara të qendrës së votimit që nuk është përfshirë në tabelën e rezultateve. Afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni fillon pas plotësimit të secilës tabelë rezultati ZAZ-je, sipas kësaj pike.

Në çdo rast Tabela Përmbledhëse e Rezultatit për Zonën Zgjedhore, sipas këtij neni, nuk mund të miratohet nga KQZ-ja, pa numëruar të gjitha kutitë e pranuara të rregullta, sipas këtij Kodi, në të kundërt vendimi i miratimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, është i pavlefshëm.

3. Kur gjatë hartimit të tabelës, sipas pikës 1 të këtij neni, KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vëren mospërputhje të shifrave të votave për subjektet të tabelës së rezultatit të ZAZ-së me tabelat e rezultateve të qendrave të votimit, merr vendim për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore me shifrat e korrigjuara, duke u bazuar në origjinalet e tabelave të qendrave të votimit. Një kopje e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore u jepet të gjitha subjekteve zgjedhore që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e zonës zgjedhore përkatëse.

4. Vendimi i KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, mund të ankimohet po në KQZ, sipas procedurave të parashikuara në pjesën X të këtij Kodi.

5. Vendimi i KZAZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve të ZAZ-së, çdo vendim i KZAZ-së, i marrë gjatë procedurës së marrjes në dorëzim të materialeve dhe dokumentacionit zgjedhor nga KQV-të, si dhe gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të votimit, janë vendime të ndërmjetme dhe ankimohen në KQZ së bashku me ankimin kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas pikës 1 të këtij neni.

PJESA X
ANKIMI NË RRUGË ADMINISTRATIVE I VENDIMEVE TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE

Neni 124*
E drejta e ankimit

1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

2. Kundër vendimit të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njësive të qeverisjes vendore nën juridiksionin e saj, të marrë sipas nenit 122 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.

3. Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.

4. Në çdo rast ankimi për pavlefshmëri, sipas nenit 160, dhe ankimi për ndryshimin e tabelës së rezultatit paraqitet në të njëjtën kërkesë ankimore, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni. Në kërkesë përcaktohen qendrat e votimit, për të cilat kërkohet ndryshimi i rezultatit apo pavlefshmëria.

5. Të drejtën e ankimit, sipas pikës 1 të këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, si dhe subjektet e përmendura në nenin 6 të këtij Kodi, kundër refuzimit të kërkesave për akreditim

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

të vëzhguesve, në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve. Vendimet e KQZ-së për regjistrimin apo refuzimin për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor, të marra në zbatim të pjesës IV të këtij Kodi, ankimohen sipas kreut I të pjesës XI të këtij Kodi në Kolegjin Zgjedhor.

6. Në shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura, KQZ-ja shqyrton të gjithë problematikën e tyre, përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, pa u kufizuar në objektin e kërkimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor.

Neni 125*

Llogaritja e afateve

1. Afatet që në pjesën X dhe XI të këtij Kodi janë përcaktuar me orë llogariten duke përjashtuar orën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ. Në të gjitha rastet kur afatet në këtë Kod llogariten me orë, organi administrativ i ngarkuar nga ky Kod është i detyruar të shënojë në aktin administrativ orën e shpalljes së aktit. Në rast të kundërt, afati llogaritet duke filluar nga ora 8^{00} e ditës pasardhëse.

2. Afatet që në këtë pjesë janë përcaktuar me ditë llogariten duke përjashtuar ditën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ.

3. Në rast se plotësimi i afateve, sipas pikës 2 të këtij neni, bie jashtë orarit zyrtar të punës, të përcaktuar në vendimin e KQZ-së, atëherë ecja e afatit pezullohet në orën e mbarimit të orarit zyrtar dhe rifillon në orën e fillimit të orarit zyrtar në ditën pasardhëse.

4. Në rast se plotësimi i afateve bie në ditët e pushimeve ose festave zyrtare, afati fillon në ditën më të parë pasardhëse të punës.

5. Për afatet e ankimit, sipas kësaj pjese, nuk mund të ketë rivendosje në afat.

6. Për efekt të këtij neni, në rast se nga KQZ-ja nuk është përcaktuar ndryshe me vendim, orar zyrtar i punës llogaritet koha nga ora 8^{00} deri në orën 16^{00} dhe ditë pushimi janë dita e shtunë dhe dita e diel.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Neni 126

Forma dhe përmbajtja e ankimit kundër vendimeve të KZAZ-së dhe vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve

1. Ankimi zgjedhor kundër vendimeve të KZAZ-së ose vendimit të KQZ-së, sipas nenit 123 të këtij Kodi, paraqitet në formën e kërkesës ankimore dhe duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

a) emrin e plotë të subjektit zgjedhor ankues dhe adresën e tij;

b) referimin te vendimi që ankimohet;

c) bazën ligjore;

ç) përshkrimin e shkurtër të shkeljes së pretenduar;

d) përshkrimin e fakteve, argumenteve dhe dispozitave ligjore, tek të cilat ai mbështet ankimin;

dh) tregimin e provave, të cilat kërkon të marrë gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit, si dhe burimin e tyre; dhe

e) datën dhe firmën e ankuesit.

Kërkesa për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve përmban, për aq sa është e mundur, elementet e parashikuara në këtë pikë.

2. Subjekti zgjedhor ankues duhet të depozitojë, së bashku me ankimin, edhe vendimin e plotë, ndaj të cilit ushtron ankimin, me përjashtim të rastit kur KZAZ-ja nuk merr vendim.

Neni 127*

Regjistrimi i kërkesave ankimore nga KQZ-ja

1. Kërkesat ankimore depozitohen në selinë e KQZ-së. KQZ-ja krijon dhe mban një regjistër të posaçëm për regjistrimin e kërkesave ankimore. Regjistri i Ankimeve Zgjedhore është i vlefshëm vetëm për zgjedhjet në proces.

2. Regjistri i Ankimeve Zgjedhore përmban:

a) numrin rendor të kërkesës ankimore;

b) datën dhe orën e paraqitjes së ankimit;

c) subjektin ankimues;

ç) objektin e ankimit;

d) numrin dhe llojin e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës ankimore.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

3. Pas bërjes së shënimeve në regjistër, subjekti që ankohet merr nga KQZ-ja një vërtetim, i cili provon dorëzimin dhe marrjen e kërkesës ankimore.

4. KQZ-ja nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e kërkesave ankimore.

5. Regjistri i Ankimeve Zgjedhore është vetëm për zgjedhjet e radhës. Hapja e Regjistrit të Ankimeve Zgjedhore për zgjedhjet e radhës bëhet jo më vonë se 24 orë nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse. Në këtë regjistër shënohen edhe kërkesat ankimore për zgjedhjet e pjesshme që zhvillohen midis dy zgjedhjeve të përgjithshme.

Neni 128

(Shfuqizuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19 korrik 2012)

Neni 129

Verifikimi i plotësimit të formës dhe përmbajtjes së kërkesës ankimore

1. Për çdo kërkesë ankimore të regjistruar KQZ-ja cakton me short si relator njërin nga anëtarët e saj. Relatori bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës, sipas nenit 126 të këtij Kodi dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të këtij Kodi. Rezultati i verifikimit relatohet në mbledhjen e KQZ-së jo më vonë se 24 orë nga çasti i regjistrimit të kërkesës ankimore.

2. Rregullat për hedhjen e shortit për caktimin e relatorit, sipas pikës 1 të këtij neni, caktohen me vendim të KQZ-së.

3. KQZ-ja bën verifikimin paraprak të kërkesës ankimore dhe vendos:

a) kalimin e kërkesës për shqyrtim;

b) mospranimin e kërkesës për shkak të mungesës së elementeve të përcaktuara në nenin 130 të këtij Kodi; ose

c) kthimin e kërkesës për plotësim të elementeve të formës, të përcaktuara në nenin 126 të këtij Kodi.

4. Në rastin e parashikuar në shkronjën “c” të pikës 3 të këtij neni, ankuesi bën plotësimin e kërkesës dhe e ridepoziton atë brenda 24 orëve nga çasti i shpalljes së këtij vendimi. Kërkesa

ankimore mund të kthehet për plotësim vetëm një herë. Verifikimi i dytë i kërkesës ankimore kryhet brenda 24 orëve nga ridepozitimi i saj.

Neni 130
Objekti i verifikimit paraprak

KQZ-ja merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon elementet e mëposhtme:

a) kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit;
b) legjitimimin e ankuesit; dhe
c) respektimin e afateve ligjore për ankimin.

Neni 131
Përmbajtja e vendimit të pranimit për shqyrtim të kërkesës ankimore

1. Në vendimin e pranimit për shqyrtim të kërkesës ankimore, KQZ-ja duhet të përcaktojë datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në seancë publike. Vendimi afishohet për publikun në hyrjen e selisë së KQZ-së jo më vonë se dy orë pas marrjes së tij.

2. Seanca e shqyrtimit zhvillohet jo më parë se 24 orë dhe jo më vonë se 48 orë nga data e shpalljes së vendimit të pranimit.

Neni 132*
Bashkimi i kërkesave ankimore

1. Shqyrtimi i kërkesave ankimore ndaj rezultatit të një zone zgjedhore, sipas nenit 124, fillon vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 124 të këtij Kodi. KQZ-ja, përpara ose gjatë shqyrtimit të një kërkese ankimore, vendos shqyrtimin bashkërisht të saj me një ose më shumë kërkesa të tjera ankimore, të paraqitura nga subjekte të ndryshme kundër të njëjtit vendim të KZAZ-së, sipas nenit 122 apo, sipas rastit, të KQZ-së, sipas nenit 123 për rezultatin dhe/ose pavlefshmërinë e votimit.

2. Kur për të njëjtën zonë zgjedhore janë paraqitur në KQZ disa kërkesa ankimore dhe kur të paktën njëra prej tyre ka në objekt

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, KQZ-ja merr në shqyrtim fillimisht pretendimin për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në ato qendra votimi. Vendimi i KQZ-së për pavlefshmërinë e një apo më shumë qendrave votimi, sipas nenit 160, është vendim i ndërmjetëm dhe mund të ankohet në Kolegjin Zgjedhor bashkë me vendimin e KQZ-së që zgjidh ankimin e paraqitur sipas nenit 124 të këtij Kodi.

3. Vendimi i KQZ-së për bashkimin e kërkesave ankimore është i formës së prerë.

4. Vendimi i KQZ-së për bashkimin e kërkesave ankimore shpallet për publikun në hyrjen e selisë së KQZ-së jo më vonë se dy orë pas marrjes së tij.

Neni 133

Palët në shqyrtimin administrativ

1. Në shqyrtimin e ankimit nga KQZ-ja kanë të drejtë të marrin pjesë, duke paraqitur kërkesa, duke ngritur pretendime dhe duke bërë prapësime të pretendimeve të ngritura, si dhe duke paraqitur prova vetëm:

a) ankuesi;

b) pala e interesuar. Palë e interesuar është çdo subjekt zgjedhor, të drejtat dhe interesat e ligjshëm të të cilit, qofshin këta individualë ose të përbashkët, preken ose kanë të ngjarë të preken nga vendimi që mund të jepet në përfundim të procedurës administrative.

2. Pala e interesuar depoziton kërkesën e saj për të marrë pjesë në shqyrtimin e një ankimi, jo më vonë se ora e caktuar për zhvillimin e seancës. Depozitimi jashtë këtij afati passjell mospranimin e kërkesës.

3. Pranimi i palës së interesuar në procedurën administrative bëhet me vendim të KQZ-së në fillim të seancës përkatëse dhe pas verifikimit të pjesëmarrjes së palëve të tjera.

4. Palët kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë procedurës administrative nga përfaqësues të autorizuar prej tyre ose me deklarim në seancë. Subjektet zgjedhore të përfaqësuara në KQZ, si rregull, përfaqësohen nga përfaqësuesit e akredituar të tyre në KQZ.

Neni 134
Shqyrtimi administrativ

1. Shqyrtimi administrativ për kërkesën ankimore zgjedhore zhvillohet nga KQZ-ja në seancë plenare.

2. Kryetari i KQZ-së drejton seancën plenare.

3. Afatet për kryerjen e veprimeve hetimore administrative caktohen nga KQZ-ja në konsultim me palët.

4. Shqyrtimi i kërkesës ankimore përpara KQZ-së bëhet verbalisht, por palët mund të parashtrojnë me shkrim shpjegimet dhe pretendimet e tyre rreth çështjes.

5. Gjatë shqyrtimit të kërkesës ankimore mbahet procesverbal nga një punonjës i caktuar nga KQZ-ja dhe, për sa është e mundur, seanca plenare regjistrohet me zë dhe/ose me figurë. Në procesverbal shënohen në mënyrë të përmbledhur shpjegimet e palëve dhe pasqyrohen në mënyrë të plotë provat që merren, si dhe urdhrat e vendimet e ndërmjetme të KQZ-së.

Neni 135
Çelja e seancës për shqyrtimin e kërkesës ankimore

1. Në ditën dhe në orën e caktuar palët njoftojnë sekretarinë e ngritur posaçërisht nga KQZ-ja për praninë e tyre.

2. Përpara fillimit të seancës, administrata e KQZ-së thërret palët ose përfaqësuesit e tyre dhe i fton të zënë vendet e caktuara.

3. Pasi deklarohet çelja e seancës së shqyrtimit, verifikohet legjitimimi procedural i palëve, sipas nenit 133 këtij Kodi.

4. Në qoftë se në ditën dhe në orën e caktuar njëra ose disa prej palëve nuk paraqiten, seanca zhvillohet pavarësisht pjesëmarrjes së tyre.

5. Përpara se palët të paraqesin pretendimet e tyre, KQZ-ja:

a) pranon ose refuzon deklarimet individuale të anëtarëve të KQZ-së për ekzistencën e konfliktit të interesit, sipas nenit 17 pika 3 të këtij Kodi;

b) vendos lidhur me kërkesat e palëve për përjashtimin e anëtarëve të KQZ-së për ekzistencën e konfliktit të interesit, në përputhje me nenin 17 pika 4 të këtij Kodi;

c) vendos lidhur me kërkesat e palëve apo të relatorit për mosshqyrtimin e çështjes për mungesë kompetence të KQZ-së ose kalim të afatit për ankim.

6. Pasi merr vendim për kërkesat paraprake të palëve dhe në rast se ato nuk sjellin pushimin e shqyrtimit administrativ, KQZ-ja shqyrton dhe zgjidh çështjen në themel, pa ndërprerë seancën. Seanca ndërpritet vetëm kur është e nevojshme marrja e provave nga të tretë.

Neni 136*

Paraqitja e pretendimeve dhe kërkimi i provave

1. Në përfundim të veprimeve të përcaktuara në nenin 135 të këtij Kodi, KQZ-ja fton palët të paraqesin pretendimet e tyre dhe:

a) të japin shpjegime rreth kërkesave të parashtruara në ankim;

b) të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Llojet e provave përcaktohen në Kodin e Procedurës Civile; dhe

c) të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre.

2. Pas paraqitjes së pretendimeve të palëve, KQZ-ja, me kërkesë të secilës prej tyre ose kryesisht, mund të vendosë marrjen e provave të tjera kur çmon se marrja e tyre është në dobi të gjykimit.

3. Kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtruar debatit ose votimit në KQZ. KQZ-ja është e detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara.

4. KQZ-ja mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara. Arsyetimi i KQZ-së për refuzimin e marrjes së provës jepet i detajuar në vendimin

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

përfundimtar. KQZ-ja nuk mund të refuzojë kërkesën për prova, të bërë sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Paraqitja e pretendimeve të palëve fillon me ankuesin dhe vijon me palët e interesuara, sipas radhës së caktuar nga Kryetari i KQZ-së. Kjo radhë ruhet gjatë gjithë procedimit.

6. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në këtë nen, kur KQZ-ja çmon se një fakt, rrethanë ose ngjarje ka ndodhur, ajo merret si provë, pavarësisht nëse nuk është pasqyruar në ndonjë dokument zgjedhor.

Neni 137

Detyrimi i organeve të tjera për të vënë në dispozicion prova

1. KQZ-ja u kërkon organeve të administratës publike të vënë në dispozicion informacione, dokumente ose çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ.

2. Organet e administratës publike janë të detyruara të vënë në dispozicion provat, sipas pikës 1 të këtij neni, me marrjen e kërkesës së KQZ-së dhe brenda afatit të përcaktuar në të.

3. Në qoftë se organi i administratës publike, pa shkaqe të ligjshme, refuzon plotësimin e kërkesës ose nuk e plotëson atë në afat, KQZ-ja, në përputhje me nenin 172 të këtij Kodi, gjobit ose, sipas rastit, kallëzon për ndjekje penale personat përgjegjës të përcaktuar në nenin 4 të këtij Kodi.

Neni 138*

Këqyrja e materialit zgjedhor

1. Për nevojat e hetimit administrativ, KQZ-ja, kur ka pranuar kërkesën e palëve apo sipas parashikimeve të nenit 136 pika 3 të këtij Kodi, këqyr dokumentacionin dhe materialin zgjedhor që ndodhet në kutinë e materialeve të votimit dhe/ose kutitë e votimit dhe fletët e votimit, si dhe çdo dokumentacion apo material tjetër zgjedhor. Kur materiali zgjedhor ndodhet brenda kutive me vula sigurie, hapja dhe rimbyllja e tyre bëhet sipas procedurave që parashikon ky Kod për hapjen dhe mbylljen e kutive, duke treguar dhe shënuar kodet

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

me të cilat kutitë përkatëse janë mbyllur nga KZAZ-ja, si dhe numrat me të cilat ato mbyllen rishtazi.

2. Këqyrja e materialit zgjedhor bëhet në prani të palëve dhe publikut. Pas këqyrjes së materialit dhe/ose dokumentacionit zgjedhor, palët kanë të drejtë të paraqesin vlerësimet dhe pretendimet e tyre. Provat e gjetura paraqiten në procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së.

3. KQZ-ja, me kërkesë të palëve ose kryesisht, kur çmon se për dhënien e vendimit është i nevojshëm rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave të caktuara, kryen, në praninë e palëve, rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave dhe pasqyron përfundimin në procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së dhe vendimin përkatës të saj. Vota të caktuara janë votat e identifikuara ose të kontestuara, sipas procedurave të neneve 116 dhe 118 të këtij Kodi, për të cilat është kontestuar vlerësimi ose numri i tyre gjatë procesit të numërimit, si dhe votat e tabelës së rezultatit të kundërshtuar, sipas pikës 2 të nenit 119 të këtij Kodi. Në rast se kërkesa për rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave të caktuara bëhet nga dy anëtarë të KQZ-së, ajo është e detyruar të bëjë rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave të kërkuara.

4. Kur objekt i ankimit janë kutitë e votimit, të konstatuara si “KUTI TË PARREGULLTA” nga KZAZ-ja, sipas nenit 115 të këtij Kodi, KQZ-ja është e detyruar të kryejë hetim administrativ gjatë shqyrtimit të ankesës për atë zonë zgjedhore, sipas nenit 124 të këtij Kodi. Hetimi nuk kufizohet vetëm në këqyrjen nga jashtë të kutisë, duke vlerësuar në tërësi faktet dhe rrethanat që kanë çuar në konstatimin e kutisë si “KUTI E PARREGULLT”, por edhe nëse këto parregullsi kanë ndikuar në materialin zgjedhor. Nëse KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjektit zgjedhor, shprehet me vendim se janë kuti të rregullta, KQZ-ja kryen numërimin fillestar të votave në këto kuti.

Votimi në qendrat e votimit, kutia/kutitë e të cilave janë konstatuar si “KUTI TË PARREGULLTA”, sipas nenit 115 të këtij Kodi dhe për të cilat nuk është bërë ankim, sipas nenit 124, konsiderohet i pavlefshëm.

5. Vendimet e KQZ-së, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, mund të ankimohen së bashku me vendimin e KQZ-së.

Neni 139
Faktet e njohura botërisht dhe ekspertimet

1. Për faktet, të cilat janë të njohura botërisht, si dhe për ato fakte, të cilat janë të ditura për KQZ-në, për shkak të funksioneve të saj, nuk nevojitet verifikim. Gjatë hetimit administrativ të çështjes, KQZ-ja konfirmon në seancë njohjen dhe marrjen parasysh të tyre në shqyrtimin e çështjes.

2. Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me shqyrtimin e kërkesave ankimore, kërkohen njohuri të posaçme në fusha të shkencës ose teknikës, KQZ-ja mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë.

Neni 140
Prapësimet mbi provat

1. Palët në shqyrtimin administrativ kanë të drejtë të paraqesin prapësimet e tyre për të kundërshtuar:

a) mënyrën e marrjes së provave të paraqitura nga palët e tjera;

b) faktet që tregojnë këto prova; ose

c) vërtetësinë dhe besueshmërinë e fakteve që tregojnë këto prova.

2. Në mbështetje të këtyre prapësimeve, palët kanë të drejtë të paraqesin edhe prova të tjera, përveç atyre të kërkuara, sipas nenit 136 të këtij Kodi.

Neni 141*
Mbyllja e hetimit administrativ

1. Kur gjatë hetimit administrativ kanë dalë fakte apo prova të reja, për të cilat ankuesi nuk mund të kishte dijeni përpara se të paraqitej ankimi, objekti i ankimit mund të shtohet apo ndryshohet përpara se KQZ-ja t'i japë fund hetimit administrativ, sipas pikës 2 të këtij neni. Kërkesa mund të përfshijë ndryshimin e tabelës së rezultatit ose pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra votimi të

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

caktuara. KQZ-ja është e detyruar të marrë në shqyrtim pretendimin e ri dhe të rihapë hetimin administrativ.

2. Pas përfundimit të hetimit administrativ, KQZ-ja pyet palët nëse kanë kërkesa ose prova të tjera në dobi të shqyrtimit të çështjes dhe në rast se ato nuk pranohen, KQZ-ja i jep fund hetimit administrativ dhe i fton palët të parashtrojnë pretendimet përfundimtare.

3. KQZ-ja vendos, rast pas rasti, nëse palët do t'i parashtrojnë pretendimet përfundimtare me shkrim ose me gojë.

Neni 142*

Tërheqja e pretendimeve ose heqja dorë prej tyre

Ankuesi ka të drejtë të heqë dorë tërësisht apo pjesërisht nga objekti i ankimit në çdo fazë të shqyrtimit të tij. Në këtë rast KQZ-ja vendos pushimin e çështjes në tërësi ose për pjesën që është hequr dorë. Pas kësaj ankuesi nuk mund të paraqesë përsëri ankimin, për të cilin është vendosur pushimi i çështjes.

Neni 143*

Lloji i vendimeve që merr KQZ-ja pas shqyrtimit të ankimeve dhe afatet

1. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit KQZ-ja vendos sipas rastit:

a) pushimin e shqyrtimit;

b) lënien në fuqi të vendimit të KZAZ-së;

c) ndryshimin e vendimit të KZAZ-së;

ç) shpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme në një ose disa qendra votimi të zonës zgjedhore ose në të gjithë njësinë zgjedhore;

d) lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve, sipas nenit 122 ose nenit 123 të këtij Kodi.

2. KQZ-ja merr vendim, sipas njërit nga rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, pavarësisht nga ajo çfarë ankuesi ka kërkuar në ankimin e tij.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

3. KQZ-ja merr vendim përfundimtar, në lidhje me ankimin ndaj vendimit për miratimin e tabelës së rezultateve të zgjedhjeve, jo më vonë se 10 ditë nga data kur është regjistruar ankimi përkatës. Në çdo rast tjetër, KQZ-ja merr vendim jo më vonë se dy ditë nga paraqitja e ankimit.

4. Në rastin e bashkimit të kërkesave ankimore, afatet llogariten nga data e regjistrimit të kërkesës së fundit ankimore.

Neni 144

Përmbajtja e vendimeve të KQZ-së

1. Vendimi i KQZ-së është gjithmonë i formës së shkruar.

2. Vendimet e KQZ-së për ankimet zgjedhore përmbajnë:

a) palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ;

b) kërkimet e secilës palë;

c) tregimin e çdo prove të marrë në shqyrtim;

ç) shpjegimin e rrethanave dhe fakteve që kanë rezultuar nga këto prova;

d) analizën ligjore të çështjes; dhe

dh) pjesën urdhëruese.

3. Vendimi i KQZ-së përmban numrin, datën, përkatësisht orën e shpalljes së tij, si dhe nënshkrimet e anëtarëve të KQZ-së, së bashku me deklarimin e votës.

4. Vendimi shoqërohet me mendimin e pakicës ose mendimin alternativ të nënshkruar nga anëtarët që e mbështesin atë.

5. Vendimi përmban edhe sqarimin për të drejtën e palëve për ta ankimuar në rrugë gjyqësore dhe afatet e ankimit.

6. KQZ-ja në asnjë rast nuk nxjerr vendime që nuk përmbajnë të gjitha elementet e përmendura në këtë nen.

PJESA XI
ANKIMI NË RRUGË GJYQËSORE I VENDIMEVE TË KQZ-SË DHE PAVLEFSHMËRIA E ZGJEDHJEVE

KREU I
ANKIMI NË RRUGË GJYQËSORE I VENDIMEVE TË KQZ-SË

Neni 145
E drejta e ankimit në gjykatë

1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.

2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Përjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi.

3. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe subjektet e përmendura në nenin 6 të këtij Kodi, të cilëve u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve. Në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve, atëherë e drejta e ankimit, sipas kësaj pike, fillon me ankimin administrativ, në përputhje me nenin 124 të këtij Kodi.

Neni 146*
Përbërja e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë

1. Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit, Tiranë përbëhet nga tetë gjyqtarë të përzgjedhur me short nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

2. Në shortin e hedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për përzgjedhjen e tetë gjyqtarëve, që përbëjnë Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë, përfshihen emrat e të gjithë gjyqtarëve të të gjitha gjykatave të apelit të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të atyre të përcaktuar në nenin 148 të këtij Kodi.

3. Shorti për përzgjedhjen e tetë gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë hidhet jo më vonë se 5 ditë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve për Kuvendin. Jo më vonë se 48 orë pas daljes së dekretit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë shpall publikisht dhe boton në të paktën tri gazeta me tirazhin më të madh datën, orën dhe vendin ku do të hidhet shorti dhe u dërgon partive parlamentare listën e gjyqtarëve që do të përfshihen në short. Shorti hidhet në praninë e publikut, përfaqësuesve të partive politike, koalicioneve dhe të medias. Shorti zhvillohet duke tërhequr emrat e tetë gjyqtarëve nga kutia e shortit. Para fillimit të tij, të pranishmëve u jepet mundësia të këqyrin kutinë e shortit dhe emrat e gjyqtarëve të futur në të. Pas këqyrjes, nxirren tetë emra nga kutia. Ata përbëjnë Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë dhe delegohen në detyrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë menjëherë pas hedhjes së shortit.

4. Brenda 24 orëve nga përzgjedhja e tyre me short, të tetë gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë bëjnë betimin në një ceremoni publike, në prani të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nën drejtimin e Presidentit të Republikës. Betimi ka përmbajtjen që vijon: “**Betohem solemnisht se do të respektoj, do të mbroj dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë, se do të respektoj të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe do të përmbush detyrat e mia. Betohem se do të kryej detyrën time me të gjitha mundësitë e mia dhe në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe pa favorizuar ndonjë person ose parti**”.

5. Gjykata e Apelit, Tiranë vë në dispozicion të Kolegjit Zgjedhor mjedise të mjaftueshme pune, pajisje dhe personel, në mënyrë që të sigurojë kryerjen në kohë dhe në mënyrë profesionale të detyrave të veta.

Neni 147

Kohëzgjatja dhe mbledhjet e Kolegjit Zgjedhor

1. Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit, Tiranë i ushtron funksionet e veta gjatë gjithë kohëzgjatjes së legjislaturës së Kuvendit të dalë nga zgjedhjet, për të cilat është hedhur shorti dhe funksionon për të gjitha llojet e zgjedhjeve.

2. Konstituimi i kolegjit bëhet menjëherë pas betimit dhe thirret në detyrë nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë jo më vonë se 45 ditë përpara zgjedhjeve. Kolegji qëndron i mbledhur deri në përfundim të gjykimit të ankimeve ose të kalimit të afateve të ankimit, lidhur me procesin zgjedhor të radhës.

3. Kolegji rithirret në detyrë nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë jo më vonë se 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme dhe për referendumet. Kolegji qëndron i mbledhur deri në përfundim të gjykimit të ankimeve ose të kalimit të afateve të ankimit për këto zgjedhje.

4. Me kërkesë të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, kolegji rithirret në detyrë sa herë që pranë kësaj gjykate depozitohen ankime ndaj vendimeve të KQZ-së, jashtë afateve të përmendura në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 148*

Kriteret për mospërfshirjen e gjyqtarëve në short

1. Nuk përfshihen në shortin e hedhur, sipas nenit 146 të këtij Kodi, gjyqtarët, ndaj të cilëve:

a) është vendosur fillimi i çështjes penale;

b) është në fuqi një masë disiplinore;

c) është filluar procedim disiplinor.

2. Përveç rasteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, nuk përfshihen në shortin e hedhur gjyqtarët në detyrë të Kolegjit Zgjedhor.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Neni 149
Mbrojtja e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor

Gjyqtari i Kolegjit Zgjedhor nuk mund t'i nënshtrohet procedimit disiplinor gjatë gjithë periudhës për të cilën është krijuar kolegji.

Gjatë kësaj kohe, gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë nuk mund të lëvizen nga detyra e gjyqtarit, për shkaqe që lidhen me nenit 32 të ligjit nr. 9877 datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", si dhe për pamjaftueshmëri profesionale. Ndaj tyre nuk mund të jepet vlerësimi "i paaftë".

Neni 150
Pavlefshmëria e delegimit

1. Delegimi i gjyqtarëve në Kolegjin Zgjedhor është i pavlefshëm në rast se pjesëmarrja e tyre në short është bërë në kundërshtim me kushtet e parashikuara në nenin 146 të këtij Kodi.

2. Pavlefshmëria e delegimit është shkak për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i mosmarrëveshjeve zgjedhore.

Neni 151*
Përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi i çështjes

1. Palët në gjykimin përpara Kolegjit Zgjedhor kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin nga gjykimi i çështjes të ndonjërit prej gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor.

2. Përjashtimi bëhet nëse rezulton se gjyqtari ka ndonjë interes për çështjen, ka qenë më parë punëdhënës, punëmarrës, këshilltar, përfaqësues ose avokat i ndonjërës prej palëve, ka lidhje gjinie ose marrëdhënie krushqie të afërt me ndonjë nga palët, ose rezulton se ai nuk mund ta kryejë detyrën në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe pa favorizuar asnjë prej palëve.

3. Përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi i çështjes bëhet nga Kolegji Zgjedhor. Të gjithë gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor vendosin së bashku për vlefshmërinë e kundërshtimit ndaj ndonjërit prej gjyqtarëve.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

4. Kërkesën për përjashtim paditësi apo pala e interesuar duhet ta depozitojë në sekretarinë e gjykatës pasi është bërë i ditur emri i gjyqtarëve që shqyrtojnë çështjen.

5. Kërkesa për përjashtim përmban arsyen specifike pse nuk është e përshtatshme që një gjyqtar i caktuar i Kolegjit Zgjedhor të gjykojë kërkesëpadinë.

6. Kërkesat për përjashtim të gjyqtarit, të paraqitura jashtë afateve dhe procedurave të këtij neni, nuk merren në shqyrtim.

Neni 152

Afati i ankimit në gjykatë

1. Ankimet, sipas këtij Kodi, paraqiten në Gjykatën e Apelit, Tiranë, e cila ia kalon ato Kolegjit Zgjedhor.

2. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë.

Neni 153

Forma dhe përmbajtja e ankimit

1. Ankimi paraqitet në formën e kërkesëpadisë dhe duhet të përmbajë:

a) të dhënat për identitetin e paditësit;

b) tregimin e palës së paditur;

c) tregimin e palëve të interesuara. Palë të interesuara janë palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ pranë KQZ-së;

ç) objektin e kërkimit;

d) bazën ligjore;

dh) përshkrimin e shkeljes së pretenduar dhe pikat e vendimit të KQZ-së, të cilat ankuesi kundërshton; dhe

e) faktet, argumentet dhe dispozitat ligjore ku mbështetet ankimi.

2. Kërkesëpadia depozitohet në aq kopje sa është numri i palëve në proces, si dhe shoqërohet me kopjen e vendimit të KQZ-së

dhe, sipas rastit, me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit.

3. Kërkesëpadia regjistrohet me paraqitjen e saj.

Neni 154

Veprimet paraprake lidhur me kërkesëpadinë

1. Pas regjistrimit të kërkesëpadisë, Kryetari i Gjykatës së Apelit, Tiranë i kalon Kolegjit Zgjedhor çështjen për shqyrtim.

2. Kolegji Zgjedhor njihet me kërkesëpadinë jo më vonë se 24 orë nga dërgimi i saj, sipas pikës 1 të këtij neni dhe:

a) merr vendim për kërkesën e paditësit për përjashtimin e gjyqtarit;

b) hedh shortin për përbërjen e trupit gjykues dhe relatorin e çështjes; dhe

c) cakton datën dhe orën e fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

3. Relatori, menjëherë pas caktimit, kryen veprimet paraprake të mëposhtme:

a) njofton palët për datën dhe orën e gjykimit të çështjes dhe përbërjen e trupit gjykues;

b) sipas rastit, i kërkon paditësit plotësimin e kërkesëpadisë, jo më vonë se 24 orë para datës së caktuar për shqyrtim gjyqësor;

c) u dërgon palëve të interesuara kopje të kërkesëpadisë dhe i informon ato për të drejtën ligjore për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit të trupit gjykues, sipas nenit 151 të këtij Kodi. Palët e interesuara, kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit duhet ta paraqesin brenda 48 orëve nga marrja e njoftimit, sipas shkronjës “a” të kësaj pike. Kërkesat, sipas kësaj shkronje, shqyrtohen nga Kolegji Zgjedhor brenda 24 orëve nga depozitimi i kërkesës;

ç) në rast se KQZ-ja nuk ka lëshuar vendimin, sipas nenit 144 të këtij Kodi, i kërkon asaj të depozitojë vendimin në gjykatë jo më vonë se 24 orë para datës së caktuar për shqyrtimin gjyqësor.

Neni 155

Procedura e shqyrtimit të kërkesëpadisë

1. Në shqyrtimin gjyqësor të kërkesëpadive për të gjitha veprimet procedurale që nuk rregullohen nga ky Kod, Kolegji

Zgjedhor zbaton dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për gjykimin e çështjeve në shkallën e parë.

2. Kolegji Zgjedhor gjykon me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Relatori i çështjes kryeson trupin gjykues.

Neni 156*

Të drejtat e palëve në proces

1. Palët në procesin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadisë kanë të gjitha të drejtat procedurale, që parashikohen në Kodin e Procedurës Civile, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.

2. KQZ-ja sjell në gjykim të gjitha provat e administruara prej saj gjatë shqyrtimit administrativ, pavarësisht nga kërkesat e palëve për to, si dhe çdo provë tjetër që Kolegji Zgjedhor kërkon.

3. Kur gjatë hetimit gjyqësor kanë dalë fakte apo prova të reja, për të cilat paditësi nuk mund të kishte dijeni përpara se të paraqitej kërkesëpadia, me kërkesë të paditësit objekti i padisë mund të shtohet apo ndryshohet përpara se Kolegji Zgjedhor t'i japë fund hetimit gjyqësor. Kërkesa mund të përfshijë ndryshimin e tabelës së rezultatit ose pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendër/qendra votimi.

4. Mungesa e njërës palë gjatë procesit nuk përbën pengesë për vazhdimin e gjykimit nga ana e Kolegjit Zgjedhor, përveç rastit kur kolegji vendos ndryshe.

Neni 157

Afati i gjykimit në Kolegjin Zgjedhor

1. Kolegji Zgjedhor gjykon dhe vendos për kërkesëpaditë brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesëpadisë.

2. Në rastet e parashikuara nga fjalia e fundit e pikës 2 të nenit 152 të këtij Kodi, Kolegji Zgjedhor vendos brenda 30 ditëve nga depozitimi i ankimit.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Neni 158
Llojet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor

1. Në varësi nga çështjet në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos:
a) pushimin e gjykimit;
b) gjykimin e çështjes në themel; ose
c) detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim.
2. Pushimi i gjykimit vendoset kur Kolegji Zgjedhor konstaton se ankimi është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara në këtë Kod ose për mungesë kompetence. Kur Kolegji Zgjedhor vendos mungesën e kompetencës, ia dërgon çështjen organit kompetent.
3. Me gjykimin e çështjes në themel, Kolegji Zgjedhor vendos pranimin e plotë apo të pjesshëm të padisë ose rrëzimin e plotë apo të pjesshëm të saj.
4. Kolegji Zgjedhor vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim, në zbatim të pikës 2 të nenit 145 të këtij Kodi. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor cakton afat të prerë për marrjen e vendimit jo më të gjatë se 10 ditë.
5. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor është i formës së prerë. Ndaj tij nuk bëhet ankim.
6. Kolegji Zgjedhor është i detyruar të zbardhë vendimin jo më vonë se tre ditë nga data e dhënies së tij.

Neni 159
Përmbajtja e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor

1. Vendimet e Kolegjit Zgjedhor përmbajnë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese.
2. Në hyrjen e vendimit përmenden:
a) gjykata, trupi gjykues dhe sekretari;
b) koha dhe vendi i dhënies së vendimit;
c) palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre si paditës, i paditur, palë e interesuar, si dhe përfaqësuesit e tyre;
ç) objekti i padisë; dhe
d) kërkimet përfundimtare të palëve.
3. Në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit përmenden:
a) rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata;

b) provat dhe arsyet, në të cilat mbështetet vendimi; dhe

c) dispozitat ligjore, në të cilat bazohet vendimi.

4. Në pjesën urdhëruese të vendimit, ndër të tjera, duhet të përmenden:

a) çfarë vendosi gjykata; dhe

b) sipas rastit, kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore.

5. Vendimi shoqërohet me mendimin e pakicës ose mendimin alternativ të nënshkruar nga gjyqtarët që e mbështesin atë.

KREU II
PAVLEFSHMËRIA DHE PËRSËRITJA E ZGJEDHJEVE

Neni 160*
Pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit

1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:

a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;

b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose

c) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.

2. Subjektet zgjedhore, në përputhje me rregullat dhe afatin e përcaktuar në nenin 124 të këtij Kodi, kanë të drejtë të kërkojnë në KQZ shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi.

3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore, përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre.

4. Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të përcaktuara në pjesën X të këtij Kodi. KQZ-ja, në marrjen e vendimit

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, mund konsultohet me KZAZ-në përkatëse. Në arsyetimin e vendimit të KQZ-së duhet të përshkruhet shkaku ligjor, rastet e vërtetuara të shkeljeve dhe arsyetimi i detajuar për pasojën e tyre.

Neni 161*

Përsëritja e zgjedhjeve

1. Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore, KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit, shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.

2. Do të konsiderohet ndikim në ndarjen e mandateve për zgjedhjet në Kuvend kur numri i zgjedhëse, që kanë votuar apo mund të kishin votuar në qendrën apo qendrat e votimit të shpallura të pavlefshme, është i barabartë ose më i madh se numri i zgjedhësve të nevojshëm për caktimin e një mandati në zonën zgjedhore përkatëse, mbi bazën e përllogaritjes së votave të vlefshme në zonën zgjedhore, të bërë sipas nenit 162 të këtij Kodi. Për zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore ndikim në rezultat do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.

3. Në rast pavlefshmërie për shkak të fatkeqësisë natyrore, sipas shkronjës “b”, apo të mosfillimit të votimit ose pezullimit më shumë se pesë orë të tij, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 160, merret në konsideratë numri total i zgjedhësve të regjistruar në qendrën e votimit të shpallur të pavlefshme.

4. Në rast pavlefshmërie për shkelje të ligjit, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 160, apo kur votimi është shpallur i pavlefshëm, sipas paragrafit të dytë të pikës 4 të nenit 138 të këtij Kodi dhe kur procesi i votimit ka përfunduar, sipas këtij Kodi, për përcaktimin e ndikimit merret në konsideratë numri i zgjedhësve që kanë votuar në qendrën e votimit të shpallur të pavlefshme.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

5. Përsëritja e zgjedhjeve urdhërohet në të njëjtin vendim të KQZ-së, që i shpall ato të pavlefshme. Zgjedhjet për kështillat e qeverisjes vendore nuk përsëriten.

6. Zgjedhjet e shpallura të pavlefshme dhe për të cilat KQZ-ja ka vendosur përsëritjen, sipas këtij neni, përsëriten në një ditë të vetme për të gjitha zonat zgjedhore ku është vendosur përsëritja e tyre. Vendimi për caktimin e datës për përsëritjen e zgjedhjeve merret nga KQZ-ja me përfundimin e procedurave ankimore, sipas kësaj pjese ose me kalimin e afateve ligjore të ankimit, të përcaktuara në këtë pjesë. Përsëritja e zgjedhjeve zhvillohet jo më vonë se 4 javë nga data e vendimit.

7. Ankimi ndaj vendimit të KQZ-së për shpalljen ose jo të zgjedhjeve të pavlefshme bëhet në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në këtë pjesë.

PJESA XII
NDARJA E MANDATEVE

KREU I
MANDATET PËR KUVENDIN

Neni 162
Përllogaritja e mandateve të subjekteve zgjedhore

1. Jo më vonë se 3 ditë nga përfundimi i procesit të ankimit kundër vendimit për miratimin e rezultateve të zonës zgjedhore apo pavlefshmërisë së zgjedhjeve, sipas këtij Kodi, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë në nivel zone zgjedhore. Për zgjedhjet për Kuvendin, përjashtohen nga shpërndarja e mandateve partitë politike që konkurrojnë më vete dhe që kanë marrë më pak se 3 për qind dhe koalicionet që kanë marrë më pak se 5 për qind të votave të vlefshme në zonën zgjedhore përkatëse.

2. Numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1

dhe duke përfunduar me numrin natyror që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse. Hapi nga njëri pjesëtues tek tjetri është 1. Në rast se herësi që përftohet nga pjesëtimi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt.

3. Kur subjekti zgjedhor është kandidat i propozuar nga zgjedhësit, votat e tij pjesëtohen vetëm me pjesëtuesin 1.

4. Herësit e përftuar nga çdo pjesëtim, përfshirë edhe rezultatin e pikës 3 të këtij neni, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Në rast se herësi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse.

5. Një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar në pikën 4 të këtij neni. Në rast se për vendin e fundit në listën e përcaktuar në pikën 4 të këtij neni rezultojnë dy apo më shumë subjekte me të njëjtin herës, mandati i jepet atij subjekti që ka numrin me të madh të votave dhe nëse ato kanë numër të barabartë votash, atëherë përcaktohet me short midis atyre subjekteve. Shorti hidhet publikisht në KQZ, në prani të subjekteve të interesuara.

Neni 163

Ndarja e mandateve brenda koalicionit

1. Menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit, sipas nenit 162 të këtij Kodi, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve brenda koalicionit në çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që secila parti pjesëtare e koalicionit ka marrë në zonën zgjedhore përkatëse dhe numrit të mandateve që koalicioni ka fituar në zonën zgjedhore përkatëse.

2. Numri i votave të vlefshme të secilës parti pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë tek të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror që i korrespondon dyfishit të numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse. Në rast se herësi

që përftohet nga pjesëtimi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt.

3. Herësit e përftuar nga çdo pjesëtim renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Në rast se herësi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen brenda koalicionit në zonën zgjedhore përkatëse.

4. Një parti politike përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni. Në rast se për vendin e fundit në listën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni rezultojnë dy apo më shumë subjekte me të njëjtin herës, mandati i jepet atij subjekti që ka fituar numrin më të madh të votave dhe nëse ato kanë numër të barabartë votash, atëherë përcaktohet me short midis atyre partive. Shorti hidhet publikisht në KQZ, në prani të subjekteve të interesuara.

5. Menjëherë pas përfundimit të procedurave për ndarjen e mandateve për çdo parti politike, sipas këtij neni, KQZ-ja përcakton mandatet nominale për çdo parti politike, në bazë të renditjes së kandidatëve në listë, të depozituar sipas pikës 4 të nenit 67 të këtij Kodi, në rend zbritës, duke filluar nga numri rendor një.

6. Kryetari i partisë, i regjistruar në më shumë sesa një listë, sipas pikës 3 të nenit 67 të këtij Kodi, i cili ka fituar mandat në më shumë se një zonë zgjedhore, mban vetëm mandatin e fituar në zonën zgjedhore ku lista fituese ka marrë numrin më të vogël të votave, sipas përllogaritjes së neneve 162 dhe 163 të këtij Kodi. Mandatet e tjera të fituara nga kryetari i partisë u shpërndahen kandidatëve të tjerë, që renditen menjëherë pas tij në listën shumemërore përkatëse.

7. Shpërndarja e mandateve, sipas nenit 162 dhe këtij neni për çdo zonë zgjedhore miratohet me vendim. Vendimi nxirret për çdo zonë zgjedhore më vete. Vendimi mund të ankimohet në Kolegjin Zgjedhor, sipas procedurave të pjesës XI të këtij Kodi, nga subjektet e parashikuara në pikën 1 të nenit 124, përfshirë edhe kandidatët e listës shumemërore.

Neni 164*

Ndërprerja e mandatit dhe zëvendësimi i vakancës

1. Mandati i deputetit, i fituar sipas neneve 162 dhe 163 të këtij Kodi, ndërpritet vetëm për shkaqet e parashikuara në nenin 71 të Kushtetutës. Nuk përbëjnë shkak për ndërprerje të mandatit marrëveshjet apo deklaratat paraprake individuale apo kolektive për heqje dorë nga mandati. Në rastin e shkronjave "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 71 të Kushtetutës, deputeti deklaron në mënyrë publike përpara komisionit përkatës të Kuvendit refuzimin për të bërë betimin ose heqjen dorë nga mandati. Në këtë rast Kuvendi, jo më vonë se 30 ditë, njofton KQZ-në për krijimin e vakancës.

2. Mandati i ndërprerë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse. Në përjashtim nga ky rregull, kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Ky rregull nuk aplikohet kur emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar.

3. KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën e kandidatëve të regjistruar sipas nenit 67 të këtij Kodi. Vendimi i njoftohet kandidatit dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Nëse kandidati i radhës nuk paraqitet në Kuvend brenda 30 ditëve nga njoftimi, pa shkaqe të përligjura, mandati i kalon kandidatit vijues të listës, sipas procedurës së parashikuar në pikën 1 ose 2 të këtij neni. E njëjta procedurë vazhdon deri në shterimin e listës së kandidatëve të së njëjtës parti politike.

4. Në rast kur është shteruar lista e kandidatëve të partisë politike, anëtare e një koalicioni, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë. Kur mandati i ndërprerë i përket një kandidati të propozuar nga zgjedhësit, mandati i kalon subjektit zgjedhor me herësin më të lartë. Kur mandati i takon një koalicioni zgjedhor, ai i shpërndahet partisë pjesëtare të koalicionit me herësin më të lartë.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

KREU II
SISTEMI I ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Neni 165
Sistemi i zgjedhjeve vendore

1. Kryetarët e bashkive ose të komunave, si dhe këshillat e bashkive ose komunave zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë ose të komunës.

2. Anëtarët e këshillave të bashkisë dhe të komunave zgjidhen në bazë të listave shumemërore të paraqitura nga partitë politike, koalicionet, ose të kandidaturave të propozuara nga zgjedhësit.

3. Partitë politike të regjistruara si koalicion në KQZ paraqesin vetëm një kandidat të përbashkët për kryetar bashkie ose komune.

Neni 166
Zgjedhja e organeve të qeverisjes vendore

1. Kryetar bashkie ose komune zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

2. Në rastin kur dy ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash, atëherë ndërmjet tyre hidhet short. Shorti organizohet nga KQZ-ja në një seancë publike, me pjesëmarrjen edhe të kandidatëve. KQZ-ja përcakton rregullat e organizimit të shortit.

3. Mandatet e këshillave vendorë ndahen nga KQZ-ja në bazë të sistemit proporcional, sipas të njëjtave procedurave të parashikuara në nenet 162 dhe 163 të këtij Kodi.

KREU III
SHPALLJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE

Neni 167
Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve

Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve shpallet nga KQZ-ja jo më vonë se 5 ditë nga data e shpalljes së rezultatit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas pikës 7 të nenit 163 të këtij Kodi dhe pasi të kenë përfunduar procedurat e ankimit, sipas këtij Kodi.

PJESA XIII
PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET

Neni 168
Përgjegjësia e personave të ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve

Anëtarët e komisioneve zgjedhore dhe nëpunësit e administratës publike në shërbim të këtyre komisioneve mbajnë përgjegjësi penale dhe administrative, sipas legjislacionit në fuqi për shkeljen e dispozitave të këtij Kodi.

Neni 169*
Mosbashkëpunimi me KQZ-në

Refuzimi për të bashkëpunuar me KQZ-në ose për të dhënë informacione që parashikohen nga ky Kod KQZ-së, nga ana e zyrtarëve të organeve të qeverisjes vendore ose qendrore, ndëshkohet me gjobë nga 10 mijë deri në 50 mijë lekë.

Neni 170
(Shfuqizuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19 korrik 2012)

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

Neni 171
Sanksionet administrative

1. Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3,000 deri në 90,000 lekë.

2. Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë.

3. Shkelja e rregullave të përcaktuara në nenet 34 dhe 41 të këtij Kodi, përkatësisht nga sekretari i KZAZ-së ose KQV-së, dënohet me gjobë nga 30,000 deri në 60,000 lekë ose me burgim deri në 6 muaj.

4. Personat e ngarkuar nga ky ligj, me përgatitjen dhe miratimin e listave të zgjedhësve, kur përfshijnë në këto lista të dhëna të rreme ose kur lënë pa përfshirë zgjedhës, përgjigjen penalisht në bazë të nenit 186 të Kodit Penal.

5. Shkelja e rregullave të tjera dhe afateve të parashikuara në pjesën II të këtij Kodi, kur nuk përbën shpërdorim të detyrës, sipas nenit 248 të Kodit Penal, dënohet me gjobë nga 10,000 deri në 100,000 lekë. Gjoba vendoset nga titullari i institucionit, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra përkatëse e financës.

Neni 172
Sanksionet për shkelje të parimeve të Kodit

1. Shkelja e ndonjërit nga parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4 ose 5 të këtij Kodi, në rastet kur kjo shkelje nuk ka ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100,000 deri në 500,000 lekë.

2. Masa e gjobës përcaktohet në varësi nga rrethanat e mëposhtme:

a) rreziku që formon shkelja për zhvillimin dhe administrimin e zgjedhjeve në të ardhmen;

b) fakti nëse autori i shkeljes ka përfituar nga shkelja materialisht ose nëpërmjet shkeljes ka ndikuar në marrjen e mandatit nga kandidati, partia politike apo koalicioni;

c) kohëzgjatja dhe rrethi i veprimeve që kanë çuar në kryerjen e shkeljes;

ç) fakti nëse ka pasur përpjekje për fshehjen e shkeljes dhe në ç'shkallë kanë qenë ato;

d) qëndrimi i autorit të shkeljes pas zbulimit të saj;

dh) fakti nëse në kryerjen e shkeljes kanë marrë pjesë persona zyrtarë ose janë shfrytëzuar burime publike;

e) fakti nëse shkelja është përsëritur;

ë) fakti nëse është kryer në bashkëpunim;

f) rreziku potencial ndaj zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente.

3. Gjobat, sipas pikës 1 të këtij neni, vihen nga KQZ-ja.

4. Shkeljet, sipas pikës 1 të këtij neni, kur kanë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 2 vjet.

Neni 173

Sanksionet në lidhje me financimin e fushatës

1. Shkelja e dispozitave për financimin e fushatës zgjedhore nga ana e përgjegjësit të financës të partisë politike ndëshkohet me gjobë nga 50,000 deri në 100,000 lekë.

2. Mosbashkëpunimi me auditin e KQZ-së nga ana e subjektit zgjedhor dënohet me gjobë nga 1,000,000 deri në 2,000,000 lekë.

3. Refuzimi për të bërë transparent burimet e financimit të fushatës, apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e auditit, dënohet me gjobë nga 2,000,000 lekë deri në pezullimin për 5 vjet të financimit publik për partinë politike.

4. Shkeljet në lidhje me nenin 90 të këtij Kodi nga ana e dhuruesit dënohen me gjobë, me vlerë të barabartë me 30 për qind të shumës së dhuruar.

5. Shkelja e kufirit maksimal të shpenzimeve nga subjekti zgjedhor ndëshkohet me një gjobë të barabartë me vlerën 10 për qind të vlerës mbi kufirin e lejuar të shpenzimit, sipas nenit 90 të këtij Kodi.

Neni 174
Thyerja e heshtjes zgjedhore

1. Subjekti zgjedhor që thyen heshtjen zgjedhore, sipas nenit 77 të këtij Kodi, gjobitet nga KZQ-ja me 500,000 lekë.

2. Botuesi ose operatori radioteleviziv që thyen heshtjen zgjedhore, sipas nenit 77 të këtij Kodi, gjobitet nga KQZ-ja me 2,000,000 lekë.

3. Ankimi ndaj vendimit të KQZ-së për gjobën nuk pezullon ekzekutimin e saj.

Neni 175*
Sanksionet në lidhje me barazinë gjinore

1. Mospërmbushja nga ana e subjektit zgjedhor e detyrimeve të parashikuara në pikën 6 të nenit 67 të këtij Kodi, në lidhje me përbërjen e listës, dënohet nga KQZ-ja me gjobë 1,000,000 lekë në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin dhe 50,000 lekë në rastin e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor, si dhe sanksionin plotësues, sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Kur ndaj një subjekti zgjedhor është konstatuar shkelja, KQZ-ja zbaton si sanksion plotësues zëvendësimin e çdo vakance në listën e subjektit, në zonën ku është konstatuar shkelja, me kandidatët vijues në listë nga gjinia më pak e përfaqësuar deri në plotësimin e kuotës gjinore. Në rast se KQZ-ja vendos aplikimin e këtij sanksioni, përjashtimi i pikës 2 të nenit 164 nuk zbatohet dhe vakanca plotësohet sipas kësaj pike.

3. Sanksionet e përcaktuara në këtë nen vendosen për çdo zonë zgjedhore ku konstatohet shkelja.

Neni 176
Ekzekutimi i sanksioneve administrative

Gjoba e vendosur nga KQZ-ja, sipas kësaj pjese, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas procedurave të parashikuara në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

PJESA XIV

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 177
Lista e zgjedhësve për Bashkinë e Tiranës

Për Bashkinë e Tiranës, detyrimet e parashikuara në Pjesën III të këtij Kodi kryhen nga kryetarët e njësive bashkiake të Tiranës, në afatet e përcaktuara në këtë Kod.

Neni 178*
Ruajtja e dokumentacionit

1. Asnjë procesverbal i KQV-së, KZAZ-së ose i një komisioni tjetër zgjedhor nuk mund të asgjësohet pa miratimin paraprak të KQZ-së.

2. Të gjitha procesverbalet e KQV-së ose të çdo komisioni tjetër të ngritur nga KZAZ-ja i jepen KZAZ-së në mënyrën dhe kohën e caktuar nga KQZ-ja.

3. KZAZ-ja mban nga një kopje:

a) të dokumentacionit të kandidatëve dhe partive politike që marrin pjesë në zgjedhje;

b) të listës së emrave dhe adresave të të gjithë anëtarëve të KQV-së dhe komisioneve të tjera;

c) të listës së qendrave të votimit;

ç) të listave të zgjedhësve për zonën zgjedhore;

d) të emrave dhe adresave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së;

dh) të hartës së zonës zgjedhore me kufijtë e zonave të qendrave të votimit;

e) të përshkrimit me shkrim të kufijve të të gjitha zonave të administrimit zgjedhor;

ë) të dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve, të njoftimeve zyrtare për zgjedhjet të KZAZ-së, të shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve për çdo qendër votimi dhe të shpalljes përfundimtare të rezultateve;

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

f) të deklaratës së shpenzimeve të bëra për administrimin e zgjedhjeve.

4. Dokumentet origjinale, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, i dërgohen KQZ-së brenda 3 muajve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve. KQZ-ja mban një kopje dhe ia dërgon dokumentet origjinale Arkivit Qendror të Shtetit, në mënyrën e kërkuar prej tij dhe brenda 24 muajve pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

5. Menjëherë pas shpalljes së rezultateve nga KZAZ-ja, komisioni i dërgon KQZ-së, në mënyrën e caktuar prej saj, të gjitha kutitë e vulosura të votimit me procesverbalet e votimit, vulën e komisionit, fletët e votimit të përdorura në zgjedhje, si edhe fletët e votimit të papërdorura.

6. Gjashtë muaj pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, sipas këtij Kodi, KQZ-ja hap të gjitha kutitë e votimit, nxjerr procesverbalet e votimit, tabelat dhe procesverbalin e numrit të fletëve të votimit, dokumentacionin që ndodhet në kutitë e materialeve të votimit dhe ia dërgon ato Arkivit Qendror të Shtetit në mënyrën e caktuar prej tij. Të gjitha fletët e votimit asgjësohen sipas mënyrës së përcaktuar nga KQZ-ja.

Neni 179*

Plani i Veprimit për përdorimin e teknologjive të informacionit në zgjedhje

1. Për futjen dhe zbatimin e teknologjisë së re informative në procesin zgjedhor, KQZ-ja miraton një Plan Veprimi. Vendimi miratohet me votën “pro” të jo më pak se 5 anëtarëve të KQZ-së.

2. Miratimi ose jo i Planit të Veprimit për zbatimin e teknologjisë në të gjithë vendin nuk cenon zbatimin pjesor të SEN-it dhe SEV-it, sipas nenit 179/1 të këtij Kodi.

3. Plani i Veprimit duhet të parashikojë dhe të garantojë të paktën:

a) kryerjen e një studimi zbatueshmërie për sistemet elektronike të numërimit dhe identifikimit në përdorim. Ky studim do të identifikojë përfitimet dhe rreziqet e përfshira në zbatimin

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

e sistemeve të tilla dhe në mënyrë të veçantë aspektet ligjore, operacionale dhe financiare;

b) kryerjen e prokurimit transparent, testimit dhe certifikimit, trajnimit, edukimit të zgjedhësve dhe zbatimit. Ai duhet të parashikojë specifikimin e një date për nxjerrjen e aktit normativ të KQZ-së për hollësitë operacionale të sistemit elektronik të numërimit;

c) qasje graduale në rritje për futjen e teknologjive të reja të informacionit, duke filluar me një pilotim të kufizuar, si rregull në 20 për qind të zgjedhësve. Çdo rritje pasuese në përdorimin e tij duhet të jetë në varësi të trajtimit të rekomandimeve të dala nga vlerësimet dhe të konsultimeve publike;

ç) kërkesat për certifikim, në përputhje me legjislacionin vendas dhe praktikat e mira ndërkombëtare. Kërkesat për certifikim duhet të jenë të disponueshme për publikun në kohë të mjaftueshme dhe duhet të përbëjnë një pjesë të rëndësishme të procesit të prokurimit;

d) testimi i sistemit përpara përdorimit të jetë i detyrueshëm;

dh) udhëzime të qarta mbi mënyrën se si KQZ-ja do të vazhdojë me zhvillimin e sistemeve elektronike të numërimit dhe identifikimit, në rast se auditimi do të evidentojë mangësi serioze;

e) parashikimin e personave përgjegjës për vënien në funksionim të sistemeve elektronike të numërimit dhe identifikimit, të cilët duhet të trajnohen specifikisht dhe në kohë për detyrat e tyre;

ë) mbrojtjen e të dhënave personale, duke sanksionuar se:

i) personeli në qendrën e votimit t'i bëjë të ditur çdo zgjedhësi, para mbledhjes apo transferimit të të dhënave nga dokumenti i identifikimit vetjak, identitetin e kontrolluesit, kategoritë e të dhënave që mblidhen dhe transferohen, qëllimet e transferimit të të dhënave, përpunuesin e të dhënave (që mund të përfshijë specifikimet teknike të sistemit), dhe marrësin e të dhënave;

ii) marrjen e pëlqimit të zgjedhësit për të skanuar dokumentin e identifikimit vetjak.

Neni 179/1*

Masat për realizimin e teknologjisë së re informative në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013

1. Jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, KQZ-ja fillon përgatitjen e projektit për ngritjen e sistemit të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV) dhe sistemit elektronik të numërimit (SEN). Në përgatitjen e projektit të SEV-it përfshihen edhe përfaqësues të Ministrisë së Brendshme.

2. Këshilli i Ministrave jep mbështetjen e nevojshme, përfshirë edhe atë financiare, për shërbimin e konsulencës që nevojitet për hartimin e kushteve të projektit për SEV-in dhe SEN-in.

3. KQZ-ja përcakton planin për përmbushjen e projektit të SEN-it në të gjithë qarkun e Fierit për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013.

4. KQZ-ja përcakton planin për përmbushjen e projektit të SEV-it në të gjithë qarkun e Tiranës për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013.

5. Me qëllim zbatimin e sistemit SEV, qendrat e votimit nuk mund të kenë më shumë se 700 zgjedhës. Kur në një zonë të qendrës së votimit ka më shumë se 700 zgjedhës, zbatohen të njëjtat kritere për ndarjen e tyre, sipas pikës 6 të nenit 62 të këtij Kodi.

6. Procedurat për blerjen e shërbimit dhe/ose pajisjeve të SEN-it dhe SEV-it kryhen me operatorë të mirënjohur që ofrojnë teknologji të provuara me sukses në fushat respektive. Procedurat e prokurimit, si rregull, duhet të përfundojnë jo më vonë se 6 muaj përpara zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2013.

7. KQZ-ja informon në mënyrë periodike Kuvendin në lidhje me ecurinë e përgatitjes dhe zbatimit të projekteve të përcaktuara në këtë nen.

Neni 180

Ndarja e zonave të administrimit zgjedhor

Për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2009, zonat e administrimit zgjedhor përcaktohen në Aneksin I të këtij Kodi. Zonat e administrimit

---

* Shtuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

zgjedhor, sipas Aneksit I do të mbeten në fuqi pas zgjedhjeve të vitit 2009, deri në rishikimin e tyre nga KQZ-ja, në përputhje me nenin 27 të këtij Kodi. Pavarësisht nga ky rregull, KQZ-ja mund të marrë vendim, në përputhje me pikën 4 të nenit 27, për bashkitë që kanë mbi 100 mijë zgjedhës.

Neni 181*

Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së

1. Kuvendi, 30 ditë nga data e shpalljes së këtij ligji, zgjedh anëtarët e KQZ-së, sipas neneve 14 dhe 15 të këtij Kodi.

2. Publikimi i vakancës për Kryetarin e KQZ-së bëhet menjëherë pas shpalljes së këtij ligji.

3. Betimi kryhet jo më vonë se 24 orë nga dita e zgjedhjes së Kryetarit të KQZ-së.

Neni 182*

Ndërprerja e mandatit të anëtarëve ekzistues të KQZ-së

1. Anëtarët e KQZ-së, të cilëve u ndërpritet mandati para kohe për shkak të ndryshimeve në këtë Kod, qëndrojnë në detyrë deri në zëvendësimin e tyre me anëtarët e rinj të zgjedhur sipas këtij Kodi.

2. Anëtarit të KQZ-së, të cilit i ndërpritet mandati për shkak të nenit 181, përfiton pagën e funksionit deri më 31 dhjetor 2012.

3. Anëtari i KQZ-së, të cilit i ndërpritet mandati, kthehet në funksionin publik të mëparshëm, ose emërohet në një funksion ekuivalent me të.

Neni 183*

Përtëritja pjesore e anëtarëve të KQZ-së

1. Me qëllim përtëritjen pjesore të KQZ-së, dy nga anëtarët e zgjedhur sipas pikës 1 të nenit 14 dhe nenit 181 të këtij Kodi e ushtrojnë mandatin e parë për 3 vjet me të drejtë rizgjedhjeje. Një anëtar, të cilit i ndërpritet mandati para kohe, përcaktohet me

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

short mes tre anëtarëve të propozuar nga shumica parlamentare dhe anëtari tjetër, mes tre anëtarëve të propozuar nga opozita parlamentare, sipas pikës 1 të nenit 14 të këtij Kodi.

2. KQZ-ja zhvillon hedhjen e shortit në seancë publike jo më vonë se 10 ditë nga mbledhja e parë.

Neni 184*

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet KQZ-ja, në përputhje me përcaktimet dhe afatet kohore të vendosura në këtë Kod, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Jo më vonë se 60 ditë nga mbledhja e parë, KQZ-ja e zgjedhur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton Rregulloren e KQZ-së, e cila përfshin edhe marrëdhëniet e anëtarëve të saj me administratën e KQZ-së.

Neni 185

Shfuqizime

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, ligji nr. 9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor, që bie në kundërshtim me të, shfuqizohet.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në pikën 1 të këtij neni, pjesa e nëntë "Referendumet" e ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe çdo pjesë e dispozitave të tij që ka lidhje me të mbetet në fuqi deri në miratimin e ligjit të ri për referendumet e përgjithshme dhe vendore. Administrimi i procesit të referendumeve dhe nxjerrja e rezultatit të tyre bëhen në përputhje me këtë Kod.

Neni 186

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

---

* Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

SHTOJCA II

NUMËRIMI DHE VLERËSIMI I VOTAVE NËPËRMJET SISTEMIT ELEKTRONIK TË NUMËRIMIT (SEN)

Seksioni 1 - Qëllimi

1. Kjo shtojcë ka për qëllim të përcaktojë kërkesat bazë që duhet të plotësojë Sistemi Elektronik i Numërimit (SEN) dhe procedurën që ndiqet në vendin e numërimit të votave ku do të aplikohet SEN-i.

2. KQZ-ja përcakton me akt normativ rregullat në lidhje me verifikimin e saktësisë së SEN-it në vendin e numërimit, përdorimin dhe administrimin e SEN-it, si dhe procedurat e numërimit, vlerësimit të fletëve të votimit nëpërmjet SEN-it, përfshirë edhe nxjerrjen e rezultatit dhe administrimin e çdo të dhëne të prodhuar nga SEN-i.

3. Akti normativ i KQZ-së mund të ndryshojë ndonjë nga procedurat e parashikuara në këtë shtojcë, nëse ndikon në optimizimin e SEN-it, por në çdo rast pa prekur parimet e përcaktuara në seksionin 2 të kësaj shtojce.

Seksioni 2 - Sistemi Elektronik i Numërimit (SEN)

1. Sistemi Elektronik i Numërimit (SEN) përbëhet nga tërësia e pajisjeve elektronike, kompjuterike dhe programeve të ndryshme informatike, nëpërmjet të cilave në mënyrë automatike dhe të pavarur, realizohet numërimi, vlerësimi i fletëve të votimit dhe nxjerrja e rezultatit zgjedhor.

2. SEN-i duhet të garantojë se:

a) numëron çdo fletë të votimit në mënyrë të njëpasnjëshme dhe pa e dëmtuar atë;

b) procesi i përpunimit të fletës nga pajisja mund të vëzhgohet me sy të lirë;

c) vlerësimi i fletës të votimit kryhet një herë të vetme, pavarësisht nga numri i skanimeve të fletës së votimit;

ç) numëron dhe vlerëson fletët, pavarësisht llojit të organit për të cilin janë hedhur;

d) skanimi i imazhit të fletës bëhet nga të dyja anët;

dh) llogarit në mënyrë automatike rezultatin e zgjedhjeve për qendrën e caktuar të votimit dhe ZAZ-në;

e) përpunon dhe ruan të dhënat e fletëve të skanuara të grupuara, sipas qendrës së votimit;

ë) ruan imazhin e çdo flete të votimit të skanuar;

f) ndan fizikisht fletët e vlerësuara dhe ato të pavlerësuara;

g) shfaq imazhin e fletës së pavlerësuar nga SEN-i dhe të dhëna të tjera në monitor;

gj) mundëson regjistrimin e çdo vendimmarrjeje të KZAZ-së ose vërejtje gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave, sipas këtij Kodi, dhe ruan rekorde të auditueshme në lidhje me to;

h) prodhon tabela të rezultatit për çdo QV, ZAZ dhe një raport me rekordet e vendimmarrjes së KZAZ-së të përpunura në SEN;

i) ruan të gjitha rekordet e vendimmarrjes dhe çdo të dhënë të përpunuar nga SEN-i për një periudhë kohore 6 muaj nga përfundimi i zgjedhjeve, sipas përcaktimeve në aktin normativ të KQZ-së. Të dhënat e përpunuara dhe imazhet e fletëve të skanuara në SEN përdoren për qëllime të hetimit administrativ gjatë fazës së shqyrtimit të ankimeve.

Seksioni 3 - Testimi paraprak i SEN-it

1. Jo më vonë se 90 ditë përpara datës së zgjedhjeve, KQZ-ja zhvillon, në prani të përfaqësuesve të partive politike, vëzhguesve dhe medias, një provë të plotë, duke simuluar një numërim real, në lidhje me funksionimin e SEN-it. KQZ-ja harton një raport në lidhje me provën e zhvilluar, i cili shqyrtohet në seancë publike. Kur në raport janë konstatuar mangësi teknike, ato duhet të riparohen përpara ditës së zgjedhjeve, sipas afatit të përcaktuar nga KQZ-ja.

2. Akti normativ për përdorimin e SEN-it duhet të parashikojë dhe shkaqe teknike që ndikojnë në integritetin dhe funksionimin e SEN-it, sipas këtij Kodi. Në këtë rast KQZ-ja, me vendim të miratuar me jo më pak se 4 vota “pro”, vendos zbatimin e numërimit me dorë. Për këtë qëllim KQZ-ja mund të kërkojë kryerjen e një auditimi të pavarur nga një subjekt i specializuar, i cili paraqet një raport në KQZ, jo më vonë se 75 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

3. Operatori ekonomik që është përzgjedhur për zbatimin e SEN-it, sipas këtij Kodi, duhet të bashkëpunojë plotësisht me subjektin auditues, duke i dhënë çdo informacion që kërkohet nga auditi, me qëllim vlerësimin e integritetit të SEN-it. Subjekti auditues duhet të ruajë sekretin e të dhënave tregtare të mësuara gjatë auditimit. Ky detyrim nuk zbatohet në raportet e tij me KQZ-në.

Seksioni 4 - Personat përgjegjës për numërimin dhe mbikëqyrja e procesit

1. Përgjegjësinë për administrimin e SEN-it e ka vetëm personeli teknik i SEN-it. Personeli teknik i SEN-it përgjigjet plotësisht për administrimin e pajisjeve të SEN-it, hapjen dhe mbylljen e kutive të votimit, nxjerrjen dhe sistemimin e të gjitha fletëve të votimit për vlerësim në pajisje, hedhjen e çdo të dhëne apo vendimi të KZAZ-së në SEN, si dhe detyra të tjera të përcaktuara në këtë Kod ose në aktin normativ të KQZ-së.

Personeli nuk merr asnjë vendim në lidhje me procesin apo vlerësimin e votave. Operatori i ngarkuar për zbatimin e SEN-it është përgjegjës për rekrutimin dhe trajnimin e personelit teknik. Përzgjedhja e personelit bëhet së bashku me KQZ-në, sipas procedurave të përcaktuara në aktin normativ të KQZ-së.

2. Procesi i numërimit të votave drejtohet dhe kontrollohet nga KZAZ-ja. KZAZ-ja është plotësisht përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimeve të personelit të SEN-it, vendimmarrjen në lidhje me fletët e votimit të pavlerësuara nga SEN-i, kontrollin e regjistrimit të çdo të dhëne në SEN dhe nënshkrimin e tabelave të rezultatit, sipas përcaktimeve në këtë Kod. Për një mbikëqyrje më të mirë të procesit, KZAZ-ja mund të ndahet në disa grupe me dy anëtarë, ku në çdo rast përbërja e grupeve duhet të ruajë baraspeshën politike të KZAZ-së.

3. KZAZ-ja cakton katër përfaqësues të subjekteve zgjedhore, të cilët janë të ngarkuar vetëm për verifikimin e materialit në kutinë e votimit, në zbatim të procedurave të nenit 116/1 të këtij Kodi. Për këtë qëllim, në çdo vend të numërimit të votave organizohet një tavolinë e veçantë vetëm për këtë qëllim. Përfaqësuesit propozohen një nga partia që propozon kryetarin e KZAZ-së dhe një nga partia që propozon zëvendëskryetarin e KZAZ-së. Dy përfaqësuesit e tjerë propozohen respektivisht nga partia e shumicës dhe pakicës

që kanë të drejtë të propozojnë anëtar në KZAZ, përveç partisë që propozon kryetarin dhe zëvendëskryetarin. Personat caktohen nga KZAZ-ja jo më vonë se 5 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

4. Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore qëndrojnë përballë tavolinave ku është vendosur pajisja e numërimit dhe tavolina e verifikimit të materialit të votimit, në një largësi të vogël nga tryezat e punës dhe përballë monitorëve të SEN-it. Vëzhguesit nuk duhet të kenë kontakt fizik me materialet e votimit dhe pajisjet e SEN-it, por kanë të gjithë mundësinë për të parë pa pengesë veprimet e personelit të SEN-it. Vëzhguesit kanë të drejtë të paraqesin vërejtjet e tyre pranë KZAZ-së, e cila është e detyruar t'i regjistrojë ato në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së.

Seksioni 5 - Verifikimi i saktësisë së SEN-it në vendin e numërimit (verifikimi *a posteriori)*

1. Përpara fillimit të numërimit të votave, sipas seksionit 6, KZAZ-ja urdhëron kryerjen e verifikimit të saktësisë së SEN-it. Për këtë qëllim, për çdo pajisje numërimi, pasi të ketë përfunduar numërimi i dy kutive të para, sipas procedurave të numërimit me SEN, këto kuti i nënshtrohen rinumërimit me dorë. Rregullat dhe procedurat që do të ndiqen për verifikimin e saktësisë së SEN-it përcaktohen në aktin normativ që KQZ-ja nxjerr, sipas pikës 2 të seksionit 1 të kësaj shtojce.

2. Rinumërimi kryhet nga personeli i SEN-it, nën mbikëqyrjen e KZAZ-së, vetëm për votat "të vlerësuara nga SEN-i".

3. Nëse rezultati i nxjerrë nga rinumërimi me dorë është i njëjtë me atë të nxjerrë nga SEN-i, ose kur diferenca midis rezultatit të nxjerrë nga rinumërimi me dorë dhe rezultatit të nxjerrë nga SEN-i është më e vogël se 0,5 për qind, atëherë numërimi vazhdon normalisht, sipas seksionit 6 të kësaj shtojce.

4. Nëse konstatohen mospërputhje mes rezultatit që ka nxjerrë SEN-i dhe rezultatit të numërimit me dorë dhe përqindja e mospërputhjes është më e madhe se 0,5 për qind, KZAZ-ja urdhëron pezullimin e numërimit për atë pajisje. Konstatimi shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe KZAZ-ja njofton menjëherë KQZ-në.

5. Nëse e njëjta mospërputhje konstatohet në të gjitha pajisjet e SEN-it për atë KZAZ, numërimi pezullohet deri në një vendim të

KQZ-së. Vendimi i KQZ-së merret jo më vonë se dy orë nga marrja e njoftimit prej KZAZ-së.

6. Me marrjen e njoftimit dhe verifikimin e problemit, KQZ-ja urdhëron numërimin e votave me dorë, duke përcaktuar orarin e fillimit dhe përshtatjen e sallës për numërim të votave me dorë, sipas procedurave dhe kritereve të parashikuara për numërimin e votave me dorë në këtë Kod dhe aktet nënligjore.

Seksioni 6 - Numërimi i fletëve të votimit

1. Numërimi i votave fillon me vendim të KZAZ-së, pasi të kenë mbërritur të gjitha kutitë e qendrave të votimit nën juridiksionin e KZAZ-së. Personeli i SEN-it, me radhë dhe vetëm sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, duke filluar nga qendra e votimit me numër më të vogël, merr nga stiva e kutive të votimit kutitë e votimit me fletët e votimit të vetëm një qendre votimi. Më pas e vendos kutinë mbi tryezë dhe e hap atë, duke këputur vulat me kodet e sigurisë.

2. Në rastin e zgjedhjeve vendore, kutia e votimit e një qendre votimi për partitë politike dhe/ose koalicionet zgjedhore numërohet së bashku me kutinë me fletët e votimit për kandidatët për kryetar të njësive të qeverisjes vendore të asaj qendre votimi. Numërimi kryhet në mënyrë të njëpasnjëshme, duke filluar nga kutia për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore. Personeli i SEN-it nxjerr nga kutia Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe hedh në SEN të dhënat për pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim, fletët e votimit të shpërndara në qendrën e votimit, fletët e votimit të dëmtuara dhe fletët e votimit të papërdorura. Hedhja e të dhënave kryhet nën mbikëqyrjen e të paktën dy anëtarëve të KZAZ-së, të cilët kanë të drejtë të këqyrin nga pranë Procesverbalin për Mbylljen e Votimit.

3. Kur në kutinë e votimit nuk gjendet Procesverbali për Mbylljen e Votimit ose në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit nuk janë hedhur të dhënat për numrin e zgjedhësve që kanë votuar, fletët e dorëzuara në qendrën e votimit, fletët e papërdorura dhe fletët e dëmtuara, njoftohet KZAZ-ja. KZAZ-ja urdhëron personelin teknik të SEN-it të mbyllë kutinë e votimit, të plotësojë Procesverbalin e Konstatimit për këtë fakt, duke shënuar vulat e mbylljes, të lërë mënjanë kutinë/kutitë e votimit të asaj qendre votimi deri në verifikimin dhe plotësimin e Procesverbalit të Konstatimit, sipas

procedurave të pikës 3 të nenit 116/1 të këtij Kodi dhe hapjen e kutisë së materialeve të votimit të asaj qendre votimi.

4. Më pas personeli i SEN-it merr kutinë me materialet e votimit dhe e vendos atë mbi tavolinën e posaçme për verifikimin e materialit të votimit nga ana e përfaqësuesve të subjekteve të caktuara, sipas pikës 3 të seksionit 4 të kësaj shtojce. Përfaqësuesit e subjekteve kryejnë procedurat e parashikura nga neni 116/1 i këtij Kodi.

5. Kur materiali i votimit u nënshtrohet procedurave të verifikimit, kutia/kutitë e votimit të qendrës së votimit lihet mënjanë në vendin e përcaktuar më parë nga KZAZ-ja dhe numërimi vazhdon me qendrën e votimit të radhës, duke siguruar numërim të pandërprerë të kutive të votimit. Me përfundimin e verifikimit të materialit të votimit, të dhënat e shënuara në Procesverbalin e Konstatimit i dorëzohen KZAZ-së, e cila urdhëron hedhjen e tyre menjëherë në SEN nga ana e personelit të SEN-it. Më pas procedohet menjëherë me numërimin e fletëve të votimit, duke hapur kutinë me fletët e votimit të asaj qendre votimi.

6. Personeli i SEN-it nxjerr fletët e votimit nga kutitë, i shpalos ato, duke i vendosur mbi tryezë me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme njëra mbi tjetrën. Kur gjatë procesit konstatohen fletë të hedhura në kutinë e gabuar ato veçohen, grupohen dhe stivohen, sipas kategorive përkatëse të organeve për të cilat votohet, sipas përcaktimit në aktin normativ të KQZ-së. Më pas personeli i SEN-it i grupon, i stivon dhe i vendos në pajisjen e numërimit optik, me qëllim numërimin dhe vlerësimin e fletëve të votimit nga vetë pajisja, sipas procedurave të përcaktuara në aktin normativ të KQZ-së. Pas numërimit dhe vlerësimit, fletët e votimit futen në zarfat përkatës, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod, nga personeli i SEN-it.

7. Me qëllim optimizimin e procesit të numërimit të votave, KQZ-ja me akt normativ mund të vendosë për numërimin e të paktën 4 kutive në mënyrë të njëpasnjëshme nga e njëjta pajisje numërimi, duke zbatuar të njëjtat procedura për hapjen e kutisë së votimit. Akti normativ përcakton procedurat dhe veprimet që kryhen nga personeli i SEN-it për ndarjen, grupimin, sistemimin dhe numërimin e fletëve të votimit të kutive të votimit nga e njëjta pajisje në mënyrë të pandërprerë. Tabela e rezultatit për çdo kuti të numëruar printohet

pasi të ketë përfunduar numërimi dhe vlerësimi i të gjitha fletëve të votimit të katër kutive. Në aktin normativ të KQZ-së parashikohet edhe mënyra e trajtimit, sistemimit dhe futjes në zarfa të veçantë të fletëve pas procesit të numërimit. Fletët e skanuara dhe të ndara nga SEN-i futen në zarfa të veçantë, sipas përcaktimit të pikës 12 të seksionit 7 të kësaj shtojce, dhe mbyllen në kutinë përkatëse, sipas përcaktimeve të KQZ-së.

8. Pavarësisht nëse KQZ-ja ka marrë vendim, sipas pikës 7 të këtij seksioni, në çdo rast 4 kutitë e fundit të ZAZ-së për çdo pajisje numërimi numërohen pa nxjerrë tabelën përkatëse të rezultatit të kutisë. Tabela e rezultatit për këto kuti hartohet dhe printohet vetëm pasi të ketë përfunduar numërimi dhe vlerësimi i të gjitha fletëve të votimit të të katër kutive. KQZ-ja me akt normativ përcakton veprimet që kryhen nga personeli i SEN-it, KZAZ-ja, si dhe mënyrën e trajtimit, sistemimit dhe futjes në zarfa të veçantë të fletëve pas procesit të numërimit.

Seksioni 7 - Vlerësimi i votave dhe nxjerrja e rezultatit nëpërmjet SEN-it

1. Numërimi dhe vlerësimi i votave bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 117 të këtij Kodi dhe kryhet automatikisht nga SEN-i, i cili i ndan votat fizikisht në “të vlerësuara nga SEN-i” dhe “të kontestuara nga SEN-i”.

2. Fletë votimi “të kontestuara nga SEN-i” janë fletët, për të cilat SEN-i nuk është në gjendje të përcaktojë me saktësi vullnetin e zgjedhësit, nuk lexohen nga SEN-i, për shkak se nuk përmbajnë elementet teknike dhe formën e miratuar në aktin normativ të KQZ-së ose janë dëmtuar fizikisht. Vlerësimi i tyre bëhet nga KZAZ-ja.

3. Njoftimi për KZAZ-në bëhet me ngritjen e dorës nga ana e personelit të SEN-it, pa lëvizur nga vendi apo, sipas rastit, anëtari i KZAZ-së, pasi të ketë përfunduar vlerësimin për fletët e tjera të kutisë nga SEN-i. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të personelit të SEN-it derisa KZAZ-ja të këqyrë dhe të vlerësojë fletët e votimit. Imazhi i fletës shfaqet në monitor për vlerësim nga KZAZ-ja, si dhe për t’u këqyrur nga vëzhguesit. Vlerësimi i këtyre votave bëhet me vendim të KZAZ-së.

4. KZAZ-ja e kryen vlerësimin e votave “të kontestuara nga

SEN-i” nëpërmjet këqyrjes së imazhit elektronik të ruajtur në SEN për secilën votë të tillë, si dhe këqyrjes fizike të fletëve, të cilat nuk janë lexuar nga SEN-i, sipas pikës 2 të këtij seksioni. SEN-i bën të mundur ndarjen fizike të fletëve të palexuara nga fletët e tjera të kontestuara nga SEN-i.

5. KZAZ-ja, pasi këqyr fletët, vendos për vlerësimin e tyre dhe urdhëron përfshirjen e vlerësimit, sipas nenit 117 të Kodit, në SEN nga ana e personelit teknik në rubrikat përkatëse të SEN-it. Vlerësimi i bërë nga personeli i SEN-it shfaqet në monitor për vëzhguesit e subjekteve zgjedhore.

6. Fletët e vlerësuara nga KZAZ-ja shënohen në SEN në mënyrë dixhitale si “fletë të vlerësuara nga KZAZ-ja” dhe ruhen elektronikisht në rubrikë të veçantë. Nëse për vlerësimin ka kontestim nga të paktën një anëtar i KZAZ-së, në SEN bëhet shënimi si “fletë të kontestuara nga KZAZ-ja”. SEN-i bën të mundur ruajtjen në mënyrë elektronike në një rubrikë të veçantë të quajtur “Fletë të Kontestuara nga KZAZ-ja” të imazhit të këtyre fletëve. Nëse lind nevoja, KZAZ-ja mund të bëjë këqyrjen fizike të fletëve që ndodhen në zarfin e fletëve të votimit të kontestuara nga SEN-i.

7. Fletët e palexuara nga SEN-i këqyren fizikisht nga KZAZ-ja, me qëllim kontrollin nëse janë fletë votimi, sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar nga KQZ-ja, ose nëse fleta e votimit është dëmtuar në atë masë sa nuk mund të skanohet nga SEN-i. Në rast se fleta e votimit është e dëmtuar, llogaritet në numrin e fletëve të përdorura në votim dhe vlerësohet nga KZAZ-ja, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 117 të këtij Kodi dhe aktin normativ të KQZ-së.

8. Të dhënat dhe imazhi i fletës hidhen në SEN nga ana e personelit teknik, sipas procedurave të përcaktuara në aktin normativ. Çdo fletë tjetër që nuk ka formën, përmasat dhe karakteristikat teknike të miratuara nga KQZ-ja nuk llogaritet në numrin e fletëve të përdorura në votim dhe fakti shënohet në Procesverbalin e Konstatimit nga KZAZ-ja.

9. Pas numërimit të të gjitha fletëve të kutisë, personeli i SEN-it kontrollon të dhënat nën mbikëqyrjen e KZAZ-së dhe nëse nuk ka kundërshtim, i konfirmon ato. Të dhënat shfaqen njëkohësisht edhe në monitor për vëzhguesit. Në rast se vëzhguesit kanë kundërshtime, KZAZ-ja njihet me problemin dhe e shënon atë

në Librin e Protokollit të Mbledhjeve. KZAZ-ja merr vendim dhe më pas urdhëron nxjerrjen e tabelës së rezultatit.

10. Kur SEN-i konstaton diferencë ndërmjet fletëve të numëruara dhe të dhënave që janë hedhur në sistem për pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim, sipas Procesverbalit për Mbylljen e Votimit apo, sipas rastit, Procesverbalit të Konstatimit, personeli teknik njofton KZAZ-në. Fakti i mospërputhjes shënohet në Procesverbalin e Konstatimit nga KZAZ-ja, e cila më pas urdhëron hartimin e tabelës. Tabela hartohet dhe printohet nga SEN-i me shënimin "mospërputhje". Nëse ndonjë nga vëzhguesit ka vërejtje, ato shënohen nga personeli i SEN-it përpara se tabela e rezultatit të printohet.

11. Tabela e rezultatit për kutinë e numëruar printohet menjëherë nga SEN-i në disa kopje e më pas nënshkruhet nga personeli teknik i SEN-it dhe KZAZ-ja dhe më pas vuloset me vulën e KZAZ-së. Një kopje e tabelës u jepet vëzhguesve të subjekteve zgjedhore apo vëzhguesve të akredituar, ndërsa një kopje administrohet nga sekretari i KZAZ-së. Të dhënat e rezultatit ruhen në sistem dhe transmetohen në rrugë elektronike në KQZ, e cila i publikon menjëherë. Formati i tabelës së rezultatit përcaktohet në aktin normativ të KQZ-së.

12. Pas kryerjes së procedurave të përcaktuara në pikat 1 deri në 11 të këtij seksioni, fletët e vlerësuara si të vlefshme futen në zarfin me shënimin "VOTA TË VLERËSUARA NGA SEN-i", ndërsa votat e kontestuara nga SEN-i dhe të vlerësuara nga KZAZ-ja futen në zarfin me shënimin "VOTA TË KONTESTUARA NGA SEN-i". Këto dy zarfe së bashku me zarfin e Procesverbalit të Vulosjes futen në kutinë e votimit. Një kopje e Procesverbalit të Vulosjes, së bashku me Procesverbalin për Mbylljen e Votimit i dorëzohet sekretarit të KZAZ-së, i cili përgjigjet për administrimin e tyre. Kutia mbyllet me vula me kode sigurie të reja. Një kopje e Procesverbalit të Vulosjes i jepet vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.

13. Kutitë e numëruara, sipas këtij seksioni, dërgohen në vendin e caktuar brenda sallës së Vendit të Numërimit të Votave. Procesi i numërimit vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në numërimin e të gjitha kutive të pranuara të rregullta nga ana e KZAZ-së. Procesi i numërimit ndërpritet me vendim të KZAZ-së, vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore ose që pengojnë

procesin normal të numërimit. Shkaqet argumentohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së.

14. Në zbatim të nenit 122 të këtij Kodi, Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së hartohet në mënyrë automatike dhe printohet nga SEN-i. KQZ-ja përcakton me akt normativ formatin dhe procedurat që ndiqen në këtë rast.

15. Një kopje e dokumentacionit të prodhuar, sipas shkronjës "i" të pikës 2 të seksionit 2 të kësaj shtojce dhe një kopje e imazheve në format "vetëm lexim" për çdo fletë të skanuar të çdo qendre votimi, u jepet subjekteve zgjedhore apo vëzhguesve të akredituar nga KQZ-ja, pas nxjerrjes së rezultatit të zonës zgjedhore, me kërkesë të tyre, jo më vonë se 48 orë nga kërkesa, kundrejt tarifës që mbulon koston e riprodhimit. Tarifa përcaktohet me vendim të KQZ-së.

SHTOJCA III

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË VERIFIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË PJESËMARRJES SË ZGJEDHËSVE NË DITËN E VOTIMIT (SEV)

Seksioni 1 - Qëllimi

1. Me qëllim verifikimin dhe regjistrimin e pjesëmarrjes së zgjedhësve në ditën e votimit ngrihet sistemi elektronik i integruar për verifikimin dhe regjistrimin e pjesëmarrjes së zgjedhësve në datën e votimit (SEV). Zgjidhja teknike duhet të integrojë të gjitha elementet e nevojshme, përfshirë pajisjet, programet, licencat ose certifikatat përkatëse, për të garantuar siguri dhe thjeshtësi në përdorim.

2. Karakteristikat teknike të sistemit, pajisjeve, procedurat e funksionimit të teknologjisë, mënyra e komunikimit me njësinë qendrore informatike, formati i raportimit, mënyra e shpërndarjes, dorëzimit, administrimit të pajisjes në qendrën e votimit dhe hedhja e të dhënave nga pajisjet e qendrës së votimit në KQZ, rregullat për administrimin e sistemit, si dhe çdo çështje që lidhet me përdorimin e SEV-it, përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.

3. Akti normativ i KQZ-së mund të ndryshojë ndonjë nga procedurat e parashikuara në këtë shtojcë, nëse ndikon në optimizimin e SEV-it, por në çdo rast pa prekur parimet e përcaktuara në seksionin 2.

Seksioni 2 - Sistemi elektronik për verifikimin dhe regjistrimin e zgjedhësit (SEV)

1. Sistemi Elektronik i Verifikimit dhe regjistrimit të pjesëmarrjes së zgjedhësve në ditën e votimit (SEV) përbëhet nga:

a) njësia qendrore informatike e instaluar në KQZ;

b) tërësia e pajisjeve të leximit elektronik të përmbajtjes së dokumentit të identifikimit që përdoret në qendrën e votimit; dhe

c) çdo pajisje teknike apo program që lidhet me to.

2. Pajisja që përdoret në qendrën e votimit funksionon në mënyrë të pavarur nga njësia qendrore, duke lexuar përmbajtjen e

dokumentit të identifikimit me të dhëna biometrike. Kriteret teknike dhe procedurat përcaktohen në aktin normativ të KQZ-së.

3. Pajisja që përdoret në qendrën e votimit lexon dhe regjistron automatikisht informacionin që ndodhet në qarkun me kontakt dhe/ose pa kontakt të dokumentit të identifikimit. Të dhënat që lexohen janë emri, mbiemri, datëlindja, numri i identifikimit personal dhe numri i dokumentit të identifikimit.

4. Pajisja që përdoret në qendrën e votimit duhet të garantojë:

a) minimumin e ndërhyrjes, nga personi i caktuar me përdorimin e saj, për të funksionuar;

b) një shkallë të lartë mbrojtjeje e sigurie ndaj tentativave për ndërhyrje të paligjshme nga jashtë pajisjes;

c) ruajtjen në kujtesën e saj elektronike të të dhënave të dokumenteve të identifikimit të lexuara;

ç) mosregjistrimin e të dhënave të dokumenteve të lexuara në rend kronologjik gjatë ditës së votimit;

d) regjistrimin e të dhënave të një dokumenti identifikimi vetëm një herë, pavarësisht se sa herë dokumenti lexohet nga makina.

5. Karakteristikat përfundimtare teknike dhe specifikimet për pajisjet, mënyrën e veprimit dhe kontrollit mbi to përcaktohen në aktin normativ të KQZ-së.

6. SEV-i duhet të bëjë të mundur kontrollin në distancë të gjendjes së funksionimit të pajisjeve përgjatë ditës së votimit nga të gjitha qendrat e votimit ku përdoret SEV-i.

Seksioni 3 - Përdorimi i pajisjeve të leximit në qendrën e votimit dhe personeli

1. Si rregull, çdo qendër votimi duhet të jetë e pajisur me pajisjen e leximit elektronik të dokumentit të identifikimit. Shtrirja e SEV-it dhe përcaktimi i qendrave të votimit, në të cilat, për arsye teknike, nuk mund të përdoret SEV-i, përcaktohen nga KQZ-ja jo më vonë se 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

2. Pas mbylljes së votimit, pajisja transmeton vetëm numrin e plotë të dokumenteve të lexuara në qendrën e votimit. Të dhënat e plota për çdo dokument të lexuar nga qendra e votimit përkatëse nxirren nga memoria elektronike e pajisjes, duke i hedhur ato në

sistemin qendror, menjëherë pas mbërritjes së tyre në KQZ. Hedhja e të dhënave në sistem kryhet nën mbikëqyrjen e auditëve të KQZ-së. Procedurat dhe kriteret për hedhjen e të dhënave në sistemin qendror përcaktohen në aktin normativ të KQZ-së.

3. Nëse pajisja nuk funksionon, votimi zhvillohet pa ndërprerje, sipas procedurave të nenit 105 të këtij Kodi, duke shënuar në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit numrin e dokumentit të identifikimit. Fakti i mosfunksionimit shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të qendrës së votimit, si dhe njoftohet KZAZ-ja përkatëse, e cila duhet ta pasqyrojë këtë fakt në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të saj. Kur pajisja rivihet në punë, procesi vazhdon duke përdorur pajisjen për verifikimin dhe regjistrimin e pjesëmarrjes së zgjedhësve. Procedurat e komunikimit, zëvendësimit dhe raportimit, sipas kësaj pike, përcaktohen në aktin normativ të KQZ-së.

4. Pajisjet administrohen dhe përdoren vetëm nga personeli i specializuar dhe i autorizuar i KQZ-së. Operatori i ngarkuar për zbatimin e SEV-it është përgjegjës për rekrutimin dhe trajnimin e personelit teknik, sipas procedurave të përcaktuara në aktin normativ të KQZ-së dhe manualeve të miratuara nga KQZ-ja. Në përfundim të votimit, pajisjet dërgohen në KQZ. Procedurat, afatet dhe veprimet për dorëzimin, transportin, instalimin dhe verifikimin e funksionimit nga personeli përgjegjës për përdorimin e pajisjeve elektronike në qendrën e votimit përcaktohen në aktin normativ të KQZ-së.

5. Të dhënat e hedhura nga kujtesa elektronike e pajisjes administrohen nga KQZ-ja për nevoja të hetimit administrativ, në përputhje me nenet 136 ose 138 të këtij Kodi. Mospërputhja e të dhënave të transmetuara në SEV nuk përbën shkak për ankim, sipas pjesës X të këtij Kodi.

Seksioni 4 - Përpunimi i të dhënave, raportet dhe administrimi i sistemit

1. Menjëherë pas përfundimit të procesit të votimit në të gjithë vendin dhe bazuar në të dhënat e transmetuara nga pajisjet e përdorura në qendrën e votimit, njësia qendrore prodhon një raport të qendrave, në të cilat sistemi nuk ka funksionuar për një pjesë apo gjatë gjithë kohës së votimit, si dhe numrin e dokumenteve të lexuara për çdo qendër votimi. Formati i raportimit përcaktohet në aktin normativ të KQZ-së.

2. Pas hedhjes së të dhënave nga pajisjet e leximit të qendrave të votimit në KQZ, njësia qendrore prodhon një raport, nëse rezulton se një e dhënë nga i njëjti dokument është regjistruar më shumë se një herë, si dhe gjeneron raporte specifike në lidhje me to. Formati përcaktohet me akt normativ të KQZ-së. Raporti nuk përmban detaje në lidhje me identitetin e zgjedhësve të veçantë. Ky raport u jepet vetëm anëtarëve të KQZ-së nëpërmjet auditëve.

3. Aksesi në njësinë qendrore është i lejuar vetëm për personelin teknik të autorizuar, auditët teknicienë të KQZ-së, të emëruar sipas nenit 61 të këtij Kodi, dhe anëtarët e KQZ-së, të cilët pajisen me certifikatat hyrëse përkatëse. Auditët teknicienë të KQZ-së kanë të drejta të plota për të kontrolluar çdo veprim të kryer në sistem, hedhjen e çdo të dhëne nga kujtesa elektronike e secilës pajisje të leximit të përdorur në qendrën e votimit në sistemin qendror pranë KQZ-së, përfshirë dhe metodologjinë e gjenerimit të raporteve të parashikuara në këtë seksion. KQZ-ja, me të paktën 5 vota “pro” të anëtarëve të saj, miraton rregulloren për administrimin e SEV-it dhe rregullat për të drejtat e hyrjes në sistem nga personat e përcaktuar në këtë pikë.

4. Përveç auditëve të emëruar, sipas nenit 61 të këtij Kodi, KQZ-ja mund të përzgjedhë një shoqëri për auditimin e jashtëm të sigurisë dhe funksionimit të sistemit. Auditimi dhe raportimi kryhen jo më vonë se 60 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Raporti i auditimit shqyrtohet në KQZ në seancë publike.

5. Të dhënat e përpunuara dhe të hedhura nga pajisjet në KQZ, pas përfundimit të votimit, ruhen në KQZ për një periudhë 6-mujore nga data e zgjedhjeve dhe i nënshtrohen auditimit të plotë nga ana e KQZ-së menjëherë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar. Auditët paraqesin një raport përfundimtar në KQZ për auditimin e kryer brenda 30 ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar. Nëse gjatë auditimit dalin të dhëna për ndërhyrje të paligjshme në sistem, ose për votim më shumë se një herë, KQZ-ja është e detyruar të bëjë kallëzim penal.

6. Të dhënat e përpunuara dhe të ruajtura në sistem trajtohen sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Njoftimi i zgjedhësit, sipas nenit 52 të këtij Kodi, përmban dhe informacionin mbi të dhënat që do të përpunohen nga dokumenti i tij i identifikimit

dhe se ushtrimi i së drejtës së votës konsiderohet dhënie pëlqimi për përpunimin e këtyre të dhënave nga pajisja.

7. Raporti i hartuar sipas pikës 1 të këtij seksioni nxirret menjëherë sapo votimi është mbyllur në të gjithë vendin dhe i paraqitet nga auditët teknicienë anëtarëve të KQZ-së, jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e procesit të votimit. Një kopje e raportit u jepet përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore në KQZ, me kërkesë të tyre, brenda 24 orëve nga kërkesa, si dhe publikohet në faqen e internetit të KQZ-së.

Seksioni 5 - Procedurat në qendrën e votimit

1. Në vijim të procedurave të paraqitjes së zgjedhësit në qendrën e votimit, të parashikuara në nenin 105 të këtij Kodi, dhe menjëherë pas kryerjes së veprimeve të parashikuara nga shkronja "c" e pikës 1 të nenit 105, kryetari i KQV-së identifikon zgjedhësin nëpërmjet dokumentit të identifikimit, gjen emrin në listën e zgjedhësve dhe i kalon menjëherë dokumentin e identifikimit personit të ngarkuar për leximin dhe regjistrimin në pajisjen elektronike. Personi i caktuar me këtë detyrë vendos dokumentin e identifikimit përkatës në pajisjen lexuese, për të lexuar të dhënat e dokumentit të identifikimit. Një zgjedhës lejohet të votojë vetëm pasi kryhet regjistrimi i dokumentit të identifikimit.

2. Në rastet kur pajisja nuk funksionon, sipas pikës 3 të seksionit 3 të kësaj shtojce të Kodit, votimi fillon dhe/ose zhvillohet pa ndërprerje, pavarësisht mosfunksionimit të saj, dhe zgjedhësi lejohet të votojë rregullisht dhe pa asnjë pengesë.

3. KQV-ja dhe personeli teknik janë përgjegjës për zbatimin e këtij detyrimi. Personeli teknik mban përgjegjësi të plotë ligjore për administrimin e pajisjes dhe për regjistrimin e çdo dokumenti identifikimi në pajisje.

4. Në përmbushje të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 113 të këtij Kodi, për përcaktimin e numrit të zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votim, kjo e dhënë nxirret bazuar në numrin e dokumenteve të lexuara nga pajisja e leximit në qendrën e votimit. Kur pajisja nuk ka funksionuar, sipas pikës 3 të seksionit 3 të kësaj shtojce, numri i zgjedhësve nxirret bazuar në numrin e nënshkrimeve në listën e

zgjedhësve. Procesverbali i mbylljes së votimit, përveç anëtarëve të KQV-së, nënshkruhet edhe nga personeli teknik i SEV-it.

5. Veprimet e personelit teknik para, gjatë dhe pas procesit të votimit përcaktohen në aktin normativ të KQZ-së.

SHËNIME

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

ISBN: 978-92-9235-237-0

Tiranë, 2012